



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**Këshilli Drejtues**

**V E N D I M**

**Nr.11 , datë 19.04. 2017**

**Për**

**“Miratimin e Raportit të veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2016”.**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj.Anila	Denaj	Anëtar
4. Znj.Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Znj.Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Zj. Sara Reçi, në mbledhjen e datës 19.04.2017, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe Rregullores së Brendshme “Për Funksonimin e Kwshillit Drejtues të AKEP”, miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues nr.7 , datë 16.02.2017, shqyrtoi çështjen me objekt:

**“Miratimi i Raportit të veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2016”.**

**I. BAZA LIGJORE:**

1. Neni 9, pika 1 e nenit 114 dhe pika 1 e nenit 115 të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (**ligji nr.9918**);
2. Neni 8 I ligjit nr. 46/2015, datë 23.9.1999 “Për shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë”, (**ligji nr. 46/2015**);
3. Rregullore e Brendshme “Për Funksonimin e Këshillit Drejtues të AKEP”, miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues nr.7 , datë 16.02.2017 (**Rregullore e Brendshme**);

## II. K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Projekt-Raport i veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2016 (*Projekt-raporti*);
2. Relacioni shpjegues mbi projekt-vendimin (*Relacioni*);
3. Projektakti miratues – Vendim i Këshillit Drejtues për miratimin e “Raportit të veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2016”;

## III. V Ë R E N se:

1. Projekt-raporti i paraqitur pasqyron në mënyrë të plotë dhe korrekte veprimtarinë e AKEP për vitin 2016 dhe është hartuar bazuar në raportimet e bëra nga secila drejtori e AKEP mbi veprimtarinë e kryer;
2. Përmbajtja e Projekt-raportit përmbush kërkesat e përcaktuara në:
  - (i) Nenin 9, të ligjit nr. 9918;
  - (ii) Nenit 8 të ligjit nr. 46/2015,
  - (iii) Rregulloren e Brendshme .

## IV. P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Pasi e gjen projekt-raportin në përputhje me kërkesat ligjore, në mbështetje të pikës 1 të nenit 114, pikës 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918 dhe Rregullores së Brendshme,

## V. V E N D O S:

1. Të miratojë Raportin e veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2016, sipas dokumentit bashkëlidhur;
2. Të dërgojë brenda datës 20/04/2017 në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, “Raportin e veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2016”;
3. Të publikojë në faqen elektronike të AKEP [www.akep.al](http://www.akep.al) “Raportin e veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2016” dhe një kopje e tij njëkohësisht t’i dërgohet edhe Ministrit të Inovacionit dhe Administratës Publike;
4. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: [www.akep.al](http://www.akep.al)
5. Ngarkohet Kabineti për zbatimin e këtij vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R**

**PIRO XHIXHO**

**ANËTARË:**

1. **Alban KARAPICI**
2. **Anila DENAJ**
3. **Ketrin TOPÇIU**
4. **Klarina ALLUSHI**



# **RAPORTI VJETOR I VEPRIMTARISË SË AKEP**

**2016**

[www.akep.al](http://www.akep.al)

## Përmbajtja

<b>I. Të përgjithshme</b>	<b>8</b>
1. Shkurtime	8
2. Përmbledhje ekzekutive	9
2.1 Zhvillimi i tregut të komunikimeve elektronike:	10
2.2 Zhvillimi i tregut të shërbimeve postare	18
3. Baza ligjore	20
3.1 Legjislacioni material i fushës:	20
3.2 Kuadri ligjor që rregullon veprimtarinë si organ administrativ	21
3.3 Kuadri nënligjor rregullator	22
3.4 Përmirësim i bazës ligjore në periudhën raportuese (viti 2016)	24
3.5 Sfidat e së ardhmes	24
4. Përshkrim i Institucionit	24
4.1 Statusi dhe Këshilli Drejtues i AKEP	24
4.2 Juridiksioni territorial	25
4.3 Misioni	25
4.4 Vlerat thelbësore të AKEP	25
4.5 Struktura	25
4.6 Kompetencat e AKEP	26
5. Organizimi institucional	29
5.1 Parimet e Organizimit dhe Funksonet e Administratës	29
5.2 Struktura organizative e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare	29
5.3 Këshilli Drejtues	30
6. Kërkesat e Kuvendit nga AKEP për vitin 2016	33
7. Përshkrim i fushave që mbulon institucioni	35
7.1 Tregu i Komunikimeve Elektronike	35
7.1.1 Zhvillimi i tregut të komunikimeve elektronike	35
7.1.2 Tregues Financiarë të sektorit	35
7.1.2.1 Të Ardhurat	35
7.1.2.2 Fitimet	38

7.1.2.3	Investimet	39
7.1.3	Shërbime të rrjeteve Celulare	40
7.1.3.1	Numri i përdoruesve celularë	41
7.1.3.2	Shërbimet e aksesit broadband në rrjetet celulare 3G/4G	42
7.1.3.3	Trafiku telefonik dhe SMS	44
7.1.3.4	Trafiku on-net/offnet	45
7.1.3.5	Pjesët e tregut	46
7.1.3.6	Përdorimi mesatar mujor i shërbimeve celulare	49
7.1.3.7	Tarifat celulare	50
7.1.4	Shërbimet nga rrjetet fikse	56
7.1.4.1	Telefonia fikse	56
7.1.4.2	Aksesi broadband nga rrjete fikse	58
7.1.4.3	Përdorimi i përbashkët i infrastrukturës aktive dhe pasive në rrjetet fikse	64
7.2	Tregu i Shërbimeve Postare	64
7.2.1	Informacion mbi ecurinë dhe tendencat e tregut të shërbimeve postare	65
7.2.1.1	Volumi i objekteve postare	65
7.2.1.2	Tregues të rrjetit postar	67
7.2.1.3	Të punësuarit	68
7.2.1.4	Ankesat e përdoruesve (Reklamacionet)	69
7.3	Rezultatet Financiare në tregun postar	69
7.3.1	Të ardhurat	69
7.3.2	Investimet	72
	<b>II Puna gjatë vitit paraprak (2016)</b>	<b>73</b>
8.	Mbikqyrja e tregut të komunikimeve elektronike	73
8.1	Mbikqyrja dhe rregullimi ekonomik i tregut	73
8.1.1	Rregullimi ekonomik i tregut të komunikimeve elektronike	73
8.1.1.1	Analiza e tregut të aksesit broadband dhe linjave me qira	74
8.1.1.2	Analiza e tregut celular-këshillim Publik	75
8.2	Administrimi i burimeve të fundme, autorizimet dhe facilitetet	78
8.2.1	Autorizimi për të ofruar rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike sipas regjimit të autorizimit të përgjithshëm	79
8.2.1.1	Regjistrimi i Njoftimit	79
8.2.1.2	Dhënia e autorizimeve, liçencave dhe çertifikatave për shërbimet ajrore/detare etj.	80

8.2.1.3	Administrimi dhe publikimi i regjistrave të sipërmarrësve dhe liçencave.	80
8.2.2	Harmonizimi i pajisjeve radio / Konfirmimi i miratimit të tipit / Njoftimet për 2.4/5.8	82
8.2.3	Veprimtaria për administrimin e spektrit të frekuencave dhe numeracionit	83
8.2.3.1	Lëshimi i autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave	83
8.2.4	Mbi procedurat për koordinimin e frekuencave dhe notifikimit të satelitëve që ndiqen nga AKEP	85
8.2.4.1	Shtojca 30B të RR ITU, publikuar në BR IFIC.	85
8.2.4.2	Seksioni CR/C i softit SpaceCom	86
8.2.5	Bashkëndimi i punës me administratat e vendeve fqinje dhe të vendeve të tjera, për caktimin dhe përdorimin e radio-frekuencave për pjesën e spektrit që administron	86
8.2.6	Hartimi, miratimi dhe administrimi i planit kombëtar të numeracionit për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë	86
8.2.7	Mbikqyrja e Faciliteteve	89
8.3	Monitorimi i spektrit të frekuencave, cilësisë dhe inspektimit	91
8.3.1	Ndjekja e Inspektimeve dhe problematika të sipërmarrësve të komunikimeve elektronike	91
8.3.2	Ndjekja e arkëtimeve të pagesave nga debitorët e AKEP	92
8.3.3	Marrjen e masave organizative dhe operative për detyrimin e sipërmarrësve lidhur me zbatimin e rregullave teknike për rrjetet.	92
8.3.4	Monitorimi i spektrit të frekuencave	95
8.3.4.1	Monitorimi i radiolidhjeve fikse në pikat transmetuese të vendit	95
8.3.4.2	Monitorimi Fiks i Spektrit të frekuencave 20– 3000 MHz nga Stacionet Fikse në Krujë dhe Pinet	96
8.3.4.3	Subjektet që ofrojnë Shërbim Audiovizual	97
8.3.4.4	Subjekte që ofrojnë shërbimet internet dhe data	97
8.3.4.5	Subjekte të cilat ofrojnë internet nëpërmjet sistemeve që operojnë në brezin e frekuencave 2.4 dhe 5.8 GHz	97
8.3.5	Interferenca që shfaqin rrezikshmëri	98
8.3.6	Interferenca që dëmtojnë cilësinë e shërbimit	98
8.3.7	Bashkëpunimi ndërinstitucional	99
8.3.8	Monitorimi i cilësisë së shërbimit	99
8.3.9	Përmirësimi dhe zgjerimi i shërbimit Broadband	101

8.3.10	Verifikimi i marrëveshjes së koordinimit ndërkufitar	101
8.3.11	Zhvillimi i projektit “Sistemi Kombëtar i Monitorimit të Spektrit të Frekuencave për Shqipërinë”	102
8.4	Ushtrimi i funksioneve rregullatore në teknologjinë e informacionit dhe zhvillimit të broadband	105
8.4.1	Administrimi i domain	106
8.4.2	Portabiliteti i Numrit	109
8.4.3	Ndjekje e procesit të zbatimit nga ana e sipërmarrësve të detyrimeve ligjore lidhur me marrjen e masave për sigurinë e rrjeteve dhe\ose shërbimeve.	109
8.4.4	Administrimi dhe mirëmbajtja e sistemeve informatike dhe rrjetit kompjuterik të AKEP	111
8.4.5	Ndjekja e zbatimit të strategjisë së AKEP për broadband	112
8.4.6	Bazuar në Planin e Punës për vitin 2016 janë përfunduar me sukses këto projekte kryesore	113
8.4.6.1	“Sistemi dhe rrjeti i komunikimit të Q.K.M.F. me pikat e monitorimit në distancë”	113
8.4.6.2	“Zëvendësimi dhe Rinovimi i pajisjeve IT”	113
8.5	Zgjidhja e mosmarrëveshjeve dhe mbrojtja e konsumatorit	114
8.5.1	Zgjidhja e mosmarrëveshjeve midis sipërmarrësve	114
8.5.2	Shqyrtimi i ankesave dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve midis pajtimtarëve dhe sipërmarrësve	115
8.5.3	Ankesa administrative	115
8.5.4	Mosmarrëveshjet gjyqësore	115
8.6	Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe administrimi i brendshëm.	116
8.6.1	Në drejtim të menaxhimit të burimeve njerëzore është realizuar	116
8.6.2	Në drejtim të administrimit të brendshëm janë kryer	118
8.6.3	Administrimi i shërbimeve mbështetëse për instuticionin	120
8.6.4	Dixhitalizimi i Arkivës së AKEP	120
8.7	Mbikqyrja e tregut të shërbimeve postare	120
8.7.1	Paketa rregullatore e hartuar dhe miratuar nga AKEP në zbatim të Ligjit 46/2015	120
8.7.2	Mbikqyrja, monitorimi dhe ushtrimi i kontrollit të veprimtarisë së ofruesve të shërbimeve postare	122
8.7.3	Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare dhe kombëtare në fushën e rregullimit të shërbimeve postare	124



8.7.4	Aktiviteti i bashkëpunimit ndër-institucional dhe marrëdhëniet ndërkombëtare.	125
<b>III Statusi i Shërbimit Universal</b>		<b>129</b>
9.	Statusi i shërbimit universal për shërbimet publike të komunikimeve elektronike	129
9.1	Propozimi i KE për rishikimin e kuadrit rregullator	129
9.2	Implementimi i SHU në vendet e BEREC	131
9.3	Përballueshmëria e tarifave: Raporti i ITU 2016	132
9.4	Përfundimi i AKEP	135
10.	Statusi i ofrimit të shërbimit postar	135
10.1	Përcaktimet ligjore dhe nënligjore për ofrimin e shërbimit universal postar	135
10.2	Tregues të volumit dhe cilësisë së shërbimit universal postar	136
10.2.1	Për vitin 2016 Posta Shqiptare në krahasim me vitin 2015 ka realizuar:	137
10.2.2	Treguesit e totalit të shërbimeve postare universale	138
10.3	Tregues të rrjetit dhe shërbimit universal postar	139
10.4	Standardet e cilësisë së shërbimit universal postar	140
10.4.1	Cilësia e Shërbimit/standartet e shërbimit universal postar:	140
10.4.2	Testet mbi kohën e shpërndarjes së objekteve postare.	141
10.4.3	Realizimi i treguesve të cilësisë së shërbimit postar për vitin 2016:	142
10.4.4	Standardet e kohës së shpërndarjes për postën ndërkombëtare.	142
10.4.5	Dorëzimi i objekteve postare.	143
10.5	Tarifat dhe kostot për ofrimin e shërbimit universal postar	144
<b>IV Programi vjetor i punës për vitin në vazhdim</b>		<b>145</b>
11.	Programi vjetor i punës për vitin në vazhdim 2017	145
11.1	Në drejtim të mbikëqyrjes dhe rregullimit ekonomik	145
11.2	Në drejtim të administrimit të burimeve të fundme, autorizimeve dhe faciliteteve	146
11.3	Në drejtim të monitorimit të spektrit të frekuencave, cilësisë dhe inspektimit	147
11.4	Në drejtim të ushtrimit të funksioneve rregullatore në teknologjinë e informacionit dhe zhvillimit të broadband	148
11.5	Në drejtim të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe mbrojtjes së konsumatorit	148
11.6	Në drejtim të mbikëqyrjes së tregut të shërbimeve postare	149
11.7	Në drejtim të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe administrimit të brendshëm	151
11.8	Në drejtim të menaxhimit financiar dhe pagesave	151

	<b>V Raporti Financiar</b>	<b>152</b>
12.	Raporti për realizimin e treguesve financiar vjetor të AKEP	152
12.1	Të ardhurat dhe shpenzimet	152
12.2	Realizimi i arkëtimeve	152
12.3	Realizimi i shpenzimeve.	153
12.3.1	Shpenzimet administrative	153
12.3.1.1	Shpenzime për paga dhe shtesa	153
12.3.1.2	Shpenzime për sigurime shoqërore	154
12.3.1.3	Shpenzime për materiale	154
12.3.1.4	Shpenzimet për shërbime.	154
12.3.1.5	Shpenzimet për Investimet	155
12.4	Mbi tepricën e të ardhurave	156
12.5	Mbi taksën e radiokomunikacionit	156
12.6	Rritja e performancës dhe efektiviteti i realizimit të treguesve financiarë të AKEP	157
13.	Programi i treguesve financiarë të AKEP për vitin 2017	158
	<b>Figurat</b>	<b>159</b>
	<b>Tabelat</b>	<b>160</b>

## I. Të përgjithshme

### 1. Shkurtime

AKEP - Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare  
MIAP - Ministri i Inovacionit dhe Administratës Publike  
BEREC - Body of European Regulators of Electronic Communications  
ERGP - The European Regulators Group for Postal Services  
ITU - International Telecommunication Union  
UPU - Universal Postal Union  
KE - Këshilli i Evropës  
AEK - Autoriteti rregullator i Maqedonisë  
EKIP - Autoriteti rregullator i Malit të Zi  
HAKOM - Autoriteti rregullator i Kroacisë  
RATEL - Autoriteti rregullator i Serbisë  
RTR - Autoriteti rregullator i Gjermanisë  
AKOS - Autoriteti rregullator i Sllovenisë  
BTK - Autoriteti rregullator i Turqisë  
ARKEP - Autoriteti rregullator i Kosovës  
AK - Autoriteti i Konkurrencës  
AMA - Autoriteti Mediave Audiovizive  
KKRT - Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit  
DAP - Departamenti i Administratës Publike  
ASPA - Shkolla Shqiptare e Administratës Publike  
FNT - Fuqi të Ndjeshme në Treg  
PKF - Plani Kombëtar i Frekuencave  
PKN - Plani Kombëtar i Numeracionit  
SHU - Shërbim Universal  
OA - Operatorë Alternativë  
NGN - Next Generation Networks  
CEPT - Centre for Environmental Planning and Technology  
LLU - Local Loop Unbundling  
ARPU - Average Revenue Per User  
ARPM - Average Revenue Per Minute

## 2. Përmbledhje ekzekutive

AKEP për punën e tij është përgjegjës përpara Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe ky raport i paraqitet Kuvendit prej tij në zbatim të detyrimit ligjor të përcaktuar në nenin 9 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenit 8 të ligjit nr. 46/2015 “Për Shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë” mbi veprimtarinë e vitit pararendës, si organ rregullator i fushës së komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare.

Raporti është hartuar i ndarë në pesë kapituj kryesorë:

- Të përgjithshme,
- Puna gjatë vitit paraprak,
- Statusi i Shërbimit Universal,
- Programi vjetor i punës për vitin në vazhdim,
- Raporti Financiar.

Veprimtaria rregullatore e AKEP gjatë vitit 2016 është karakterizuar nga pesë parime bazë:

- Mbrojtja e interesave të përdoruesve,
- Nxitja e konkurrencës,
- Sigurimi i integritimit social,
- Mirëadministrimi i burimeve të fundme,
- Garantimi i sigurisë së rrjeteve.

dhe vlerat e mishëruara janë:

- Profesionalizmi,
- Zhdërvjelltësia,
- Pavarësia,
- Transparenca.

Puna e AKEP gjatë vitit paraprak është udhëhequr nga angazhimi maksimal për zbatimin dhe përmbushjen e:

- Detyrimeve dhe objektivave rregullatore të përcaktuar në legjislacionin material,
- Politikat e zhvillimit sektorial të Këshillit të Ministrave,
- Rekomandimeve të Kuvendit,
- Direktivave të fushës të Komisionit dhe Parlamentit Europian,
- Akteve të BEREC, ERGP dhe ITU,
- Rekomandimeve sektoriale të Progres Raportit të KE për Shqipërinë,

- Programit vjetor të punës për vitin në vazhdim të paraqitur në Raportin vjetor të veprimtarisë së AKEP për vitin 2015.

Këshilli Drejtues gjatë vitit 2016 ka zhvilluar 19 mbledhje dhe ka nxjerrë 39 akte vendim-marrëse, nga të cilat:

- 24 akte të karakterit rregullator,
- 1 akt të karakterit të brendshëm administrativ,
- 5 akte për miratim dhënie Autorizime Individuale,
- 9 akte për shqyrtimin e ankimeve administrative dhe zgjidhje mosmarrëveshje.

Raporti përmban të dhëna të detajuara mbi zhvillimin gjatë vitit 2016 të tregut të:

- Ofrimit të rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike,
- Ofrimit të shërbimeve postare,

## **2.1 Zhvillimi i tregut të komunikimeve elektronike:**

Tendencat kryesore të tregut të komunikimeve elektronike gjatë vitit 2016 ishin:

- Rritja e ndjeshme e përdorimit të shërbimeve të aksesit broadband nga rrjete celulare;
- Rritje e qëndrueshme e aksesit broadband nga rrjete fikse, ndonëse me norma më të ngadalësuara se në vitet e mëparshme;
- Rritje përdorimit të paketave të integruara në rrjetet fiks dhe celulare;
- Rënie e përdorimit të shërbimeve tradicionale të telefonisë (celulare dhe fikse);
- Rënie e fitimeve neto dhe normave të fitimit për sipërmarrësit e rrjeteve kryesore të komunikimeve elektronike.

Numri i përdoruesve celularë aktivë në fund të vitit 2016 ishte 3.4 milion, që përbën një rënie me 2.1% në krahasim me vitin 2015. Përsa i përket numrit të përdoruesve sipas kartave SIM në fund të 2016 ishin rreth 5.3 milion përdorues që përbën që përbën rritje me 7.8% në krahasim me vitin 2015.

Numri i përdoruesve aktivë (përdorim 3 muajt e fundit) të shërbimeve me akses broadband nga rrjetet celulare (3G/4G nga aparateve celulare dhe me karta USB/modem) në vitin 2016 ishte rreth 1.7 milionë, që përbën rritje me 30% krahasuar me 2015. Nga të dhënat tremujore të ecurisë së numrit të përdoruesve celularë vihet re se në tremujorin e katërt 2016 treguesit janë me rënie 2.5 deri në 8 përqind në krahasim me tremujorin e tretë 2016. Rënia në tremujorin e katërt 2016 vjen pas rritjes së madhe në tremujorin e tretë 2016, e cila shpjegohet me efektin sezonal të muajve Korrik-Gusht që përkon me sezonin turistik dhe kthimin e emigrantëve në Shqipëri. Megjithatë, numri i përdoruesve të telefonisë celulare në periudhën 2014-2016 rezulton se ka luhatje por rreth niveleve tashme të maturuara, ndërsa

numri i përdoruesve të aksesit broadband celular ka trend rritës, pavarësisht efekteve sezonale.

Rritja e përdorimit të aksesit broadband nga rrjetet celulare 3G/4G në vitet e fundit vihet re edhe në rritjen e volumit të të dhënave të transmetuara në rrjetet celulare. Në vitin 2014 rritja vjetore e trafikut të të dhënave në rrjetet celulare ishte 148%, dhe ky trend vijoi edhe në vitet 2015 dhe 2016 ku rritja vjetore ishte 103% dhe 110% respektivisht. Në periudhën 2013-2016 volumi i të dhënave të aksesit në Internet në rrjetet celulare është rritur më shumë se 10 herë.

Sasia totale e thirrjeve telefonike të gjeneruara nga përdoruesit celularë gjatë vitit 2016 u reduktua me 8% në krahasim me vitin 2015, ndërkohë numri i mesazheve SMS të dërguara nga përdoruesit celularë rezultoi me një rritje modeste prej 1%. Këto tendenca të shërbimeve tradicionale nga rrjete celulare (thirrje dhe SMS) janë të kundërta me rritjen e ndjeshme të përdorimit të aksesit broadband nga rrjete celulare. Trendi rënies së nivelit dhe/ose ritmeve të rritjes së përdorimit të thirrjeve dhe SMS-ve dhe trendi rritës i aksesit broadband celular në 2-3 vitet e fundit janë tregues të efektit të zëvendësimit të thirrjeve telefonike/mesazheve SMS me thirrje/mesazhe nga aplikacionet OTT (Over The Top) në Internet në aparat celular, të vënë në dukje nga AKEP dhe në raportin e mëparshëm vjetor.

Gjatë vitit 2016, një përdorues celular aktiv (që ka kryer komunikim në 3 muajt e fundit) ka kryer mesatarisht 166 minuta thirrje dalëse, ka dërguar 39 mesazhe SMS në muaj dhe ka konsumuar 1.48 GB në Internet broadband. Këto vlera përdorimi janë me rënie 9% për thirrjet dhe të pandryshyar për SMS-të në krahasim me vitin 2015, ndërsa përdorimi mesatar i Internetit në celular ka rritje me 68%. Ndërkohë gjatë vitit 2016 një përdorues celular (që ka përdorur Internetin të paktën një herë gjatë vitit) ka përdorur mesatarisht 954 MB në muaj të dhëna në Internet krahasuar me 541 MB në vitin 2015, pra rritje me 76%.

Sic është përmendur edhe në raportin vjetor të vitit 2015, më 1 Korrik 2015 hyri në fuqi detyrimi i operatorëve celularë për mos-diskriminim në tarifën e thirrjeve brenda rrjetit dhe drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare. Vijimi i zbatimit të këtyre detyrimeve në vitin 2016 ka çuar në ndryshime të tjera të ndjeshme në nivelin e thirrjeve sipas destinacionit dhe strukturën e tyre.

Në vitin 2016 thirrjet brenda rrjetit u reduktuan me 20% në krahasim me 2015, ndërsa thirrjet drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare (off-net) u rritën me 83%. Pesha e thirrjeve brenda rrjetit ndaj totalit të thirrjeve dalëse në vitin 2016 u reduktua në 60% nga 69% në 2015 (84% në 2014), ndërsa pesha e thirrjeve off-net arriti në 37% krahasuar me 18% në 2015 (8% në 2014).

Për sa i përket pjesëve të tregut të operatorëve celularë, Vodafone Albania ka rritur pjesën e tregut për numrin total të pajtimtarëve/përdoruesve aktivë të shërbimeve telefonike duke arritur në rreth 50% të tregut, që përbën një rritje me 4 pikë përqindje në krahasim me vitin 2015, ndërsa tre operatorët e tjerë kanë pasur ulje të pjesëve të tregut për këtë tregues. Vodafone Albania historikisht ka pasur pjesë tregu të larta për shërbime të të dhënave (SMS

dhe akses broadband) dhe në vitin 2016 pjesët e tregut të këtij operatori për përdorues aktivë të aksesit broadband celular dhe SMS, ishin 55 dhe 67% respektivisht. Pjesët e tregut në të ardhura në vitin 2015 nuk patën ndryshime të ndjeshme, përveç shtimit me 1 pikë përqindje të pjesës së tregut të Plus dhe rënies me 1 pp të pjesës së Vodafone, duke zbritur në 47%.

Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse ka patur tendencë reduktimi duke filluar nga viti 2012 dhe në vitin 2015, ndërsa në vitin 2016 u vu re një rritje e numrit të linjave të telefonisë fikse. Shërbimet e telefonisë fikse në Shqipëri ofrohen nga rreth 80 sipërmarrës, të cilët zotërojnë rrjetet/infrastrukturën e tyre, përfshirë rrjetin e aksesit apo të lidhjes direkte me përdoruesit fundorë. Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse në fund të vitit 2016 arriti në rreth 248 mijë dhe norma e penetrimit për telefoninë fikse (numër pajtimtarësh për 100 banorë) arriti në 8.8 %, që është shumë më e ulët se vendet e zhvilluara (rreth 40%), rreth dy here te me e ulet se mesatarja botërore (15.2%), madje me te ulet edhe se mesatarja e vendeve në zhvillim (10%). Sic është theksuar në raportet e mëparshme vjetore tendenca rënëse e përdorimit të këtij shërbimi është një trend global dhe i ndikuar nga shumë faktorë, ndër të tjera edhe efekti i zëvendësimit të këtyre shërbimeve me shërbime nga rrjete celulare, të cilat vitet e fundit në Shqipëri ofrojnë tashmë edhe akses broadband në Internet me cilësi dhe tarifa të favorshme për përdoruesit.

Shërbimet e aksesit broadband nga rrjete fikse kanë vazhduar të kenë rritje të qëndrueshme në 5 vitet e fundit. Numri pajtimtarëve me akses broadband nga rrjete fikse në fund të vitit 2016 arriti në rreth 264 mijë, që përbën një rritje vjetore prej rreth 9% dhe më e ngadaltë se rritja vjetore prej 17% në vitin 2015. Norma e penetrimit për popullsi dhe për familje e pajtimtarëve me akses broadband fikse në fund të vitit 2016 ishte 9.3% dhe 33.4% përkatësisht. Albtelecom zotëron 41.3% pjesë tregu që përbën një rritje vjetore me 1.1 pikë përqindje.

Gjatë vitit 2016, numri i pajtimtarëve me shërbime të integruara në shporta triple play (Telefoni, Internet dhe TV), arriti në rreth 187 mijë, rreth 25 % më shumë se në vitin 2015. Albtelecom pati rritjen më të madhe të këtyre pajtimtarëve (me rreth 4 herë). Në fund të vitit 2016, 70% e pajtimtarëve me akses broadband në rrjete fikse ishin pajtimtarë me paketa të integruara (dyfishe ose trefishe), ku gjysma e tyre janë me paketa trefishe (Telefoni, Internet dhe TV). Për Albtelecom përdorimi i paketave të integruara është akoma më i lartë. Në vitin 2016, 67% e përdoruesve me akses broadband të Albtelecom ishin me paketa trefishe.

### ***Tregues financiarë të vitit 2015/2016***

Të ardhurat totale të sipërmarrësve në tregun e komunikimeve elektronike për vitin 2015 ishin rreth 43 miliard lek, krahasuar me 42.5 miliard lek në vitin 2014, që përbën një rritje me 1.3%. Kjo rritje erdhi pas një trendi rënës të të ardhurave që prej vitit 2009 (përveç vitit 2012). Të ardhurat nga operatorëve të rrjeteve celulare u rritën me 1.2%, ndërsa të ardhurat e operatorëve të rrjeteve fikse u rritën me 1.4%. Të ardhurat nga shërbimet celulare vijnë të përbëjnë rreth 77% të të ardhurave të sektorit, ndërsa të ardhurat nga shërbimet e rrjeteve fikse 23%.

Te ardhurat nga shërbimet me pakice të rrjeteve celulare vijuan tendencen rënëse që prej vitit 2011 dhe e shoqëruar me rritje të ndjeshme të konsumit mesatar të shërbimeve celulare, sidomos akses në internet, ka çuar në rënie të ARPU retail të operatorëve celulare. Në vitet 2014 dhe 2015 është vënë re një rënie e madhe e fitimeve neto totale e katër sipërmarrësve të sektorit celular, sidomos për dy operatorët më të mëdhenj, Vodafone dhe TA. Në vitin 2015 për herë të parë rezultati neto total i të katër sipërmarrësve së bashku ishte negativ. Megjithë rënien e madhe të fitimeve neto, niveli total i investimeve në infrastrukturë rrjeti celular në këtë periudhë nuk ka pasur rënie të ndjeshme, madje sipërmarrësit kanë kryer investime të larta në asete jo-të prekshme si pagesat one-off për rinovime frekuencash 900/1800 MHz (TA dhe Vodafone) dhe blerje të brezave të rinj të frekuencave në këto vite për ofrim të shërbimeve në rrjete 3G/4G.

Të dhënat e vitit 2016 tregojnë për rritje me 2.4% të të ardhurave totale nga shërbimet celulare, por me trende të ndryshme midis katër operatorëve celularë, dhe rënie me 15% të të ardhurave të Albtelecom nga shërbimet e rrjetit fikse.

### *Analiza e tregjeve*

AKEP gjatë vitit 2016 kreu procedurat e analizës së tregjeve me shumicë të aksesit broadband dhe linjave me qira, dhe në përfundim të procesit të këshillimit publik, përcaktoi Albtelecom si sipërmarrës me FNT në tregjet e analizuara dhe vendosi masat përkatëse rregulluese, të cilat përfshijnë ndër të tjera detyrimin për Albtelecom për të dhënë akses në elementët aktivë dhe pasivë të rrjetit si LLU, akses bitstream dhe akses në tubacione në nivel lokal (zona urbane) dhe me tarifa nën-rregullim. Një theks i veçantë në këtë analizë tregu i'u kushtua aksesit në tubacione në nivel lokal (urban) dhe kombëtar (ndërrurbane). Në përfundim të procesit, AKEP vendosi të sanksionojë si tarifa maksimale (tavan) për t'u aplikuar nga Albtelecom për aksesin në tubacione në zona urbane tarifat e reduktuara nga vetë Albtelecom për këtë shërbim me 50% në Tetor 2016. Për aksesin në tubacione në nivel ndër-urban, ku ofrues të vetëm janë ATU dhe Albtelecom, AKEP gjykoi se problematika e mundshme mund të adresohet me instrumenta të tjerë ligjorë si zgjidhja e mosmarrveshjeve sipas Ligjit 9918, tarifat "benchmark" të publikuara nga AKEP për këtë shërbim dhe parashikimet më të detajuara dhe aktet nën-ligjore të Ligjit Nr. 120/2016 "*Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit*", të miratuar më 24.11.2016, ligj i cili ka për qëllim të lehtësojë e nxisë ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë (broadband) dhe synon të rregullojë jo vetëm aksesin në infrastrukturën e rrjeteve të sipërmarrësve të komunikimeve elektronike por edhe aksesin në llojet e tjera të infrastrukturës që zotërohen nga sipërmarrës në sektorë të tjerë si energji, ujë, transport rrugor etj, dhe që mund të përdoren për rrjetet e komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë.

AKEP në muajin Dhjetor 2016 publikoi për këshillim publik dokumentin e Analizës së tregut celular dhe dokumentin e Rregullimit të tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, nëpërmjet të cilat analizohet tregu celular për FNT në tregun e terminimit të thirrjeve dhe ma-



sat përkatëse rregulluese, përfshirë rregullimin e tarifave të terminimit, si dhe analizohet tregu me pakicë i shërbimeve celulare.

### ***Shërbimi Universal***

AKEP në vijim të Planit të Veprimit 2013-2016 për Shërbimin Universal në fushën e komunikimeve elektronike në periudhën Tetor-Nëntor 2016 kreu procesin e këshillimit publik për Shërbimin Universal. Një ndër çështjet më të diskutuara ishte propozimi i AKEP për përfshirjen e aksesit broadband nga rrjete fikse dhe celulare dhe paketat përkatëse tarifore në objektin e SHU. AKEP bazuar në një sërë faktorësh të analizuar në miratimin e versionit final të dokumentit vendosi që megjithë zhvillimet shumë të mirat të aksesit broadband, sidomos nga rrjetet celulare vitet e fundit, dhe nivelit të përbalueshëm të tarifave me pakicë të aksesit broadband dhe telefonisë (fikse dhe celulare)<sup>1</sup> të ofruara në mënyrë komerciale nga tregu pa ndërhyrjen direkte të AKEP, përfshirja e aksesit broadband në objektin e SHU aktualisht do të ishte e parakohshme (në vendet e BE aplikohet vetëm në 7 vende).

Mënyra më mirë për promovimin dhe më pas universalizimin e këtij shërbimi janë masat e tjera të ndërmarra nga AKEP si përmirësimi i sinjalit të mbulimit dhe cilësisë së rrjeteve 3G/4G në zona të caktuara nga 3 operatorët kryesorë celularë, masa rregulluese për aksesin broadband fikse, përfshirë masa që ndërmerren nga Qeveria në anën e kërkesës për nxitjen e shtresave në nevojë për përdorimin e këtij shërbimi dhe ICT në përgjithësi.

Raporti i ITU “*Measuring the Information Society Report*”, i cili është një raport periodik vjetor, në publikimin e vitit 2016, ka evidentuar një sërë zhvillimesh pozitive për sektorin e komunikimeve elektronikë në Shqipëri. Në raportin e vitit 2015 Shqipëria rënditej në vende të mira për aksesin të aksesit broadband por në vende më të ulëta për telefoninë, sidomos telefoninë celulare.

### ***Administrimi i spektrit i frekuencave***

Në drejtim të administrimit me efikasitet të spektrit të frekuencave dhe në funksion të zhvillimit të tregut AKEP ka zbatuar një proces dhënie të drejtash përdorimi të frekuencave objektiv dhe transparent në përfitim të konsumatorëve shqiptarë dhe ekonomisë së vendit.

Për një shfytëzim sa më efektiv të spektrit AKEP, me Vendimin e Këshillit Drejtues Nr.2662, datë 28.12.2015 bëri miratimin e dokumentit të Tenderit Publik me Procedurë të Hapur me objekt: “*Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1970 – 1980 MHz çiftuar me 2160- 2170 MHz dhe 5 MHz spektër i paçiftuar 1915 – 1920 MHz*” dhe Njoftimin për Tender Publik. Hapja e ofertave u bë në datën 15.02.2016. Në përfundim të procesit dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, AKEP me anë të VKD Nr. 2677, datë 21.04.2016, pajisi ofertuesin fitues “Plus Communication” sh.a. me Autorizimin Individual përkatës.

---

<sup>1</sup> I konfirmuar edhe nga Raporti i ITU 2016 “Measuring the Information Society Report”

Me qëllim nxitjen e një konkurrence sa më efëente në tregun e komunikimeve elektronike dhe përdorimin sa më të frytshëm të frekuencave në rastet e kufizimit të tyre AKEP me anë të Vendimit të Këshillit Drejtues Nr.2663, datë 28.12.2015 miratoi dokumentin e Tenderit Publik me Proçedurë të Hapur me objekt: “*Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 2500-2690 MHz*”. Hapja e ofertave u bë në datën 10.03.2016. Në përfundim të procesit dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, AKEP me anë të VKD Nr. 2678, datë 21.04.2016, pajisi ofertuesin fitues “Albtelecom” sh.a.me Autorizimin Individual përkatës.

Këshilli Drejtues i AKEP me anë të Vendimit Nr.2680, datë 08.06.2016 miratoi rinovimin dhe pajisjen e sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a. me Autorizim Individual për përdorimin e frekuencave të brezit 900 dhe 1800 MHz.

*Brezi i frekuencave 3400-3600 MHz, 3600-3800 MHz* është i pashfrytëzuar. AKEP ka kryer një këshillim publik lidhur me kushtet e përdorimit e këtij brezi duke propozuar ndarjen e brezit për dhënien në përdorim.

*Brezi 800 MHz ( 790-862 MHz)* ose ndryshe i quajtur DD1 (Digital Divident 1) aktualisht është nën administrimin e AMA deri në përfundimin e procesit të kalimit nga transmetime analoge në transmetime dixhitale. Pas përfundimit të këtij procesi ky brez pritet të bëhet i disponueshëm për futjen e shërbimeve të lëvizshme, nën administrimin e AKEP.

Në zbatim të:

- Vendimit Nr. 468, datë 30.05.2013, të Këshillit të Ministrave, për “Miratimin e planit Kombëtar për zhvillimin e Broadband-it”, i ndryshuar,
- Strategjinë ndërsektoriale “Afhenda Dixhitale e Shqipërisë 2015-2020” si dhe
- ecurinë e deritanishme të procesit të kalimit të transmetimeve audiovizive nga analoge në dixhitale

parashikohet që viti 2017 të jetë vit kur ky brez do të kalojë në administrimin e AKEP dhe do të bëhet e mundur futja e shërbimeve të lëvizshme në brezin 800 MHz.

Për të paraprirë në kohë këto proçese, AKEP nëpërmjet një grupi studimi të ngritur me Urdhërin Nr. 1498, datë 21.07.2015 për “Kryerjen e studimit mbi administrimin dhe përdorimin e brezit të frekuencave 790-862 MHz”, i cili bazuar ne rekomandimet e ITU dhe CEPT vlerëson se spektri i disponueshëm është 2x30 MHz me një Gap dulpeks prej 11 MHz, dhe madhësia e bllokut njësi është 5 MHz i çiftuar.

Bazuar në përcaktimet dhe rekomandimet ndërkombëtare si dhe në eksperiencat e vendeve të tjera me marrjen në administrim të spektrit (sic përcaktohet në PKF të miratuar me VKM Nr.466, datë 27.2.2013) AKEP do të realizojë një këshillim publik me tregun.

Ky këshillim publik duhet të bëjë të mundur që nëpërmjet çështjeve që do të trajtojnë të marrë maksimumin e mundshëm për ndërtimin e një procedure të saktë, transparente, asnjëanëse për dhënien në përdorim të tyre.

### ***Portabiliteti i numrit***

Në mënyrë të vazhdueshme AKEP ka ndjekur funksionimin e sistemit të portabilitetit të numrit CRDB.

Në përgjithësi procesi ka ecur mirë. Një tablo me shifrat e numrave të bartur në fund të viteve 2015 dhe 2016 paraqitet si më poshtë:

<b>Shërbimi Telefonik</b>	<b>I lëvizshëm</b>		<b>Fiks</b>	
	2015	2016	2015	2016
Viti				
Numra të bartur	<b>95,782</b>	<b>150,703</b>	<b>2,661</b>	<b>1,361</b>

Sipas të dhënave të CRDB (bazës së të dhënave të këtij sistemi) rezulton një shifër prej afro 150,703 numrash mobile dhe 1,361 numrash fiks të bartur.

Monitorimi i spektrit të frekuencave është kryer minimumi një herë në vit për pikat kryesore të trasmetimit.

### ***Inspektime tek sipërmarrësit e komunikimeve elektronike***

Për vitin 2016 janë kryer 51 inspektime tek sipërmarrësit e komunikimeve elektronike të regjistruar në regjistrin e sipërmarrësve që ofrojnë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike sipas regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm.

Gjatë këtyre inspektimeve u konstatua se 15 sipërmarrës që ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike në përputhje me kushtet e Autorizimit të Përgjithshëm (disa prej të cilëve iu lanë disa detyra dhe rekomandime) dhe 36 sipërmarrës nuk kishin zbatuar rregulloret e miratuar nga AKEP dhe për këto shkelje u vendosën masa administrative me gjobë sipas ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Nga data 19 shtator deri më 30 dhjetor 2016 janë arkëtuar në llogarinë bankare të AKEP përkatësisht shumën 3.898.022 lekë nga sipërmarrësit debitorë.

### ***Monitorimi i cilësisë së shërbimit***

Gjatë vitit 2016 AKEP ka kryer monitorimin e cilësisë së shërbimit të qyteteve dhe akseve rrugore për teknologjitë GSM/UMTS/LTE

Në vijim të zbatimit të “Projektit për ngritjen e Sistemit Kombëtar të Monitorimit të spektrit të frekuencave” hartuar me konsulencën e ekspertëve të ITU-se, është bërë i mundur ndërtimi

i 2 (dy) Stacioneve Fikse te Monitorimit (RFMS) në Pinet dhe Krujë, për monitorimin e zonave të rëndësishme Tiranë – Durrës – Aeroporti i Rinasit, si zona mjaft të okupuara nga radiokomunikimet dhe është në proces ndërtimi i dy stacioneve fikse monitorimi në Shkodër e Vlorë.

Me datë 21.03.2016 është zhvilluar procedura e prokurimit me objekt “Zhvillimi i Sistemit Kombëtar të Monitorimit të Spektrit të Frekuencave, pajisje për Stacion të Thjeshtë Fiks, Monitorimi (SRFMS) në Shkodër dhe Vlorë”. Procedura ka kaluar në disa faza ankimimi, proces gjyqësor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë dhe Gjykatën Administrative të Apelit. Në datë 14.12.2016 vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit është pezulluar me vendim të Gjykatës të Lartë, e cila nuk ka dalë akoma me vendim përfundimtar.

Nëpërmjet stacioneve Fikse të Monitorimit në Pinet dhe Krujë, kryhet monitorimin 24 orë i brezit të frekuencave 20-3000 MHz, në një zonë 70 km rreth Tiranës dhe Durrësit, duke përfshirë dhe aeroportin ndërkombëtar në Rinas. Këto stacione kontrollohen në distancë nga Qendra Kryesore e Kontrollit (MCC), pjesë e Qendrës Kombëtare të Monitorimit të Frekuencave, në Tiranë.

Me qëllim detyrimin e sipërmarrësve të cilët ndërtojnë ose përdorin rrjete të komunikimeve elektronike dhe ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike, që të zbatojnë kushtet e parashikuara në ligjin Nr. 9918 datë 29.05.2008 “Për komunikimet elektronike në RSH” i ndryshuar dhe Rregulloren Nr. 22, datë 24.06.2011 “*Mbi kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës së rrjeteve kabllore urbane dhe rrjeteve me fibra optike ndërurbane të komunikimeve elektronike*” për të mos rrezikuar jetën dhe shëndetin e qytetarëve, AKEP gjatë vitit 2016 në bashkëpunim me OSHEE dhe sipërmarrësit e rrjeteve të komunikimeve elektronike kreu dhe mbikëqyri punën për largimin dhe sistemimin e kabllave nga shtyllat e OSHEE dhe shtyllat e ndriçimit të Bashkive, përfshirë trasversime të ulëta.

Gjatë vitit 2016 u arrit të bëhet një përmirësim rrënjësor i këtyre rrjeteve në qytetet kryesore të vendit, ku u shmangën rrjetet e komunikimeve elektronike nga rrjetet e energjisë dhe në shumicën e rrugëve kryesore dhe qendra tashmë kanë përfunduar ose është drejt përfundimit. Kjo është një arritje e rëndësishme për garancinë e rrjeteve në uljen e rrezikshmërisë të këtyre instalimeve të rrezikshme për jetën e personelit të sipërmarrësve, përmirësimi i mirëmbajtjes si të rrjeteve të komunikimeve elektronike, por dhe të energjisë dhe ndriçimit.

Bazuar në analizën e kryer nga raportimet e marra, është arritur në konkluzionin se nga 151 sipërmarrës vetëm 82 sipërmarrës kanë përmbushur plotësisht detyrimet ligjore dhe ato rregullatore. Procesi është në vazhdim.

Gjithashtu, bazuar në kërkesat e ardhura nga institucione si Autoritetit të Mediave Audiovizive në zbatim të detyrimeve ligjore të ligjit nr.9918 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, neni 15, i ka kërkuar ofruesve të shërbimit të Internetit (ISP) mbylljen e faqeve të internetit të cilat kryejnë transmetimin e evenimenteve sportive shqiptare apo të huaja në dispozicion të publikut, në mënyrë të kundraligjshme.

## ***Domain-ët***

Numri i domain-eve të regjistruar për vitin 2016 është 5799 dhe kemi një numër total prej 18,078 domain-e. Në total verifikohet një rritje mbi mbi 12% të domain-eve krahasur me vitin 2015. Është evidentuar një rritje e konsiderueshme e domain-eve tek regjistrarët e akredituar duke e lënë AKEP-in nga regjistrari dominues në vendin e tretë.

### ***Gjatë vitit 2016:***

- janë hartuar dhe nxjerrë nga AKEP,6 (gjashtë) akte administrative të karakterit normativ (Rregullore),
- është përfaqësuar AKEP dhe janë ndjekur çështjet gjyqësore ku AKEP është palë në:
  - 24 (njëzet e katër) çështje në shqyrtim në Gjykatën kompetente të Shkallës së parë,
  - 6 (gjashtë) çështje në shqyrtim në Gjykatën kompetente të Apelit,
  - 1 (një) çështje në shqyrtim në Gjykatën e Lartë.
- është shqyrtuar dhe është marrë vendim për zgjidhjen e 1 (një) mosmarrëveshjeje ndërmjet sipërmarrësve që ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike,
- janë shqyrtuar dhe dhënë rekomandime (ose janë në proces) për zgjidhjen e 30 (tridhjetë) mosmarrëveshjeve ndërmjet pajtimtarëve dhe sipërmarrësve që ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike,
- janë shqyrtuar dhe është marrë vendim (ose janë në proces) për 16 (gjashtëmbëdhjetë) ankime administrative të palëve ankimuese kundra akteve të nxjerra nga AKEP.

### ***Të tjera***

Me Vendim të Kuvendit të Shqipërisë nr.88/2015 të Kuvendit të Shqipërisë “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)” është miratuar struktura organizative dhe organika e AKEP, e përbërë nga 73 punonjës.

Gjatë vitin 2016, AKEP përmbushi detyrimet ligjore që burojnë nga legjislacionin në fuqi për marrdhënie të punës të nëpunësve civil dhe për punonjësit mbështetës, si për përmbushjen e detyrave funksionale, ashtu dhe për rritjen e performancës.

## **2.2 Zhvillimi i tregut të shërbimeve postare**

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, me synim përmbushjen e qëllimit të përcaktuar në Ligjin 46/2015, si autoriteti kombëtar përgjegjës për rregullimin dhe

mbikqyrjen e shërbimeve postare në Republikën e Shqipërisë, ka përmbyllur detyrimin ligjor mbi hartimin dhe miratimin e kuadrit të plotë rregullator në zbatim të Ligjit 46/2015.

Konkretisht, AKEP gjatë vitit 2016, në fushën e rregullimit të shërbimeve postare ka filluar dhe përfunduar procedurat përkatëse ligjore për hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore si më poshtë:

- Rregullore nr.41, datë 03.03.2016 “Për ndarjen e llogarive dhe llogaritjen e kostove të shërbimit universal postar”,
- Rregullore nr.42, datë 03.03.2016 “Për llogaritjen e kostove neto të shërbimit universal postar
- Rregullore nr.45, datë 27.10.2016 “Metodikë e inspektimit të veprimtarisë së ofruesve të shërbimeve postare”

Hyrja në fuqi e Ligjit 46/2015, solli ndryshim në sistemin e licensave/autorizimeve të ofruesve të shërbimit postar. AKEP me Vendimin e Këshillit Drejtues Nr.2581, datë 22.06.2015, pajisi subjektin Posta Shqiptare sh.a., me Autorizim Individual për ofrimin e shërbimit universal postar, me afat 5 vjeçar. Gjithashtu në dhjetor 2015 përfundoi procesi i transpozimit të licensave të përgjithshme për ofrimin e shërbimeve postare në çertifikata konfirmimi njoftimi sipas sistemit të autorizimit të përgjithshëm për 11 subjekte ofrues të shërbimeve postare, duke përdorur modulën on-line të AKEP për këtë qëllim.

Zhvillimet e mëdha në komunikimet elektronike paraqesin sfida të mëdha për ofruesit e shërbimeve postare për shkak të rritjes së ndjeshme të mundësive të zëvendësimit të shërbimeve postare me shërbimet e rrjeteve elektronike të cilat kanë çuar në reduktime të ndjeshme të numrit total të objekteve postare kudo në botë. Megjithatë zhvillimet në komunikim elektronik dhe tregtinë elektronike kanë rritur kërkesën për pakot/paketat postare ndërkombe. Me zhvillimet në vitet e fundit të aksesit broadband dhe tregtisë elektronike në Shqipëri, këto tendenca botërore të shërbimeve postare kanë filluar të shfaqen edhe në Shqipëri.

Numri total i objekteve postare të pranuar gjatë vitit 2016 nga Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare gjatë vitit 2016 ishte rreth 24 milion, që përbën një rritje me rreth 13% në krahasim me vitin 2015. Posta Shqiptare sh.a vazhdon të ruajë pozicionin e saj dominues në tregun e shërbimeve postare, duke zënë rreth 94% të tregut të shërbimit postar kundrejt 6% që zënë ofruesit e tjerë të shërbimeve postare.

Në fund të vitit 2016, numri i zyrave postare të hapura për publikun ishte 883, në raport mesatarisht një zyrë shërbimi për çdo 32.5 km<sup>2</sup> dhe për numrin e 5,228 banorëve.

Për sa i përket tarifave të shërbimit postar në Shqipëri nga analizat e AKEP rezulton se tarifat e shërbimit universal postar të ofruar nga Posta Shqiptare janë shumë të lira dhe nuk kanë

probleme përballueshmërie. Tarifat e Posta Shqiptare nuk kanë ndryshuar që prej vitit 2002, dhe ato janë deri në 13 herë më të lira se në vendet e BE/rajonit. Megjithatë struktura e tarifave të objekteve postare të Posta Shqiptare ka diferenca të mëdha me ato të vendeve të BE dhe tarifat shumë të ulëta të disa objekteve postare dhe mos-rishikimi i tarifave për një periudhë shumë të gjatë kohore krijojnë probleme për stimujt për ofrim efikas të shërbimit universal postar.

Përdorimi mesatar për banor i shërbimeve postare në Shqipëri është shumë i ulët krahasuar me vendet e BE dhe rajonit. Megjithatë shërbimet postare në vendet e tjera kanë shënuar rënie të ndjeshme në sasi totale të objekteve postare (sidomos letra), numri i objekteve postare për frymë në vendet e BE dhe rajonit është shumë më i lartë (50-252 letra/banorë) se në Shqipëri me rreth 10.1 objekte postare për banorë në vit.

### **3. Baza ligjore**

Funksionimi dhe veprimtaria e AKEP si organ administrativ dhe rregullator i fushës së komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare mbështetet kryesisht në bazën ligjore (ligje, akte nënligjore, akte të brendshme) si më poshtë vijon:

#### **3.1 Legjislacioni material i fushës:**

1. Ligj nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 9918),
2. Ligj nr. 46/2015 datë 7.05.2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”,
3. Plani Kombëtar i Frekuencave (PKF) miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 466, datë 27.2.2013,
4. Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 468, datë 30.05.2013 “Për miratimin e planit kombëtar për zhvillimin e Broadband-it”, i ndryshuar,
5. Vendim nr. 468, datë 30.5.2013, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Planit Kombëtar për Zhvillimin e Broadband-it” i ndryshuar. (Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 300, datë 8.4.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 468, datë 30.5.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e planit kombëtar për zhvillimin e Broadband-it”,
6. Vendim i Këshillit të Ministrave, nr.1252 datë 10.9.2008, “Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënie të së drejtës së përdorimit të frekuencave”, i ndryshuar,
7. Vendim i Këshillit të Ministrave nr.635 datë 15.07.2015 “Për disa shtesa në Vendimin nr. 1252, datë 10.9.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënie të së drejtës së përdorimit të frekuencave”, të ndryshuar,
8. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 599, datë 23.07.2010, “ Mbi miratimin e pagesave që kryhen në AKEP për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, të numrave dhe serive numerike” i ndryshuar;

9. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 25, datë 14.01.2014 për “Disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 599, datë 23.07.2010, i ndryshuar, “Mbi miratimin e pagesave që kryhen në AKEP, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, të numrave dhe serive numerike”,
10. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 546, datë 13.6.2013 “Për miratimin e rregullit teknik për pajisjet radio dhe fundore të telekomunikacioneve dhe njohjen e ndërsjellë të vlerësimit të konformitetit të tyre”,
11. Udhëzim i Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike nr. 4038, datë 4.9.2015 “Për përcaktimin e shërbimeve universale postare, që ofrohen pa pagesë, për personat e verbër dhe pjesërisht të verbër”,
12. Udhëzim nr. 30, datë 23.12.2014 "Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet e radio-komunikacionit" i ndryshuar, (Udhëzim nr. 28, datë 12.1.2015 “Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 30, datë 23.12.2014 "Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet e radio-komunikacionit"),
13. Urdhër i Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike nr. 6174, datë 16.12.2015 “Për përcaktimin e dendësisë së pikave të aksesit për ofrimin e shërbimit universal postar”; etj.
14. Ligji nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e të drejtës së kalimit”.

### **3.2 Kuadri ligjor që rregullon veprimtarinë si organ administrativ**

1. Ligj nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” (ligji nr. 8480),
2. Ligj nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (ligji nr. 8485),
3. Ligj nr.152/2013, datë 30.05.2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij (ligji nr.152),
4. Ligj nr. 9584, datë 17.07.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj” i ndryshuar (ligji nr. 9584),
5. Ligj nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar (ligji nr. 7961),
6. Ligj nr. 10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” (ligji nr. 10 296),
7. Ligj nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin nr.120/2014, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar,
8. Ligj nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar (ligji nr. 9367),
9. Ligj nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar me ligjin nr. 9800, datë 10.09.2007, ligjin nr. 9855, datë 26.12.2007, ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009, ligjin nr. 10309, datë 22.07.2010, ligjin nr. 22/2012, ligjin nr. 131/2012, dhe ligjin nr. 182/2014 "Për prokurimin publik",



10. Vendim i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nr.88/2015 datë 15.10.2015 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP),
11. Vendim i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e fondit të shpenzimeve, për vitin 2016, për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike e Postare”,
12. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 545, datë 11.8.2011, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në Kryeministri, aparatet e ministrave të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit”, të ndryshuar”,
13. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,
14. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 918 datë 29.12.2014 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike”; etj.

### **3.3 Kuadri nënligjor rregullator**

Rregullore:

1. Për llogaritjen e kostove neto të shërbimit universal postar,
2. Për ndarjen e llogarive dhe llogaritjen e kostove për ofrimin e shërbimit universal postar,
3. Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike mbi shërbimet e ofruara nga operatorët dhe ofruesit e shërbimeve postare,
4. Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ndërmjet përdoruesit dhe ofruesit të shërbimit postar dhe mosmarrëveshjeve ndërmjet ofruesve të shërbimit postar,
5. Për autorizimin e përgjithshëm për ofrimin e shërbimive postare,
6. Mbi masat teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike,
7. Për ofrimin e shërbimit universal postar,
8. Për përdorimin e përbashkët të infrastrukturës passive,
9. Për inspektimin, monitorimin e spektrit të frekuencave dhe masat administrative,
10. Për administrimin e interferencave,
11. Për kushtet e përdorimit të frekuencave dhe kërkesat për pajisjet radio që përdoren pa autorizim individual,
12. Mbi termat e përgjithshme të kontratës së pajtimit,
13. Për dhënien e autorizimit individual për përdorimin e frekuencave,
14. Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet pajtimtarëve dhe sipërmarrësve të komunikimeve elektronike,
15. Mbi publikimin e informacionit për tarifatat si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike,
16. Për përmbajtjen, formën dhe funksionimin e regjistrimit elektronik të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë,

17. Rregullore për pajisjet radio dhe fundore të telekomunikacioneve dhe njohjen e konformitetit të tyre,
18. Për zgjedhjen dhe parazgjedhjen e bartësit,
19. Për kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës së rrjeteve kabllore urbane dhe infrastrukturës;
20. Për procedurën dhe mënyrën e llogaritjes së nivelit të pagesave vjetore që kryhen në AKEP për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare,
21. Për Autorizimin e Përgjithshëm,
22. Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve,
23. Për aksesin dhe interkoneksionin,
24. Për treguesit e cilësisë së shërbimi dhe tabelat e matjeve,
25. Për dhënien e licencës “Autoritet i llogarive detare” dhe Kodin AAIC”,
26. Për funksionimin e ATLAS-it
27. Për portabilitetin e numrit,
28. Për shërbimet radioamatore në Republikën e Shqipërisë,
29. Për caktimin dhe përdorimin e numrave dhe serive numerike,
30. Për analizën e tregut,
31. Për regjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve nën.AL dhe nën domain-et .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al,
32. Për dhënien e licensës për stacionet radio të avionit,
33. Për dhënien e licensës për stacionet radio të anijes,
34. Për dhënien e certifikatës operatorit radiodetar,
35. Për dhënien e autorizimit për stacionet radio bregdetare,
36. Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe ose shërbimeve të komunikimeve elektronike.

#### Rregulla:

1. dhe udhëzime për ndarjen e llogarive dhe llogaritjen e kostos për sipërmarrësit me FNT,
2. Për administrimin e kodeve të pikave të sinjalizimit kombëtar (NSPC) dhe ndërkombëtar (ISPC) për interkoneksionin e rrjeteve.

#### Në aspektin e rregullave të funksionimit të brendshëm:

1. AKEP me datë 16.02.2017 me vendimet nr.6 dhe nr.7 të Këshilli Drejtues, miratoi përkatësisht “Rregullore e Brendshme e funksionimit të administratës së AKEP” dhe “Rregullore e Brendshme e funksionimit të Këshillit Drejtues të AKEP” me qëllim krijimin e kuadrit të nevojshëm normativ për garantimin e funksionimit sa më efektiv, të drejtë, transparent, të bazuar ligjërisht dhe të balancuar të veprimtarisë vendimmarrëse të Këshillit Drejtues (KD) dhe asaj ekzekutive, të administratës së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP).

### **3.4 Përmirësim i bazës ligjore në periudhën raportuese (viti 2016)**

AKEP ka miratuar Rregulloret si më poshtë vijon:

1. Rregullore për “Ndarjen e kostove dhe llogaritjen e kostove të ofrimit të shërbimit universal postar”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr.2670 datë 03.03.2016
2. Rregullore për “Llogaritjen e kostove neto të shërbimit universal postar”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr.2671 datë 03.03.2016
3. Rregullore për mënyrë e zbatimit të “Portabilitetit të numrit”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr.2689 datë 22.09.2016
4. Rregullore për “Monitorimin e spektrit të frekuencave” miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr.2690 datë 13.10.2016
5. Rregullore “Metodika e inspektimit të veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike” miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr.2695 datë 27.10.2016
6. Rregullore “Metodika e inspektimit të veprimtarisë së ofruesve të shërbimeve postare”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr.2694 datë 27.10.2016

Rishikimi i Legjislacionit sekondar synon në:

- Zbatimin e Direktivave të BE mbi liberalizimin e tregut postar;
- Forcimin e kërkesave për zhvillimet teknologjike bashkëkohore;
- Zbatimin e procedurave lehtësuese për subjektet që kërkojnë të ofrojnë shërbime postare;
- Forcimin e kontrollit dhe monitorimit të tregut.

### **3.5 Sfidat e së ardhmes**

Përmirësim i vazhdueshëm i akteve rregullatore dhe përshtatja me ndryshimet ligjore përkatëse (legjislacionin), përfaqësimi me kuadrin rregullator të BE në fushën e komunikimeve elektronike dhe postare.<sup>2</sup>

## **4. Përshkrim i Institucionit**

### **4.1 Statusi dhe Këshilli Drejtues i AKEP**

---

<sup>2</sup> Bazuar në nenin 70 të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit, sipas të cilit Shqipëria do të përpiqet të sigurojë që ligjet e saj ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm të shkojë gradualisht drejt përputhjes me legjislacionin evropian por njëkohësisht duhet të sigurojë që legjislacioni ekzistues dhe i ardhshëm të zbatohet dhe imponohet si duhet.

**Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare** është organi rregullator në fushën e komunikimeve elektronike dhe të shërbimit postar, i cili mbikqyr kuadrin rregullator të përcaktuar nga ligji për komunikimet elektronike, nga ligji për shërbimin postar dhe nga politikat e zhvillimit, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave. Roli, funksionet dhe kompetencat institucionale si organ rregullator i fushës së komunikimeve elektronike dhe shërbimit postar përcaktohen në legjislacionin material për komunikimet elektronike dhe shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë.

#### **4.2 Juridiksioni territorial**

AKEP është organ person juridik, publik, jobuxhetor, i krijuar me ligj të veçantë nr. 9918 dhe ka juridiksion territorial në tërë territorin e Republikës së Shqipërisë. Selia qendrore e AKEP është vendosur në Tiranë dhe me “Vendimin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nr.88/2015 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)”, ka katër sektorë Rajonalë të monitorimit dhe inspektimit: Krujë, Shkodër, Korçë dhe Vlorë.

#### **4.3 Misioni**

AKEP është një rregullator i pavarur dhe pararendës për tregjet e telekomunikacioneve dhe postare duke kërkuar të arrijë një kuadër rregullator që nxit një mjedis të favorshëm për investitorët dhe ofron zgjidhje, çmim dhe cilësi më të mirë për të gjithë përdoruesit e shërbimeve të telekomunikacioneve dhe postare në Shqipëri.

#### **4.4 Vlerat thelbësore të AKEP**

- Integriteti,
- Paanësia,
- Transparenca,
- Profesionalizmi,
- Efikasiteti.

#### **4.5 Struktura**

Për kryerjen e veprimtarisë dhe për realizimin e funksioneve të tij, AKEP-i funksionon sipas strukturës organizative të miratuar me “Vendimin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nr.88/2015 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)”:

- Këshilli Drejtues;
- Kabineti i Kryetarit;
- Sekretar i KD;
- Drejtoria e Administrimit të Burimeve të Fundme Autorizimeve dhe Faciliteteve;

- Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit dhe e Zhvillimit të Broadband;
- Drejtoria e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit;
- Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe Pagesave;
- Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe e Administrimit të Brendshëm;
- Drejtoria e Rregullimit Ekonomik dhe e Statistikave;
- Drejtoria e Shërbimeve Postare dhe Integritimit;
- Drejtoria e Monitorimit të Frekuencave, Cilësisë dhe Inspektimit.

#### 4.6 Kompetencat e AKEP

- Ligji nr.9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (neni 8) përcakton këto kompetenca për AKEP:
  1. Mbikëqyr, kontrollon dhe monitoron veprimtaritë e sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike, në përputhje me Ligjin nr.9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet e tjera në zbatim të tij;
  2. Rregullon aksesin dhe interkoneksionin midis rrjeteve të komunikimeve elektronike, në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr.9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe siguron që sipërmarrësit të mos diskriminohen dhe të kenë mundësi të barabarta, kushte transparente, objektive dhe të ndershme;
  3. Miraton ofertën e referencës për aksesin dhe/ose interkoneksionin, si dhe ofertën e referencës për akses të hapur në rrjetin lokal të sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme në treg, të cilat duhet të jenë në përputhje me kërkesat e Ligjit 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me aktet nënligjore, si dhe tarifa të orientuara në kosto;
  4. Përcakton sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në treg;
  5. Kryen regjistrimin e sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike në përfundim të procesit të njoftimit;
  6. Ndërmerr dhe përcakton masat mbrojtëse ndaj sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike, për të mos lejuar praktika antikonkurrese;
  7. Bashkëpunon me Ministrin për hartimin e Planit Kombëtar të Frekuencave;
  8. Përgatit Planin e Përdorimit të Frekuencave dhe administron brezat e frekuencave të caktuara;
  9. Për qëllime civile, për përdorim publik ose privat, me përjashtim të brezit të frekuencave, të caktuara për transmetime radio e televizione, të cilat administrohen nga KKRT-ja;
  10. Monitoron përdorimin e spektrit të frekuencave, në përputhje me Planin Kombëtar të Frekuencave dhe Planin e Përdorimit të Frekuencave;

11. Lëshon Autorizimet Individuale për përdorimin e frekuencave;
12. Kryen procedurat e përcaktuara, sipas Ligjit nr.9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, pas miratimit përkatës;
13. Bashkërendon punën me administratat e vendeve fqinje dhe të vendeve të tjera për caktimin dhe përdorimin e radiofrekuncave, për pjesën e spektrit që administron;
14. Harton, miraton dhe administron Planin Kombëtar të Numeracionit për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë;
15. Cakton numrat dhe seritë numerike të sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike publike dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike;
16. Administron domain cc.TLD.al, nëndomanet e tij , si edhe ENUM;
17. Merr masat administrative, në përputhje me Ligjin nr.9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar në rast të shkeljeve të këtij ligji dhe të akteve të nxjerra në zbatim të tij;
18. Mbikëqyr respektimin e kërkesave të ligjit për tarifatat e shërbimeve të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun dhe merr masat e nevojshme rregullatore në zbatim të këtij ligji;
19. Menaxhon dhe administron fondin e shërbimit universal;
20. Zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike si dhe mosmarrëveshjet ndërmjet pajtimtarëve dhe sipërmarrësve, sipas parashikimeve të Ligjit nr.9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
21. Krijon, mirëmban dhe përditëson bazën e të dhënave elektronike për sektorin e komunikimeve elektronike dhe siguron që këto të dhëna, në formë informacioni, t’i bëhen të vlefshme publikut, në përputhje me rregullat për informimin publik dhe të ruajtjes së konfidencialitetit;
22. Mbledh të dhëna dhe informacion nga sipërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike;
23. Nxjerr rregulloret në zbatim të Ligjit nr.9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar , akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi, të cilat janë të detyrueshme për t’u zbatuar;
24. Kryen njohjen e konformitetit për pajisjet “radio” dhe pajisjet fundore të telekomunikacioneve;
25. Merr masat, që sipërmarrësit e rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike të zbatojnë detyrimet, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e interesave të vendit, të sigurisë publike edhe në rast lufte apo gjendje të jashtëzakonshme;
26. Bashkëpunon me organizatat, kombëtare dhe ndërkombëtare, në fushën e komunikimeve elektronike;
27. Kryen procedurat për përcaktimin e sipërmarrësit të shërbimit universal, sipas kërkesave të përcaktuara në kreun V të këtij ligji;
28. Përcakton rregullat për funksionimin e shërbimit të radiondërlidhjes bregdetare;

29. Përcakton rregullat dhe kërkesat teknike për funksionimin e shërbimeve radioamatore në Republikën e Shqipërisë;
  30. Siguron disponueshmërinë e një baze qendrore të dhënash për portabilitetin e numrit;
  31. Përcakton masa për rregullimin e tarifave, si dhe çmimet maksimale që mund të aplikohen në një seri të caktuar të numrave të përdorur për shërbimet me vlerë të shtuar, premium, me qëllim mbrojtjen e konsumatorëve.
- Ligji nr. 46 /2015 datë 07.05.2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë, (neni 9) për rregullimin postar përcakton këto kompetenca për AKEP:
    1. Jep Autorizimet, në bazë të përcaktimeve të Ligjit nr. 46 /2015 datë 07.05.2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë dhe rregullave të miratuara në zbatim të tij;
    2. Mbikëqyr, kontrollon dhe monitoron veprimtaritë e ofruesve të shërbimeve postare, në përputhje me Ligjin nr. 46 /2015 datë 7.05.2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet e tjera në zbatim të tij dhe merr masa administrative, në rast të shkeljeve të këtij ligji dhe të akteve të nxjerra në zbatim të tij;
    3. Mbikëqyr respektimin e kërkesave të Ligjit nr. 46 /2015 datë 7.05.2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë” për tarifën e shërbimeve postare dhe merr masat e nevojshme rregullatore në zbatim të tij;
    4. Harton dhe miraton rregulloret në zbatim të Ligjit nr. 46 /2015 datë 7.05.2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë të cilat janë të detyrueshme për t’u zbatuar;
    5. Bashkëpunon me organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e rregullimit të shërbimeve postare;
    6. Përcakton ofruesin e shërbimit universal postar, sipas kërkesave të përcaktuara në Ligjin nr. 46 /2015 datë 7.05.2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë dhe mbikëqyr përmbushjen e detyrimeve të shërbimit universal postar;
    7. Kontrollon respektimin e kërkesave thelbësore nga ofruesit e shërbimeve postare;
    8. Harton dhe miraton standardet dhe kushtet teknike për ofrimin e shërbimit postar, në përputhje me rekomandimet e organizatave ndërkombëtare, përfshirë standardet për ofrimin e shërbimit universal postar;
    9. Nxit konkurrencën e lirë dhe efçente, ndërmjet ofruesve të shërbimeve postare, për të garantuar transparencën, mosdiskriminimin dhe ndershmërinë;
    10. Mbledh dhe përpunon të dhëna statistikore dhe financiare nga ofruesit e shërbimeve postare, në përmbushje të detyrave rregullatore në zbatim të Ligjit nr. 46 /2015 datë 7.05.2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë, duke garantuar ruajtjen e sekretit për informacionin e dhënë;
    11. Miraton kushtet dhe termat e përgjithshëm të ofrimit të shërbimit universal postar;
    12. Rregullon tarifën e shërbimit universal postar dhe shërbimeve të tjera specifike, të përcaktuara nga Ligji nr. 46 /2015 datë 7.05.2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë;

13. Zgjidh mosmarrëveshjet midis ofruesve të shërbimit postar;
14. Mbron të drejtat e përdoruesve të shërbimeve postare dhe zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet përdoruesve dhe ofruesve të shërbimeve postare;
15. Bashkëpunon me Autoritetin e Konkurrencës dhe Autoritetin për Mbrojtjen e Konsumatorit në çështjet me interes të përbashkët;
16. Përfaqëson Republikën e Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare rregullatore të shërbimeve postar.

## **5. Organizimi institucional**

### **5.1 Parimet e Organizimit dhe Funkcionet e Administratës**

Administrata e AKEP-it organizohet mbështetur në parimin e shkallëzimit, sipas të cilit vartësit, në çdo nivel, duhet të ndjekin zinxhirin vendimmarrës dhe të komunikojnë me eprorët e tyre nëpërmjet eprorit më të afërt në hierarki, si dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me eprorin direkt (titullarin e institucionit).

Njësitë organizative ngrihen dhe emërtohen sipas funksioneve rregullatore dhe administrative të AKEP-it të përcaktuara në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 i ndryshuar dhe ligjin nr.46/2015 në mënyrë të tillë që të lejojë një ndarje të harmonizuar të funksioneve brenda secilës prej këtyre njësisve organizative dhe të krijojë një mundësi kontrolli dhe mbikëqyrje në mënyrë që asnjë nga njësitë apo zyrtarët të mos ketë kontroll të plotë mbi asnjë proces.

Njësia më e lartë organizative është drejtoria.

Funksionet që kryhen nga administrata e AKEP-it grupohen në tre fusha kryesore:

- a) Funksione rregullatore të fushës;
- b) Funksione të ofrimit të shërbimeve për të tretët sipas legjislacionit;
- c) Funksione të shërbimeve të brendshme mbështetëse.

Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe administrimi i shërbimeve mbështetëse për institucionin Çështjet që lidhen me zhvillimin dhe menaxhimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore si dhe administrimin e shërbimeve mbështetëse për institucionin përbëjnë objektin e veprimtarisë të Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Administrimit të Brendshëm të riorganizuar sipas strukturës dhe organikës së re të AKEP-it.

### **5.2 Struktura organizative e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare**

Të gjendur në kushtet e nevojës së domosdoshme të ushtrimit të veprimtarisë normale me qëllim përmbushjen e objektivave rregullatore në zbatim të ligjit material dhe politikave sektoriale të zhvillimit të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave, si dhe në kuadër të përafritimit



të plotë të legjislacionit në përputhje me direktivat e Parlamentit dhe Komisionit EU duke përfshirë edhe organizimin dhe funksionimit e strukturës dhe organikës si organ rregullator me ato të vendeve të Bashkimit Europian, është përcjellë kërkesa e AKEP-it për miratimin nga Kuvendi i Shqipërisë të strukturës dhe organikës duke e përshtatur me kushtet dhe rrethanat aktuale të fushës dhe legjislacionit, si dhe frymës së Qeverisë për reduktimin e shpenzimeve dhe funksionimin me struktura sa më profesionale dhe eficiente.

Në zbatim të Vendimit të Kuvendit të Shqipërisë nr.88/2015 “Për miratimin e struktues, organikes dhe kategorizimit të pozicioneve të punes të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)” është miratuar struktura organizative dhe organika e AKEP, e përbërë nga 73 punonjës.

Përmirësimet në strukturë, kanë qenë në fokusin e politikave të burimeve njerëzore me qëllim rritjen e efikasitetit të veprimtarisë së punës së institucionit, duke forcuar bashkërendimin dhe koordinimin e punëve midis strukturave, përshtatjen e tyre me detyrat e reja që burojnë nga objektivat strategjike të institucionit si dhe arritjen e standardeve evropiane.

Implementimi i strukturës së re, miratuar me Vendim të Kuvendit të Shqipërisë nr.88/2015 të Kuvendit të Shqipërisë “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)” në zbatim të Ligjit Nr.152/2013 “Për nëpunësin Civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi ka mundësuar rritjen e efikasitetit të stafit dhe cilësisë së kapaciteteve të burimeve njerëzore, në përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe rritjes së fleksibilitetit dhe transparencës në ushtrimin e funksioneve, në gjithë veprimtarinë e punës së AKEP.

Nëpërmjet strukturës përkatëse janë mbikëqyrur dhe menaxhuar burimet njerëzore, duke zbatuar ndryshimet në legjislacionin për shërbimin civil, në respektim të parimeve kryesore të tij, për të mundësuar reduktimin e subjektivizmit në procesin e konkurrimit, përzgjedhjes së kandidatëve të kualifikuar profesionalisht, bazuar në merita, transparencë dhe llogaridhënie. E reja e kësaj strukture qëndron te konfigurimi i organigramës sipas zhvillimeve të tregut të komunikimeve elektronike dhe krijimit të një drejtorie të re për rregullimin postar në Shqipëri.

### **5.3 Këshilli Drejtues**

Funksioni i Këshillit Drejtues është drejtimi kolegjial nëpërmjet vendimmarrjes i veprimtarisë së AKEP-it për përmbushjen e përgjegjësisë, detyrave dhe funksioneve të tij, të përcaktuara në ligjin nr. 9918 dhe ligjin nr.46/2015 për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë.

Këshilli Drejtues përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët zgjidhen nga Kuvendi, me propozimin e Këshillit të Ministrave, për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje jo më shumë se një herë. Kuvendi cakton kryetarin, ndërmjet anëtarëve të Këshillit Drejtues. Kryetari i

Këshillit Drejtues është drejtuesi ekzekutiv i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

Figura 1- Organigrama e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare





Figura 2- Përbërja strukturore sipas funksioneve në AKEP



Forcimi i kapaciteteve institucionale ka qenë një nga prioritetet e vitit 2016, pasi është konsideruar si një nga faktorët kryesorë për pavarësinë reale të institucionit të AKEP. Burimeve njerëzore janë orientuar në drejtim të rritjes profesionale të stafit dhe të nivelit të ekspertizës, forcimit dhe ruajtjes së një mjedisi pune motivues dhe llogaridhënës për punonjësit; arritjes së qëndrueshmërisë dhe vazhdueshmërisë afatgjatë të kapaciteteve administrative, si dhe përmirësimit të bazës rregullative dhe strukturës organizative të AKEP.

Risite e ligjit të nëpunësit civil janë përdorur si instrumenta për të ndërtuar sistemin e matjes së performancës reale të secilit prej nëpunësve të AKEP duke synuar rritjen e motivimit.

## 6. Kërkesat e Kuvendit nga AKEP për vitin 2016

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në kuadër të vlerësimit të veprimtarisë së AKEP për vitin 2015, me Rezolutë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2015”, për vitin 2016 rekomandonte:

1. Të rrisë përpjekjet në forcimin e rolit të autoritetit rregullator në mbrojtjen e konsumatorit në tregun e komunikimeve elektronike dhe në tregun postar, për të garantuar mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në tërësi nga sjelljet diskriminuese dhe antikonkurruese të operatorëve në tregun e komunikimeve elektronike dhe postare.
2. Të kryejë analizën e tregut të telefonisë celulare dhe të marrë vendimet përkatëse, me profesionalizëm, transparencë e paanësi, për të bërë të mundur garantimin e një tregu në mbrojtje të interesave të përdoruesve, si dhe për të garantuar një konkurrencë të ndershme dhe jodiskriminuese të operatorëve në këtë treg.
3. Të rrisë më tej angazhimin institucional dhe të kërkojë me rigorozitet sigurimin e transparencës dhe publikimin e informacionit nga ana e operatorëve për përdoruesit e shërbimeve elektronike dhe postare.
4. Të monitorojë cilësinë e shërbimit të telefonisë celulare në territorin shqiptar, për të gjithë operatorët, dhe rezultatet e tij të bëhen pjesë e raportimit vjetor të AKEP-it.
5. Të punojë për ndjekjen dhe zbatimin e strategjisë broadband, duke përfshirë të gjitha detyrimet ligjore, aktet rregullatore dhe vendimet e AKEP-it, rekomandimet e ITU-së, BEREC-ut etj. në këtë strategji.
6. Të marrë masat e nevojshme për implementimin e strukturës së re të AKEP-it, miratuar me vendim të Kuvendit të Shqipërisë nr. 88, date 15.10.2015, duke e parë të lidhur ngushtë me rritjen e profesionalizmit dhe të pavarësisë operationale të rregullatorit.
7. Bazuar në përcaktimet dhe rekomandimet ndërkombëtare, si dhe në eksperiencat më të mira, pas marrjes në administrim të spektrit 790–862 MHz, të realizojë një këshillim publik me tregun, për të bërë të mundur që, nëpërmjet çështjeve që do të trajtojnë, të arrihet maksimumi i mundshëm për të kryer një procedurë sa më transparente dhe asnjansë për dhënie në përdorim të tyre.
8. Të vijojë bashkëpunimin me institucione, veprimtaria e të cilave është e lidhur dhe ndikon në çështje që kanë të bëjnë me tregun e komunikimeve elektronike dhe postare, në mënyrë të veçantë me Autoritetin e Konkurrencës.
9. Të hartojë një plan veprimi të detajuar për vijimin e punës për largimin dhe sistemin e kabllave nga shtyllat e OSHEE-së dhe shtyllat e ndriçimit të bashkive, në bashkëpunim të ngushtë me pushtetin vendor, OSHEE-në dhe operatorët.
10. Të vijojë punën për përmirësimin e vazhdueshëm të akteve rregullatore dhe përshtatjen me ndryshimet ligjore përkatëse, si dhe përafrimin e tyre me kuadrin rregullator të BE-së në fushën e komunikimeve elektronike dhe postare.
11. Të vijojë punën lidhur me procesin e përmbushjes së plotë të detyrimeve ligjore dhe rregullatore të sipërmarrësve, në mënyrë që të garantojnë sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike.

12. Të vijojë punën për plotësimin e mëtejshëm të kuadrit rregullator në fushën e shërbimeve postare në përmbushje të ligjit nr. 46/2015, “Për shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë”.
13. Të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme tregun e komunikimeve elektronike, me qëllim që niveli i tarifave të thirrjeve telefonike (nga rrjete fikse dhe celulare) të jetë i përballueshëm për përdoruesit.
14. Të vijojë punën për monitorimin e spektrit të frekuencave, në përputhje me aktet e miratuara.
15. Të marrë masat e nevojshme për monitorimin e veprimitarisë së ofruesve të shërbimit postar, lidhur me zbatimin efektiv të detyrimeve ligjore, termat dhe kushtet e përgjithshme të shërbimit postar dhe kushteve thelbësore që rrjedhin nga ligji përkatës dhe aktet rregullatore të miratuara.
16. Të marrë masat e nevojshme për forcimin e rolit të rregullatorit në mbrojtjen e interesave ligjorë të tregut të shërbimit postar, për të garantuar trajtimin e barabartë ligjor dhe jodiskriminues të ofruesve të shërbimeve postare në procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve mestyre.
17. Të marrë masat e nevojshme për përditësimin e database-it për rrjetin dhe për të dhënat e tjera të shërbimit postar, si dhe realizimin e projektit për publikimin e tyre në Atlasin e AKEP.

## 7. Përshkrim i fushave që mbulon institucioni

Fushat që mbulon veprimtaria e AKEP si organ rregullator kompetent, bazuar në legjisllacionin e përcaktuar në:

- Ligj Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligj Nr. 46/2015 datë 07.05.2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, janë:
  - Tregu i ofrimit të rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike;
  - Tregu i ofrimit të shërbimeve postare.

### 7.1 Tregu i Komunikimeve Elektronike

#### 7.1.1 Zhvillimi i tregut të komunikimeve elektronike

Tendencat kryesore të tregut të komunikimeve elektronike në vitin 2016 ishin:

- Rritja e ndjeshme e përdorimit të shërbimeve të aksesit broadband nga rrjete celulare;
- Rritje e qëndrueshme e aksesit broadband nga rrjete fikse, ndonëse me norma më të ngadalësuara se në vitet e mëparshme;
- Rritje e përdorimit të paketave të integruara në rrjetet fiks dhe celulare;
- Rënie e përdorimit të shërbimeve tradicionale të telefonisë (celulare dhe fikse);
- Rënie e fitimeve neto dhe normave të fitimit për sipërmarrësit e rrjeteve kryesore të komunikimeve elektronike.

#### 7.1.2 Tregues Financiarë të sektorit<sup>3</sup>

##### 7.1.2.1 Të Ardhurat

Të ardhurat totale të sipërmarrëve nga komunikimet elektronike për vitin 2015 ishin rreth 43 miliard lekë, krahasuar me 42.5 miliard lekë në vitin 2014<sup>4</sup>, që përbën një rritje me 1.3%.


Norma e rritjes së të ardhurave nga rrjetet fikse dhe rrjetet celulare ishte 1.5% dhe 1.2% respektivisht. Ofrimi i shërbimeve nga rrjetet celulare vijon të gjenerojë pjesën më të madhe të të ardhurave të sektorit me rreth 77% në krahasim me 23% të gjeneruar nga shërbimet në rrjetet fikse.

---

<sup>3</sup> Të dhënat financiare të sipërmarrësve të komunikimeve elektronike raportohen në AKEP më datë 10 Prill të çdo viti, dhe në këtë raport të dhënat financiare më të fundit dhe tregues të tjerë të lidhur me to kanë si referencë vitin 2015, përveç rasteve kur shprehet ndryshe.

<sup>4</sup> Të ardhurat totale të vitit 2014 të raportuara në publikime të tjera janë korrigjuar për shkak të saktësimeve të bëra nga operatorët për të ardhurat nga komunikimet elektronike. Gjithashtu AKEP ka bërë disa saktësime në të dhënat paraprake të të ardhurave të vitit 2015 të raportuara në publikime të tjera.


Figura 3- Të ardhurat e sipërmarrësve të komunikimeve elektronike (2008-2015)



Burimi: Të dhënat e operatorëve të deklaruar në AKEP.

Të ardhurat e katër ofruesve kryesorë të shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike, Vodafone Albania, Telekom Albania, Altelecom dhe Plus Communication, përbëjnë 91% të të ardhurave të gjithë sektorit. Të ardhurat e Altelecom nga shërbimet e rrjetit fiks u reduktuan me 6.5% në krahasim me vitin 2014, ndërsa të ardhurat e operatorëve të tjerë të rrjeteve fikse u rritën me 16.5%.

Figura 4- Të ardhurat totale të sipërmarrësve të komunikimeve elektronike (2015)




Burimi: Të dhënat e operatorëve të deklaruar në AKEP

Në vitin 2015 të ardhurat totale të operatorëve celularë ishin rreth 33.1 miliard lekë dhe Vodafone, Telekom Albania dhe Altelecom patën ndryshime të vogla (më pak se +/-1 %), ndërsa bie në sy rritja e të ardhurave të Plus me 20%. Siç mund të vihet re nga figura e mëposhtme të ardhurat totale nga shërbimet në rrjetet celulare kanë pasur trend rënës që prej vitit 2009, ku përjashtim bën rritja e ndjeshme në vitin 2012 dhe rritja e vogël e vitit 2015.

Në vitin 2016<sup>5</sup> të ardhurat nga shërbimet celulare ishin rreth 33.9 miliard lek, që përbën një rritje me 2.4% në krahasim me vitin 2015, ndërsa të ardhurat e Albtelecom nga shërbimet e rrjetit fiks patën një reduktim të ndjeshëm me 15% në krahasim me vitin e mëparshëm. Për shërbimet celulare Telekom Albania pati një rënie me 8.4% dhe Albtelecom rënie të vogël me 1.1%, ndërsa të ardhurat e Vodafone u rritën me 5.7%. Plus Communication në vitin 2016 shënoi rritje të ndjeshme të të ardhurave totale me 41%, për shkak të rritjes së ndjeshme me 87% të të ardhurave me shumicë, ndërsa pati rënie me 17% të të ardhurave me pakicë.

*Figura 5- Të ardhurat Totale të operatorëve celularë 2004-2016*




*Shënim: Të ardhurat në milion Lek dhe janë sipas deklarimeve të operatorëve*

Të ardhurat nga shërbimet me pakicë (retail) celulare në vitin 2015 u reduktuan me 9% në krahasim me një vit më parë. Reduktimi varion nga 16% për Telekom Albania, në 8% për Vodafone dhe 1 % për Plus, ndërsa Albtelecom pati rritje më 1%. Trend të kundërt kishin të ardhurat nga shërbimet me shumicë të rrjeteve celulare, të cilat në 2015 u rritën me rreth 16% në krahasim me 2014. Operatori Plus pati rritjen më të madhe vjetore me 44%, ndërsa të ardhurat me shumicë të Telekom Albania dhe Vodafone u rritën me 19% dhe 14% përkatësisht. Të ardhurat me shumicë të Albtelecom nuk pësuan ndryshim të ndjeshëm si edhe të ardhurat me pakicë.

<sup>5</sup> Të dhënat për vitin 2016 janë raportuar nga operatorët, por janë ende paraprake dhe objekt saktësimi.



Figura 6- Të ardhurat nga Shërbimet me pakicë dhe shumicë të rrjeteve celulare 2010-2015




Shënim: Të ardhurat janë sipas deklarimeve të operatorëve

Të ardhurat nga shërbimet me shumicë në rrjetet celulare u rritën si rezultat i zbatimit të masave të imponuara nga AKEP për mosdiskriminim në tarifave të thirrjeve on-net dhe off-net, të cilat të shoqëruara edhe me uljen e tarifave të terminimit të aplikuar në vitin 2015 në krahasim me 2014, çuan në rritje të ndjeshme të trafikut off-net midis operatorëve celularë, dhe efekti i rritjes së trafikut në të ardhura tejkaloi ndjeshëm efektin e reduktimit të tarifave. Peshat e të ardhurave me shumicë të operatorëve celularë në totalin e të ardhurave të tyre u rrit nga 43% në 2014 në 47% në 2015.

### 7.1.2.2 Fitimet

Figura e mëposhtme paraqet ecurinë e fitimit neto të katër ofruesve kryesorë të shërbimeve të komunikimeve elektronike, të ardhurat e të cilëve përbëjnë 91% të të ardhurave të gjithë sektorit për periudhën 2010-2015.

Figura 7- Ecuria e Fitimeve neto të sipërmarrësve të rrjeteve celulare (2010-2015)



Shënime:


- Fitimi neto i Telekom Albania përfshin të ardhura neto nga interesat që zënë një peshë të rëndësishme në të ardhurat dhe fitimin e Telekom Albania.
- Fitimi (humbja) neto e Albtelcom për vitet 2014-2015 është rezultati neto i të gjithë kompanisë (shërbime celulare dhe fikse)

Nga figura mund të vihet re se fitimet neto totale të të katër sipërmarrësve kanë pësuar reduktime të ndjeshme në vitet 2011, 2013-2015. Në vitin 2015 rezultati neto total i të katër sipërmarrësve të komunikimeve elektronike është negativ, dhe kjo është ndikuar nga rënia e ndjeshme e fitimeve të Vodafone dhe Telekom Albania në 2015 me 84% dhe 78% respektivisht. Plus është i vetmi sipërmarrës që pati një ndryshim pozitiv, nga humbje neto prej 1.4 miliard lekë në 2014 në fitim neto prej 88 milion lekë në 2015. Albtelcom dhe Plus kanë rezultate negative neto gjatë gjithë periudhës së hyrjes në treg si operatorë celularë (përveç vitit 2015 për Plus), ndërsa Vodafone dhe TA kanë pasur fitime neto të larta por që janë reduktuar ndjeshëm në 2014-2015. Rënia e ndjeshme e fitimeve të Vodafone dhe TA është shoqëruar edhe me rënie të normave të fitimit të këtyre dy sipërmarrësve.

### 7.1.2.3 Investimet

Figura e mëposhtme paraqet ecurinë e investimeve të katër sipërmarrësve në infrastrukturë të rrjeteve celulare (nuk përfshihen shpenzimet për licenca/autorizime) në periudhën 2010-2015.

Figura 8- Ecuria e Investimeve të sipërmarrësve në rrjete celulare (2010-2015)



Ecuria e investimeve në rrjete celulare e të katër sipërmarrësve së bashku ka pasur rënie të ndjeshme në 2011 dhe 2012 por duket se është më e stabilizuar në 2013-2015. Megjithatë vlerat e investimeve sipas sipërmarrësve kanë luhate të konsiderueshme në kohë dhe midis njëri-tjetrit. Nga të katër operatorët celularë, Vodafone ka pasur nivelin më të lartë të investimeve në periudhën 2010-2015, duke arritur në 3.8 miliard lekë në vitin 2011, që përkon me fillimin e ofrimit të shërbimeve 3G nga ky operator, ndërsa nivelin më të ulët në vitin 2015 me 1.4 miliard lekë. Telekom Albania dhe Albtelcom kanë pasur rritje të ndjeshme të investimeve në vitin 2015 krahasur me tre dhe katër vitet e mëparëshme. Plus ka pasur nivelin më të lartë të investimeve në vitin 2010, që përkon me fillimin e ofrimit të shërbimeve nga ky operator, ndërsa ka pasur nivel shumë të reduktuar në vitet 2013-2015.

Megjithë rënien e madhe të fitimeve neto, niveli total i investimeve në infrastrukturë rrjeti celular në këtë periudhë nuk ka pasur rënie të ndjeshme, madje sipërmarrësit kanë kryer investime të larta në asete jo-të prekshme si pagesat one-off për rinovime frekuencash 900/1800 MHz (TA dhe Vodafone) dhe blerje të brezave të rinj të frekuencave në këto vite për ofrim të shërbimeve në rrjete 3G/4G.

Tendenca rënëse e fitimeve të operatorëve më të mëdhenj dhe më të hershëm në treg është në linjë me rritjen e konkurrencës në treg, pasi hyrjet e reja dhe rritja e konkurrencës reduktojnë, deri eliminojnë fitimet e tepërta të operatorëve më të mëdhenj. Megjithatë, rezultatet neto negative të dy operatorëve më të vegjël celularë për shumë vite si dhe për Albtelecom si kompania incumbent në tregun fiks si dhe rezultati total negativ në vitin 2015 i katër kompanive më të mëdha të sektorit (që përbëjnë mbi 90% të qarkullimit monetar të gjithë sektorit) është tregues i konkurrencës agresive në çmime (ARPU dhe ARPM shumë të ulëta), por që mund të ndikojë në konkurrencën afatgjatë dhe aftësitë për investime të operatorëve në një sektor që karakterizohet nga zhvillime dinamike në teknologji dhe kërkesa të larta për investime.

### 7.1.3 Shërbime të rrjeteve Celulare

Tabela e mëposhtëme paraqet disa tregues kryesorë të volumit të shërbimeve celulare për vitet 2013-2016 dhe normën e ndryshimit vjetor në vitin 2016.

*Tabela 1: Tregues kryesorë të volumit të shërbimeve celulare 2013-2015*

	2013	2014	2015	2016	Ndryshimi 2016/2015
<b>Numri i përdoruesve të telefonisë celulare:</b>					
- sipas kartave SIM	5,282,350	4,928,784	4,777,885	5,160,060	<b>8%</b>
- përdorues aktivë	3,685,983	3,406,772	3,442,665	3,360,888	<b>-2%</b>
<b>Numri përdoruesve me akses broadband 3G/4G:</b>					
- Totali	1,231,259	1,576,877	2,049,072	2,739,550	<b>34%</b>
- Përdorues aktive	1,231,259	907,975 <sup>6</sup>	1,297,281	1,686,354	<b>30%</b>
<b>Thirrje telefonike dalëse të përdoruesve celularë (minuta)</b>	6,769,300,966	7,301,024,035	7,381,147,348	6,793,769,155	<b>-8%</b>
<b>Numri mesazheve SMS të dërguara nga përdoruesit</b>	1,689,200,882	1,826,346,190	1,598,702,865	1,610,322,977	<b>1%</b>
<b>Volumi total i të dhënave të transmetuara në rrjete celulare (GB)</b>	2,529,549	6,269,940	12,740,073	26,753,639	<b>110%</b>

<sup>6</sup> Ndryshimi i madh në 2014 në krahasim me 2015 dhe 2013 vjen edhe për shkak të ndryshimit të mënyrës së raportimit të këtij treguesi.


Nga të dhënat e tabelës vihet re se numri i përdoruesve të shërbimeve tradicionale telefonike celulare dhe sasia e thirrjeve dhe SMS-ve të gjeneruara nga përdoruesit celularë ka patur luhajtje gjatë periudhës 2013-2016 dhe këta tregues janë kryesisht me tendencë rënëse. Ndërkohë përdorimi i shërbimeve të aksesit broadband nga rrjete celulare ka rritje të ndjeshme në 2016 krahasur me vitin 2013, si dhe me vitin 2015. Numri i përdoruesve aktivë ka rritje vetëm me 37% në 2013-2016 por volumi i të dhënave është rritur më shumë se 10 herë gjatë kësaj periudhe. Rritje të ndjeshme këta tregues kanë patur edhe në vitin 2016 krahasuar me vitin 2015, ku numri i përdoruesve të shërbimeve 3G/4G është rritur me 30-34%, ndërsa volumi i të dhënave është më shumë se dyfishuar.

### 7.1.3.1 Numri i përdoruesve celularë

*Numri i pajtimtarëve të shërbimeve celulare sipas kartave SIM (përshirë kartat e dedikuara për të dhëna) në fund të vitit 2016 ishte rreth 5.3 milionë që përbën rritje me 7.8% në krahasim me vitin 2015. Ndërkohë numri i përdoruesve aktivë (përdorim në 3 muajt e fundit të vitit) të telefonisë celulare në vitin 2016 arriti në rreth 3.4 milionë që përbën një rënie me 2.1% në krahasim me vitin 2015.*

*Numri total i përdoruesve të rrjeteve celulare që kanë përdorur aksesin broadband në Internet të paktën një herë gjatë vitit 2016 ishte rreth 2.7 milion, ndërsa numri i përdoruesve aktivë (përdorim të Internetit në tre muajt e fundit) ishte rreth 1.7 milionë, që përbën rritje vjetore me 34% dhe 30% respektivisht.*

Figura 9- Ecuria e numrit të përdoruesve celularë sipas tremujoreve T4 2014 - T4 2016



Nga të dhënat e ecurisë së numrit të përdoruesve celularë sipas tremujorëve të paraqitur në figurën e mësipërme vihet re se:

- Numri i pajtimtarëve të shërbimeve celulare sipas kartave SIM në fund të T4 2016 ishte rreth 5.3 milionë që përbën një rënie me 2.5% në krahasim me tremujorin e mëparshëm, por rritje me 7.8% në krahasim me T4 2015;
- Numri i përdoruesve aktivë të telefonisë celulare gjatë T4 2016 arriti në rreth 3.4 milionë që përbën një rënie me 14.2% me T3 2016 dhe rënie me 2.1% në krahasim me T4 2015;
- Numri i përdoruesve aktivë të aksesit broadband në Internet nga rrjetet celulare në T4 2016 ishte rreth 1.7 milionë që përbën reduktim me 8% me tremujorin e mëparshëm, por rritje më të ndjeshme me 30% në krahasim me Tremujorin e katërt 2015;
- Të dhënat tregojnë se Tremujori i tretë i vitit ka zakonisht rritje më të madhe se tremujorët e tjerë, dhe kjo shpjegohet me efektin sezonal të muajve Korrik-Gusht që përkon me sezonin turistik dhe kthimin e emigrantëve në Shqipëri;
- Rënia në tremujorin e katërt 2016 shpjegohet pasi vjen pas rritjes së madhe në T3 2016. Ndërsa numri i përdoruesve të telefonisë ka luhatje rreth niveleve tashmë të maturuara, numri i përdoruesve të aksesit broadband ka trend rritës.

Proporcioni i përdoruesve aktivë ndaj kartave SIM aktive në 2016 ishte 66% në krahasim me 72% në vitin 2015. Ky proporcion varion nga 59% për Albtelecom në 79% për Plus. Në fund të vitit 2016 numri i përdoruesve me parapagim përbënte 92% të numrit total të përdoruesve aktivë celularë, duke mos pasur ndryshim nga viti 2015. Përsa e përdoruesve me parapagim në totalin e përdoruesve aktivë celularë varion nga 83% për Plus në 96% për Vodafone.

### ***7.1.3.2 Shërbimet e aksesit broadband në rrjetet celulare 3G/4G***

Shërbimet e aksesit broadband nga rrjetet celulare janë shërbime relativisht të reja në Shqipëri. Këto shërbime filluan të ofrohen në standardin 3G në vitin 2011, pas pajisjes së Vodafone (Dhjetor 2010) dhe Telekom Albania (Shtator 2011) me autorizime individuale për brezat 1900/2100 MHz. Albtelecom (EM) u pajis me autorizim individual për brezin 1900/2100 MHz në Dhjetor 2012, ndërsa Plus Communication në vitin 2016. Shërbimet në standardin 4G filluan të ofrohen në Tremujorin III 2015, pas heqjes së kufizimeve të përdorimit të frekuencave për operatorët celularë dhe dhënies së autorizimeve në brezin 2500/2600 MHz. Numri i pajtimtarëve<sup>7</sup> me akses broadband celular në fund të vitit 2016 arriti në rreth 2.7 milion nga rreth 2 milion në fund të 2016, që përbën rritje të konsiderueshme të numrit apo rritje me 34%. Numri i përdoruesve aktivë (përdorim 3 muajt e fundit) të shërbimeve me akses broadband nga rrjetet celulare (3G/4G nga aparatet celulare dhe me karta USB/modem) në vitin 2016 ishte rreth 1.7 milion apo 30% më shumë se në vitin 2015. Përdorimi i aksesit broadband nga rrjetet 3G/4G nëpërmjet aparateve celulare përbën rreth 93% të totalit të përdoruesve të këtij shërbimi dhe rritjet e ndjeshme të këtij treguesi rezultojnë nga kjo

<sup>7</sup>Numri i pajtimtarëve (aktivë ose jo) që kanë përdorur aksesin broadband (3G/4G) në Internet të paktën një herë gjatë vitit.


kategori, ndërsa numri i përdoruesve nëpërmjet kartave USB/modem në tre vitet e fundit është pothuajse i pandryshuar në nivel rreth 120 mijë përdorues.

Penetrimi për popullsi i përdoruesve aktivë celularë të aksesit broadband nga rrjetet 3G/4G në fund të vitit 2016 arriti në 60% krahasuar me 46% në fundvitin 2015. Të katërt operatorët me rrjete 3G/4G kanë pasur rritje të numrit të përdoruesve aktivë të shërbimeve akses broadband nëpërmjet aparatave celulare, ndërsa numri përdoruesve të aksesit broadband celular me karta të dedikuara (Dedicated Data Card) në tre vitet e fundit është në nivel të qëndrueshëm 120-122 mijë.

Tabela 2: Numri i pajtimtarëve me akses broadband 3G/4G

	Telekom Albania		Vodafone		Albtelecom (EM)		Plus	Total	
	Aparat celular	USB/Modem	Aparat celular	USB/Modem	Aparat celular	USB/Modem	Aparat celular+ USB/Modem	Aparat celular	USB/Modem
2011	46,000	9,000	202,756	25,493				248,756	34,493
2012	222,882	17,833	371,426	37,572				594,308	55,405
2013	279,428	32,138	568,207	66,086	272,257	13,143		1,119,892	111,367
2014	163,797	61,549	503,855	46,341	119,998	12,435		787,650	120,325
2015	278,886	97,087	686,805	20,075	209,650	4,778		1,175,341	121,940
2016	360,415	99,806	903,317	18,537	228,734	2,587	72,958	1,565,424	120,930
<b>Ndryshimi 2016/2015</b>	29%	3%	32%	-8%	9%	-46%		33%	-1%

Figura 10- Numri i përdoruesve aktivë të aksesit broadband nga rrjete celulare



Rritja e përdorimit të aksesit broadband nga rrjetet celulare 3G/4G në vitet e fundit vëhet re sidomos në rritjen e volumit të të dhënave të transmetuara në rrjetet celulare. Në vitin 2014 rritja vjetore e trafikut të të dhënave në rrjetet celulare ishte 148% dhe ky trend vijoi edhe në vitet 2015 dhe 2016 ku rritja vjetore ishte 103% dhe 110% respektivisht. Në periudhën 2013-2016 volumi i të dhënave të aksesit në Internet në rrjetet celulare është rritur më shumë se 10 herë.

### **7.1.3.3 Trafiku telefonik dhe SMS**


Sasia totale e thirrjeve telefonike të gjeneruara nga përdoruesit celularë gjatë vitit 2016 u reduktua me 8% në krahasim me vitin 2015, ndërkohë numri i mesazheve SMS të dërguara nga përdoruesit celularë rezultoi me një rritje modeste prej 1%. Këto tendenca të shërbimeve tradicionale nga rrjete celulare (thirrje dhe SMS) janë të kundërta me rritjen e ndjeshme të përdorimit të aksesit broadband nga rrjete celulare. Trendi rënies së nivelit dhe/ose ritmeve të rritjes së përdorimit të thirrjeve dhe SMS-ve dhe trendi rritës i aksesit broadband celular në 2-3 vitet e fundit janë tregues të efektit të zëvendësimit të thirrjeve telefonike/mesazheve SMS me thirrje/mesazhe nga aplikacionet OTT (Over The Top) në Internet në aparat celular, të vënë në dukje nga AKEP dhe në raportin e mëparshëm vjetor.

Siç është përmendur edhe në raportin vjetor të vitit 2015, më 1 Korrik 2015 hyri në fuqi detyrimi i operatorëve celularë për mos-diskriminim në tarifat e thirrjeve brenda rrjetit dhe drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare. Vijimi i zbatimit të këtyre detyrimeve në vitin 2016 ka çuar në ndryshime të tjera të ndjeshme në nivelin e thirrjeve sipas destinacionit dhe strukturën e tyre. Thirrjet brenda rrjetit u reduktuan me 20% në krahasim me 2015, ndërsa thirrjet drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare (off-net) u rritën me 83%. Pesha e thirrjeve brenda rrjetit ndaj totalit të thirrjeve dalëse në vitin 2016 u reduktua në 60% nga 69% në 2015 (84% në 2014), ndërsa pesha e thirrjeve off-net arriti në 37% krahasuar me 18% në 2015 (8% në 2014).

Trafiku total i thirrjeve telefonike i gjeneruar nga pajtimtarët e rrjeteve celulare në Shqipëri gjatë vitit 2016 arriti në rreth 6.8 miliard minuta, e cila përbën një rënie me 8 % në krahasim me vitin 2015.

Normat e ndryshimit sipas destinacionit të thirrjeve kanë variacion të madh midis tyre. Thirrjet brenda rrjetit u reduktuan me 20% ndërsa thirrjet drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare u rritën me 83%. Thirrjet drejt rrjeteve fikse kombëtare u rritën me 22% ndërsa thirrjet drejt rrjeteve ndërkombëtare (fikse dhe celulare) u reduktuan ndjeshëm me 82%. Këto trende të ndryshme të nivelit të thirrjeve sipas destinacionit çuan në ndryshime në strukturën e trafikut siç paraqitet në figurën e mëposhtëme.

Figura 11- Ecuria e strukturës së trafikut dalës celular (2003-2016)



Pesha e thirrjeve brenda rrjetit ndaj totalit të thirrjeve dalëse në vitin 2016 u reduktua në 60% nga 69% në 2015 (84% në 2014), ndërsa pesha e thirrjeve off-net u dyfishua duke arritur në 37% krahasuar me 18% në 2015 (8% në 2014). Reduktimi i ndjeshëm i thirrjeve ndërkombëtare çoi në reduktim edhe të peshës së këtyre thirrjeve në 2% nga 11% në vitin 2015.


Rënia e madhe e trafikut të thirrjeve dalëse ndërkombëtare në vitin 2016 ka ardhur pas rritjeve të ndjeshme të këtyre thirrjeve në vitet 2014-2015. Këto luhatje shpjegohen me ndryshimet ofertat/paketat e operatorëve celularë për thirrjet ndërkombëtare gjatë kësaj periudhe për shkak të ndryshimeve në tarifat e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në rrjetet celulare në vendet e BE-se të cilat përbëjnë pjesë të kostove të thirrjeve dalëse ndërkombëtare për operatorët shqiptarë. Reduktimi i minutave/ofertave për këto thirrje nga operatorët celularë shqiptarë në vitin 2016 ka ardhur për shkak të rritjes së tarifave të terminimit në një sërë vendesh të BE-së për thirrjet ndërkombëtare të origjinuara jashtë vendeve anëtare të BE.

#### 7.1.3.4 Trafiku on-net/offnet

Siç është përmendur edhe në raportin vjetor të vitit 2015, më 1 Korrik 2015 hyri në fuqi **detyrimi i operatorëve celularë për mos-diskriminim** në tarifat e thirrjeve brenda rrjetit dhe drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare. Rritjet e ndjeshme të nivelit dhe peshës së thirrjeve off-net në totalin e thirrjeve celulare në vitin 2016 dhe reduktimet në thirrjet on-net kanë ndodhur në vijim të zbatimit të këtyre detyrimeve në vitin 2016. Raporti i thirrjeve on-net/off-net në vitin 2014 për Vodafone Albania ishte 95% v 5% ndërsa në vitin 2016 arriti në 72% v 28%. Këto ndryshime të ndjeshme në periudhën 2015-2016 kanë çuar në reduktim të ndjeshëm të hendekut midis këtyre thirrjeve dhe trend konvergues të tyre siç mund të vihet re nga figura e mëposhtëme.



Figura 12- Ecuria trafikut on-net/off-net 2014-2016



Rritjet e ndjeshme të sasisë së thirrjeve off-net në dy vitet e fundit kanë sjellë ndryshime të ndjeshme edhe në strukturën e trafikut hyrës të thirrjeve të terminuara në rrjetet celulare. Terminimi i thirrjeve hyrëse nga rrjete të tjera u rrit me 56% në vitin 2015, ku thirrjet hyrëse nga rrjetet celulare u rritën me 83%, dhe thirrjet nga rrjetet fikse me 32%. Ndërsa thirrjet hyrëse ndërkombëtare u reduktuan me 29%. Si rezultat i ndryshimeve në dy vitet e fundit pesha e thirrjeve hyrëse nga rrjetet e tjera celulare kombëtare u rrit nga 54% në vitin 2014 në 88% në vitin 2016, ndërsa e pesha e thirrjeve ndërkombëtare u ul ndjeshëm nga 44% në vetëm 11%.

Numri i mesazheve SMS të dërguara nga përdoruesit celularë në vitin 2016 u rrit në një masë të vogël me vetëm 1%, e cila vjen pas rënies së ndjeshme me 12% në vitin 2015. Kjo tendencë është e kundërt me rritjet e ndjeshme vjetore në 2013 dhe 2014.

Rritja e ndjeshme e përdorimit të shërbimit të aksesit broadband celular në terma përdoruesish dhe trafikut të të dhënave në vitin 2016 është shoqëruar me rënie të përdorimit të shërbimeve tradicionale celulare, thirrje dhe SMS, duke evidentuar përsëri efektin e zëvendësimit të mesazheve SMS dhe thirrjeve telefonike me mesazhe/thirrje nga aplikacionet OTT (Over The Top) nga Interneti i aparateve celulare.

### 7.1.3.5 Pjesët e tregut

Pjesët e tregut të operatorëve celularë për treguesit kryesorë në periudhën 2011-2016 së bashku me indeksin HHI<sup>8</sup> të përqëndimit janë dhënë në tabelën e mëposhtme.

<sup>8</sup>HHI (Herfindahl–Hirschman Index), i matur si shuma e katrorëve të pjesëve të tregut të gjithë lojtarëve të tregut.

Tabela 3- Pjesët e tregut të operatorëve celularë 2011-2016

	Viti	Telekom Albania	Vodafone	Albtelecom	Plus	HHI
Përdorues shërbime celulare (karta SIM përfshirë Broadband Data Card)	2016	32.1%	49.4%	14.2%	4.3%	3,689
	2015	34.3%	41.5%	16.0%	8.2%	3,223
	2014	39.7%	39.9%	13.6%	6.8%	3,395
	2013	38.8%	42.7%	12.8%	5.7%	3,526
	2012	33.3%	36.3%	25.1%	5.3%	3,083
	2011	36.6%	34.8%	21.1%	7.5%	3,052
Përdorues Aktivë Telefoni	2016	30.7%	50.8%	13.1%	5.4%	3,725
	2015	32.7%	46.8%	14.1%	6.4%	3,501
	2014	34.2%	45.5%	12.7%	7.7%	3,456
	2013	37.5%	45.0%	11.5%	6.0%	3,600
	2012	39.8%	42.2%	12.3%	5.7%	3,546
	2011	37.0%	43.7%	13.4%	5.9%	3,497
Përdorues aktivë broadband	2016	27.3%	54.7%	13.7%	4.3%	3,940
	2015	29.0%	54.5%	16.5%	N/A	4,082
	2014	24.8%	60.6%	14.6%	N/A	4,501
	2013	25.3%	51.5%	23.2%	N/A	3,831
	2012	37.0%	63.0%	N/A	N/A	5,335
	2011	19.4%	80.6%	N/A	N/A	6,871
Thirrje dalëse	2016	33.7%	51.7%	10.8%	3.8%	3,946
	2015	31.7%	49.3%	13.1%	5.9%	3,644
	2014	33.6%	50.2%	11.0%	5.2%	3,801
	2013	39.0%	51.0%	7.0%	3.0%	4,180
	2012	39.0%	50.0%	8.0%	3.0%	4,094
	2011	37.0%	51.0%	10.0%	2.0%	4,074
SMS dalëse	2016	21.2%	66.7%	8.9%	3.2%	4,986
	2015	18.1%	65.8%	8.1%	8.0%	4,786
	2014	19.4%	66.4%	4.7%	9.5%	4,897
	2013	21.0%	73.0%	5.0%	1.0%	5,796
	2012	20.0%	73.0%	6.0%	1.0%	5,766
	2011	27.0%	64.0%	8.0%	1.0%	4,890
Trafik Data <sup>9</sup>	2016	21.0%	54.8%	22.1%	2.1%	3,939
	2015	17.6%	50.8%	28.8%	2.7%	3,732
	2014	16.1%	49.3%	30.4%	4.2%	3,633
	2013	21.3%	57.4%	17.3%	3.9%	4,069
	2012	26.8%	54.0%	14.0%	5.2%	3,855
	2011	23.4%	42.5%	26.1%	8.0%	3,100

<sup>9</sup>Periudha 2011-2016 sipas trafikut total në rrjetet GPRS/UMTS. 2016 e në vijim sipas trafikut broadband celular në rrjete 3G/4G.

Të ardhura totale nga komunikimet	2015	34.3%	47.1%	12.0%	6.6%	3,582
	2014 <sup>10</sup>	34.4%	48.0%	12.1%	5.6%	3,665
	2013	32.7%	50.1%	11.4%	5.9%	3,744
	2012	29.3%	56.0%	10.3%	4.4%	4,120
	2011	33.7%	51.9%	12.4%	1.9%	3,987
	2010	39.5%	48.1%	12.3%	0.0%	4,025

Nga të dhënat vihet re se:

- Vodafone Albania ka pasur rritje me rreth 8 pikë përqindje në pjesën e tregut të numrit total të përdoruesve të shërbimeve celulare sipas kartave SIM (përfshirë kartat e të dhënave për akses broadband) dhe me 4 pikë përqindje (pp) për përdoruesit aktivë të telefonië celulare, si dhe në trafikun e të dhënave në rrjet celular. Vodafone ka rreth 50% pjesë tregu për përdorues të shërbimeve telefonike dhe rreth 55% për përdorues broadband dhe trafik të dhënash në rrjete 3G/4G.
- Telekom Albania ka humbur rreth 2 pikë përqindje në pjesët e tregut të përdoruesve dhe ka rritje me 2-3 pp për thirrje, SMS dhe trafik të dhënash;
- Albtelecom (EM) ka humbur 1-3 pp pjesë tregu për treguesit e numrit të përdoruesve dhe thirrjeve telefonike;
- Plus ka rënie të pjesëve të tregut për përdorues të shërbimeve celulare telefonike, thirrjeve dhe SMS-ve me 1-4.8 pp, ndërsa ka fituar 4.3% pjesë tregu në përdorues akses broadband dhe trafik të dhënash broadband që prej fillimit të ofrimit të shërbimeve 3G në tremujorin e tretë 2016.
- Pjesët e tregut kryesisht janë të krahasueshme sipas treguesve të ndryshëm, por bie në sy pjesa e tregut e Vodafone për SMS mbi 65% për shumë vite tashmë, dhe Albtelecom që ka pjesë tregu në trafik të dhënash shumë më të madh se numri i përdoruesve akses broadband, që do të thotë përdorim mesatar për përdorues të këtyre shërbimeve shumë më të lartë se operatorët e tjerë;
- Rënia e pjesëve të tregut të Plus për disa tregues (shërbime telefonie) është e vogël në pikë përqindje por për shkak të bazës së ulët krahasuese, ato janë rënie të ndjeshme.
- Treguesi i HHI është në nivele 3700-3900, përveç treguesit të SMS-ve që është rreth 5000 për shkak të pjesës shumë të madhe të tregut të Vodafone për këtë shërbim. HHI është rritur me 200-466 pikë për treguesit e shërbimeve telefonike dhe SMS dhe është me ulje për treguesit e aksesit broadband.
- Pjesët e tregut në të ardhura të operatorëve celularë nuk kanë ndryshime të ndjeshme në 2015. Plus ka rritur pjesën e tregut me 1 pikë përqindje, ndërsa Vodafone dhe Telekom Albania kanë patur reduktime të vogla me më pak se 1 pikë përqindje secili. Vodafone rezulton me 47% pjesë tregu të qëndrueshme në dy vitet e fundit.

<sup>10</sup>Treguesi është rishikuar pasi sipërmarrësi Vodafone Albania bëri saktësime në lidhje me vlerën e të ardhurave për vitin 2014. Mund të ekzistojë një mospërputhje e vogël ndërmjet shumës së përbërësve dhe totalit të paraqitur në tabela, për shkak të rumbullakimeve.

### 7.1.3.6 Përdorimi mesatar mujor i shërbimeve celulare

Në vijim është dhënë një tabelë me të dhëna për përdorimin mesatar mujor të thirrjeve telefonike dhe mesazheve SMS për përdorues celularë në 2011 deri në 2016, sipas dy treguesve të përdoruesve: përdorues aktiv dhe karta SIM. Përdorimi mesatar mujor për përdorues është llogaritur sipas thirrjeve dalëse (thirrje që gjenerohen nga një përdorues) dhe thirrjeve hyrëse (thirrjet e marra nga një përdorues), të matura në minuta. Njëkohësisht tabela përmban dhe përdorimin mesatar mujor për të dhëna për të gjithë përdoruesit e aksesit broadband celularë (të paktën një herë përdorim gjatë vitit) si dhe për përdorues aktivë broadband për 2014-2016.

Tabela 4: Përdorimi mesatar mujor i shërbimeve celulare 2010-2016

	2011	2012	2013	2014	2015	2016	Ndryshimi 2016/2015
<b>Përdorues Aktivë</b>							
Thirrje dalëse	130	152	156	173	182	166	-9%
Thirrje të marra (hyrëse)	147	168	167	168	171	169	-1%
MOU*	277	319	324	341	353	335	-5%
SMS (dalëse)	19	35	39	43	39	39	0%
Trafik Data (GB)				0.55	0.89	1.49	68%
<b>Përdorues Karta SIM</b>							
Thirrje dalëse	83	93	103	120	128	114	-11%
Thirrje të marra (hyrëse)	94	103	111	117	120	116	-3%
MOU*	177	195	214	237	248	230	-7%
SMS (dalëse)	12	21	26	30	28	27	-4%
Trafik Data (MB)	102	146	230	357	541	954	76%

Burimi: Përlllogaritje të stafit të AKEP bazuar në të dhënat periodike të raportuara nga operatorët

Gjatë vitit 2016, një përdorues celular aktiv (që ka kryer komunikim në 3 muajt e fundit) ka kryer mesatarisht 166 minuta thirrje dalëse, ka dërguar 39 mesazhe SMS në muaj dhe ka konsumuar 1.48 GB në Internet broadband. Këto vlera përdorimi janë më të vogla nëse si numër përdoruesish celular i referohemi numrit total të përdoruesve sipas kartave SIM: 114 minuta dalëse, 27 SMS dhe 954 MB në muaj. Treguesit e përdorimit mesatar të thirrjeve dhe SMS-ve janë me tendencë rënëse në 2016, me 1-11%, ndërsa përdorimi mesatar i të dhënave ka rritje të ndjeshme me 68% - 76%. Gjatë vitit 2016 një përdorues celular ka përdorur mesatarisht 954 MB në muaj krahasuar me 541 MB në vitin 2015. Përdorimin më të madh mesatar të thirrjeve telefonike dalëse e kishin Telekom Albania dhe Vodafone me 177 dhe 176 minuta në muaj për përdorues aktivë respektivisht. Vodafone ka përdoruesit më të mëdhenj të SMS-ve me 54

SMS/muaj. Përdoruesit aktivë të Altelecom kishin konsumin më të madh të të dhënave në akses broadband celular me 1.9 GB/muaj.

### **7.1.3.7 Tarifat celulare**

Operatorët celularë ofrojnë një sërë shërbimesh dhe paketash tarifore dhe shpesh është e vështirë krahasimi i tarifave për shërbime të veçanta dhe/ose për njësi për shkak të rritjes së përdorimit të shportave (bundles) me një shërbim ose me shumë shërbime (paketa të integruara), e cila përbën dhe një tendencë globale të përmendur dhe ITU në raportin më të fundit të vitit 2016. Si edhe në dokumentat e tjerë të AKEP, ecuria e tarifave me pakicë të tregut celular analizohet në dy drejtime kryesore:

- Të ardhura mesatare për minutë/përdorues (ARPM/ARPU);
- Tarifat nominale me pakicë të operatorëve.

Në seskionet në vijim AKEP ka analizuar fillimisht ecurinë e treguesve të ARPM dhe ARPU, dhe më pas të tarifave nominale të operatorëve celularë duke u fokusuar në ndryshimet e kryera nga operatorët celularë në zbatim të detyrimeve të mos-diskriminimit në tarifat e thirrjeve on-net dhe off-net, tarifat e shërbimeve të aksesit broadband, krahasime të tarifave të segmenteve me parapagim dhe paspagim dhe tarifat për njësi komunikimi.

Treguesit e ARPU (Average Revenue Per User) dhe ARPM (Average revenue Per Minute) masin të ardhurat mesatare të operatorëve për përdorues dhe për minutë, por që njëkohësisht mund të interpretohen si shpenzime mesatare të përdoruesve celularë, dhe për këtë arsye përdoren edhe si tregues agregatë të ecurisë së tarifave të shërbimeve celulare. Në prezencë të përdorimit të lartë të paketave/ofertave dhe shportave të integruara të shërbimeve me sasi të mëdha shërbimesh të përfshira në pagesat fikse, për përdorues me parapagim dhe me kontratë, ARPM dhe ARPU janë tregues të mirë të tarifave dhe shpenzimeve mesatare efektive që paguajnë realisht përdoruesit celularë.

ARPM<sup>11</sup> apo e ardhura mesatare për minutë matet si raporti i të ardhurave nga shërbimet me pakicë me numrin mesatar të përdoruesve gjatë periudhës përkatëse dhe përdoret si përafrues i çmimit që një përdorues celular paguan mesatarisht për një minutë thirrje telefonike. ARPU e matur si raporti i të ardhurave nga shërbimet me pakicë të operatorëve me numrin mesatar të përdoruesve (aktivë) gjatë një viti dhe tregon sa lekë shpenzon mesatarisht një përdorues celular për shërbime celulare në vit apo në muaj. Vlerat e këtyre treguesve për periudhën 2010-2015 janë dhënë në tabelën e mëposhtme.

*Tabela 5- Ecuria e ARPM dhe ARPU 2010-2015*

---

<sup>11</sup> Treguesi i ARPM llogaritet nga AKEP në bazë të të dhënave që dërgojnë operatorët për të ardhurat dhe thirrjet telefonike. Për shkak të ofertave/shportave që kanë një pagesë fikse dhe përfshijnë përveç thirrjeve edhe SMS dhe kapacitet Internet, vlerat e këtij treguesi mund të mos pasqyrojnë saktë të ardhurën mesatare retail për një minutë thirrje, megjithatë ai është një tregues i përafërt dhe mund të konsiderohet vlera maksimale kur si të ardhura përdoren të ardhurat totale retail.


	ARPM (Lek/minute)	ARPU (Lek/vit)	ARPM Ndryshimi vjetor (%)	ARPU Ndry- shimi Vjetor (%)
2010	6.49	8,594		
2011	5.35	8,319	-18%	-3%
2012	3.92	7,132	-27%	-14%
2013	3.13	5,863	-20%	-18%
2014	2.63	5,447	-16%	-7%
2015	2.36	5,125	-10%	-6%

*Shënim: Vlerat pa TVSH*

Nga tabela vihet re se ARPM dhe ARPU kanë tendencë rënëse dhe për vitin 2015 vlerat e tyre janë reduktuar me 10% dhe 6% respektivisht. Në vitin 2015 një përdorues celular ka paguar mesatarisht 2.83 lekë/minutë (me TVSH) për thirrjet telefonike dhe ka shpenzuar mesatarisht 513 lekë/muaj (me TVSH) për shërbime celulare.

Niveli i këtyre treguesve në Shqipëri është shumë më i ulët se niveli mesatar në vendet e BE dhe ndër më të ulët në rajon. ARPU në vitin 2015 në Shqipëri ishte 36.6 euro/vit, që është 23% më e ulët se Letonia me nivelin më të ulët në BE me 46 euro. Niveli mesatar i ARPU në BE në 2014<sup>12</sup> ishte 162.2 euro apo rreth 4.4 herë më e lartë se ARPU e Shqipërisë në 2015. ARPM për Shqipërinë ishte në nivelin rreth 1.9 eurocent në 2014 dhe rreth 1.7 eurocent në 2015. Të dhënat më të fundit për ARPM e vendeve të BE janë të disponueshme për vitin 2011 dhe krahasimi tregon se ARPM ka tendencë të ngjashme me ARPU, dhe raporti i ARPM së Shqipërisë me mesataren e BE është i ngjashëm me atë të ARPU. Figura e mëposhtme paraqet ecurinë e ARPU (lekë/muaj pa TVSH) si dhe të përdorimit mesatar të thirrjeve dalëse (minuta/muaj) në periudhën 2011-2015. Figura tregon për një rënie të qëndrueshme të shpenzimeve mesatare (ARPU) të përdoruesve celularë si dhe një rritje të qëndrueshme të minutave mesatare të përdorimit të shërbimeve të telefonisë celulare.

*Figura 13- Ecuria e ARPU dhe Thirrje për përdorues*



<sup>12</sup> Të dhënat më të fundit të ARPU për vendet e BE-së të publikuar nga KE janë për vitin 2014.

Tendencat rënëse të shpenzimeve mesatare të përdoruesve celularë të shoqëruara me rritje të përdorimit mesatar të shërbimeve celulare, thirrje telefonike dhe përdorim të dhënash (data), tregojnë për rritje të përfitimeve të përdoruesve celularë nga konsumi i shërbimeve tradicionale dhe të reja të rrjeteve celulare.

### ***Tarifat e thirrjeve on-net/off-net***

Implementimi i masave rregullatore të përcaktuara nga AKEP në Vendimet e Nëntor 2014/Mars 2015 si dhe në udhëzimet përkatëse të Qershor 2015 për mos diskriminim të tarifave on-net/off-net u krye në dy faza:

- Faza e parë, u aplikua për programet tarifore/ofertat/opsionet për përdoruesit me parapagim dhe përdoruesit e rinj me kontratë, përfshirë rinovimet e kontratave ekzistuese që u kryen pas datës 1 Korrik 2015;
- Faza e dytë filloi me 1.01.2016, duke u aplikuar për përdoruesit me kontrata specifike/të personalizuar apo kontrata që kishin afat maturimi përtej datës 1.01.2016.

Nga monitorimi i vazhdueshëm i publikimit të tarifave në faqet e internetit të operatorëve sipas masave rregulluese dhe rregullores mbi publikimin e informacionit për tarifat e shërbimeve të komunikimeve elektronike publike rezultoi se:

- Programet tarifore/ofertat/opsionet nga të katër operatorët celularë me detyrimin e mos-diskriminimit midis tarifave të thirrjeve off-net dhe on-net;
- Në faqet e tyre të internetit u publikuan programet tarifore, ofertat, opsionet etj., për përdoruesit me parapagim dhe përdoruesit me kontratë, sipas detyrimit të sipërpërmendur;
- Të gjitha produktet që nuk plotësonin detyrimin duke filluar nga data 01.07.2015 u hoqën nga tregu.

Nëpërmjet këtij detyrimi u thjeshtua informacioni për pajtimtarët në lidhje me përmbajtjen e programeve/ofertave/opsioneve dhe mundësia për të krahasuar këto të fundit midis operatorëve dhe midis njëra-tjetrës. Ulje pati dhe numri ofertave të përkohshme, i cili në Qershor 2014 shkonte në 13-20 për operator, duke kaluar në paketa standarte.

Njesitë e komunikimit të përfshira në pagesa fikse u konvertuan nga minuta brenda rrjetit, në minuta kombëtare ose në sasi të barabarta minutash brenda dhe jashtë rrjetit celular, duke mos prekur interesin e konsumatorit madje duke rritur përfitimet e tyre. Në shumicën e paketave/programeve tarifore celulare operatorët përfshijnë tashmë minuta kombëtare (drejt të gjitha rrjeteve celulare dhe fikse kombëtare) e cila është lehtësuar dhe nga reduktimet e tarifave të terminimit në rrjetet celulare dhe fikse këto vite të fundit.

### ***Tarifat për shërbimet e aksesit broadband celular***

Shërbimi i aksesit broadband në Internet në rrjetet celulare mund të përfitohet nëpërmjet paketave të përbashkëta me shërbimet standarde telefonike ose nëpërmjet paketave të veçanta për të dhëna. Programet tarifore të katër operatorëve celularë tregojnë se shumica e paketave janë të integruara: telefoni/SMS dhe akses në Internet 3G/4G. Këto paketa janë të shumëllojshme dhe mund të blihen nga përdoruesit me parapagim për konsum ditor, javor apo 4-javor/Mujor. Tarifat e këtyre paketave variojnë sipas afatit të vlefshmërisë dhe njërive të komunikimit dhe/ose aksesit në Internet të përfshira në pagesën fikse.

Nga ofertat/paketa tarifore të disponueshme nga operatorët celularë vihet re se përdoruesit me parapagim (që përbëjnë mbi 93% të përdoruesve të shërbimeve celulare në Shqipëri) kanë mundësi zgjedhjeje për të përfituar aksesin në Internet celular së bashku me shërbime telefonike/apo si shërbime më vehte duke filluar nga 60 lekë/ditë dhe 300/400 lekë/muaj, dhe me kapacitete download të mjaftueshme për akses broadband funksional në Internet. Pavarësisht vonesave në fillimin e ofrimit të shërbimeve 3G/4G në Shqipëri (për shkak të vonesës në dhënien e të drejtave për brezat e frekuancave të nevojshme për rrjetet 3G/4G të pavaruara nga MNO-të në Shqipëri), në vetëm disa vite përdorimi i këtyre shërbimeve ka njohur rritje të ndjeshme në përdorues dhe konsum të dhënash dhe tarifat janë shumë konkurruese dhe të përballueshme (shiko kapitullin e Shërbimit Universal të komunikimeve elektronike).

### ***Tarifat e shërbimeve roaming ndërkombëtar***

Roamingu ndërkombëtar është një ndër shërbimet që shpesh ka impakt të konsiderueshëm në faturën mujore të përdoruesve celularë. Roamingu ndërkombëtar mundëson përdorimin e shërbimeve celulare jashtë territorit të vendit përkatës duke përdorur rrjetet dhe shërbimet e operatorëve të huaj. Tarifat e roamingut ndërkombëtar që përdoruesit celularë paguajnë varen në masë të konsiderueshme nga tarifat me shumicë të aplikuar nga operatorët e huaj dhe këto tarifa janë shpesh të larta duke çuar në tarifa shumë të larta me pakicë për këto shërbime.

Për shkak të problematikës së tarifave të larta të këtyre shërbimeve dhe marrdhënieve midis operatorëve vendas dhe të huaj, që nuk mund të adresohen në mënyrë individuale nga rregullatoret vendas, Komisioni Europian ka ndërhyrë në nivel komunitar që prej vitit 2017 e në vijim për rregullimin e tarifave me pakicë dhe me shumicë të roamingut ndërkombëtar të aplikuar midis operatorëve të vendeve anëtare të BE. Këto rregullime kanë çuar në ulje të ndjeshme të tarifave të roamingut ndërkombëtar në vendet anëtare të BE, por ato nuk janë detyruese për tu aplikuar për vendet që nuk kanë statusin e vendit anëtar.

Rritja e përdorimit të Internetit në aparate celulare smart dhe shpejtësi të larta 3G/4G kanë çuar edhe rritje të përdorimit të internetit në roaming ndërkombëtar, dhe nëpërmjet përdorimit të aplikacioneve OTT përdoruesit kanë mundësinë të shmangin tarifat e larta për thirrje apo SMS në roaming ndërkombëtar. Megjithatë shpesh tarifat e internetit në roaming ndërkombëtar janë të larta dhe mundësia e kontrollit të shpenzimeve për përdorim të internetit



është shumë më ulët se kontrolli i përdorimit të thirrjeve apo SMS-ve. Kjo ka çuar që shkaku kryesor i faturave tepër të larta të roamingut ndërkombëtar të jetë përdorimi i Internetit dhe jo më i thirrjeve apo SMS-ve.

Megjithatë zhvillime pozitive për roamingun ndërkombëtar janë vënë re edhe në Shqipëri, ku operatorët celularë nëpërmjet paketave/opsioneve të veçanta për këto shërbime mundësojnë përdorimin e tyre me tarifa mesatare më të ulëta për përdoruesit fundorë dhe kontroll më të lartë të shpenzimeve nga këta të fundit, për të shmangur faturat tepër të larta. Nga këto paketa vihet re se operatorët ofrojnë paketa të ndryshme për konsum ditor si dhe opsione për përdorim të shërbimeve roaming si në Shqipëri për një tarifë shtesë ditore apo për minutë ose MB. Vodafone Albania dhe Telekom Albania duke qenë pjesë e grupeve të mëdha ndërkombëtare celulare (Vodafone Group dhe Deutsche Telekom) kanë avantazhe të ofrimit të skontove për roaming ndërkombëtarë në operatorët e tjerë pjesë e grupeve përkatëse. Megjithatë edhe Altelecom që nuk është pjesë e ndonjë grupi të madh ndërkombëtar celular vihet re se ofron skonto/tarifa atraktive për roaming ndërkombëtar, madje për internetin në roaming ofron tarifa për njësi (MB jashtë paketave/ofertave) shumë më të lira se dy operatorët e tjerë celularë.

Gjatë vitit 2016, AKEP ka bashkëpunuar me MIAP për ndryshime ligjore që mundësojnë rregullimin e tarifave me shumicë dhe me pakicë të roamingut ndërkombëtar në rastet e nënshkrimit të marrveshjeve të përbashkëta ndërkombëtare, siç është rasti i Marrëveshjes Rajonale të Roamingut (Regional Roaming Agreement-RRA) në vendet e Ballkanit Perëndimor, e cila ka filluar të zbatohet midis Serbisë, Malit të Zi, IRJ të Maqedonsië dhe Bosnjë dhe Hercegovinës. Në lidhje me këtë iniciativë, AKEP në bashkëpunim dhe me MIAP, janë angazhuar në dhënien e inputeve dhe kontributit në projektin e RCC (Regional Cooperation Council) për vlerësimin e efektivitetit të marrveshjes së cituar dhe dhënien e rekomandimeve përkatëse për vendet që e kanë nënshkruar dhe që kanë vullnet apo janë të inetersuar për ta bërë këtë. Raporti i përgatitur vë në dukje se pavarësisht se Shqipëria dhe Kosova nuk e kanë nënshkruar marrveshjen dhe nuk aplikojnë rregullim të tarifave të roamingut, midis tyre ka rritje të ndjeshme të trafikut roaming për shkak të marrveshjeve të veçanta midis operatorëve të këyre dy vendeve (si midis Altelecom dhe Telekom Kosova).

### *Afati i ofertave mujore*

Ndryshimet e ndodhura në vitin 2016 përfshijnë ndryshimin nga Altelecom, TA dhe Vodafone në Mars 2016 të afatit të përdorimit të ofertave mujore nga 30 ditë në 28 ditë. Operatorët kanë zbatuar detyrimet e transparencës dhe publikimit të tarifave për këtë ndryshim. Ndryshimi i afatit rezulton të jetë bërë për shkaqe kompatibiliteti të afateve (ditore, javore dhe 4 javore) si dhe është në vijim të praktikve të përdorura edhe nga operatorë celularë në vende të tjera europiane. AKEP pas sqarimeve të operatorëve ka bërë kërkime në website-et e disa operatorëve në vendet të tjera, nga ku rezulton se ata ofrojnë paketa/oferta 4 javëshe për përdoruesit e tyre në tregun me pakicë, me parapagim si dhe me kontratë.

### ***Tarifat standarte për njësi komunikimi (pay as you go)***

Në analizën e tregut 2014 dhe 2016, AKEP ka evidentuar si problematikë diferencën e lartë të tarifave për shërbimet e konsumuara për njësi (lekë/minutë, SMS) me tarifat e shërbimeve të përfshira në pagesën fikse si pjesë e ofertave. Këto tarifa aplikohen nëse përdoruesi me parapagim nuk blen paketa/oferta ose pasi ka konsumuar njësitë përkatëse të përfshira në çmimin e paketës/ofertës, si dhe për përdoruesit me kontratë pas konsumit të njëjësive të përfshira në pagesën fikse mujore dhe/ose të paketave/opsioneve shtesë që mund të blejnë kjo kategori përdoruesish. Këto tarifa rezultojnë të jenë shumë herë më të larta se tarifat mesatare që aktualisht paguajnë përdoruesit celularë. Siç është theksuar në seksionin e ARPM, çmimi që një përdorues celular ka paguar mesatarisht për një minutë thirrje telefonike nga rrjete celulare në vitin 2015 ishte 2.83 lekë/minutë me TVSH, ndërsa tarifat standarde të thirrjeve jashtë paketave janë deri 14 herë më të larta se kjo vlerë mesatare. Në mënyrë të ngjashme edhe tarifimi për aksesin broadband jashtë paketave tregon për nivel shumë të lartë të tyre dhe diferenca të mëdha me aksesin broadband në paketa (parapagim/paspagim).

Megjithatë duhet theksuar se pesha e madhe e përdoruesve me parapagim (93%) që përdorin shërbime me karta rimbushëse, tendencat e përdorimit të paketave me parapagim dhe paspagim që përfshijnë sasi mëse të mjaftueshme thirrjesh dhe SMS, dhe masa të tjera nga vetë operatorët celularë e reduktojnë ndjeshëm mundësinë e aplikimit të këtyre tarifave të larta standarde. P.sh, në vitin 2016 vetëm 0.7% e thirrjeve dhe 2.5% e SMS-ve janë tarifuar me tarifat standarde. Njëkohësisht, operatorët celularë për të shmangur fatura stratosferike për aksesin broadband, shpesh aplikojnë politikat tarifore të ashtuquajtura FUP (Fair Usage policy), ku ofrohet internet 'pa limit': Pas konsumit të një sasi të caktuar GB apo MB, përdoruesi vazhdon të ketë internet pa limit, por me shpejtësi të reduktuar deri në 128/256 kbps. Gjithsesi, AKEP është duke e trajtuar këtë çështje edhe në kuadër të Shërbimit Universal.

### ***Transparenca dhe lehtësia e krahasimit të tarifave***

Një ndër problemet e evidentuara në analizën e tregut 2014 ishte numri i madh i ofertave nga secili operator, të cilat çonin në konfuzion dhe vështirësi në krahasimin e tyre nga përdoruesit, si dhe në kosto shtesë të paparashikuara nga konsumi i thirrjeve off-net, jo të përfshira në paketat fikse. Ndryshimet e kryera nga operatorët celularë në zbatim të detyrimeve të mosdiskriminimit të tarifave të thirrjeve on-net/off-net në dy vitet e fundit, përveç eliminimit të diskriminimit në këto tarifa kanë çuar në rënie të ndjeshme të numrit të ofertave/paketave për secilin operator (krahasuar me numrin tepër të lartë para dy viteve), duke çuar në rritje të transparencës dhe lehtësisë së krahasimit të paketave të ndryshme tarifore nga ana e përdoruesve celularë.

Tendenca e konsumit drejt paketave bundle me shërbime të integruara thirrje telefonike kombëtare, SMS dhe akses në Internet e shoqëruar me ndryshimet e cituara ka çuar në krahasim më të lehtë të paketave të një operatori dhe ato midis operatorëve të ndryshëm dhe kontroll më të lehtë të shpenzimeve nga përdoruesit celulare. Tendencat e operatoreve celu-

larë në ofrimin e paketave për përdoruesit me parapagim është ofrimi i tyre në bazë konsumi 1 ditor, javor dhe mujor (30 ditorë) ose 4 javor/28 ditorë, duke përfshirë në shumicën e tyre përveç thirrjeve telefonike dhe SMS edhe akses në Internet. Këto paketa krijojnë mundësinë e zgjedhjes për përdoruesit me parapagim dhe janë lehtësisht të krahasueshme në bazë të çmimit, njësisive të konsumit të përfshira në paketa dhe kohëzgjatjes së tyre.

Nje zhvillim tjetër pozitiv është mundësimi nga Telekom Albania i krahasimit on-line të tarifave të paketave me parapagim që ky operator ofron në treg. Telekom Albania në faqen e vet web ofron krahasimin e paketave të ndryshme tarimore me parapagim sipas kriterëve të ndryshme si çmimi apo paketat me të shitura, duke mundësuar dhe një renditje të paketave sipas shpenzimeve të zgjedhura nga përdoruesi.

#### **7.1.4 Shërbimet nga rrjetet fikse**

##### **7.1.4.1 Telefonia fikse**

Shërbimet e telefonisë fikse në Shqipëri ofrohen nga rreth 80 sipërmarrës, të cilët zotërojnë rrjetet/infrastrukturën e tyre, përfshirë rrjetin e aksesit apo të lidhjes direkte me përdoruesit fundorë. Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse ka patur një rënie të vazhdueshme në 2012-2015 ndërsa në vitin 2016 u vu re një rritje e numrit të linjave të telefonisë fikse.


Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse në fund të vitit 2015 ishte rreth 227 mijë, ndërsa në 2016 arriti në rreth 248 mijë. Ndryshimet në 2014 dhe 2016 të këtij treguesi kanë ardhur dhe për shkak të ndryshimit të mënyrës së raportimit dhe përkufizimit të këtij treguesi<sup>13</sup> dhe për këtë arsye numri i pajtimtarëve të disa operatorëve dhe pjesët e tregut në tërësi për vitin 2106 për këtë tregues nuk janë të krahasueshme me vitet e mëparshme. Norma e penetrimit për telefoninë fikse (numër pajtimtarësh për 100 banorë) në fund të vitit 2016 arriti në 8.8%, që është shumë më e ulët se vendet e zhvilluara (rreth 40%), rreth dy herë më e ulët se mesatarja botërore (15.2%), madje me e ulët edhe se mesatarja e vendeve në zhvillim (10%).

Siç është theksuar në raportet e mëparshme vjetore tendenca rënëse e përdorimit të këtij shërbimi është një trend global dhe i ndikuar nga shumë faktorë, ndër të tjera edhe efekti i zëvendësimit të këtyre shërbimeve me shërbime nga rrjete celulare, të cilat vitet e fundit në Shqipëri ofrojnë tashmë edhe akses broadband në Internet me cilësi dhe tarifa të favorshme për përdoruesit.

*Figura 14- Ecuria e numrit të pajtimtarëve të Telefonise fikse 2000-2015*


---

<sup>13</sup> Në 2014 dhe 2015 treguesi i referohet numrit të përdoruesve aktivë (me përdorim në 3 muajt e fundit të telefonisë fikse për përdoruesit me parapagim) ndërsa në 2016 i referohet numrit të linjave të telefonisë fikse dhe pajtimtarëve që kanë të alokuar një numër telefoni fiks, pavarësisht përdorimit ose jo të tij.



Megjithë efektin e ndryshimit të përkufizimit apo raportimit të këtij treguesi, tendenca në rënie është e dukshme për disa vite rradhazi tashmë dhe vihet re edhe në reduktimin e përdorimit të minutave të telefonisë fikse nga pajtimtarët. Të dhënat për numrin e pajtimtarëve sipas qarqeve tregojnë se rreth 48% e të gjithë pajtimtarëve të telefonisë fikse janë në qarkun Tiranë. Diferenca në nivelin e përdorimit në zona urbane dhe rurale vihet re nga grafiku i mëposhtëm, ku penetrimi mesatar për popullsi në zona urbane është 15% dhe Tirana, Gjirokastra dhe Korça kanë nivel më të lartë se kjo mesatare, ndërsa në zona rurale penetrimi mesatar është vetëm 1.4%.


*Figura 15- Norma e penetrimit të telefonisë fikse sipas qarqeve dhe zonave urbane/Rurale (2016)*



Rënia e përdorimit të shërbimeve të telefonisë fikse vihet re edhe në reduktimin e sasisë totale të thirrjeve të gjeneruara nga rrjetet fikse. Sasia e thirrjeve telefonike të gjeneruara nga pajtimtarët e rrjetit fiks të Altelecom në Tremujorin IV 2015 u reduktua me 19% në krahasim me Tremujorin IV 2014, ndërsa gjatë vitit 2016 një përdorues i rrjetit fiks të Altelecom gjeneroi mesatarisht 65 minuta thirrje në muaj, krahasuar me 67 minuta në 2015.

Diferencat në përdorimin e telefonisë fikse në Shqipëri me vendet e tjera vihet re më mirë në grafikun e mëposhtëm, i cili paraqet ecurinë e numrit të pajtimtarëve për 100 banorë për Shqipërinë dhe mesataren botërore, të vendeve të zhvilluara dhe në zhvillim të këtij treguesi. Nga të dhënat vihet re se Shqipëria me 8% përdorim të telefonisë fikse ka një nivel disa herë më të ulët se vendet e zhvilluara (rreth 40%), rreth dy herë më të ulët se mesatarja botërore (15.2%), madje me të ulët edhe se mesatarja e vendeve në zhvillim (10%).

Figura 16- Norma e Penetrimit të telefonisë fikse në Shqipëri dhe vende të Tjera



Burimi: ITU dhe AKEP

Operatorët e rrjeteve fikse kanë rritur zonat e mbulimit me shërbime të rrjeteve fikse (telefoni dhe akses broadband) duke rritur dhe cilësinë e shërbimeve të aksesit broadband, megjithatë siç mund të vihet re shërbimet e telefonisë fikse kanë pasur tendencë rënëse, çka është e kundërt me tendencën e shërbimit të aksesit broadband nga rrjete fikse, si dhe shërbimet nga rrjetet celulare.

#### 7.1.4.2 Aksesit broadband nga rrjete fikse

##### Numri i pajtimtarëve

Megjithëse shërbimet e telefonisë nga rrjetet fikse kanë pasur reduktim të ndjeshëm në 5 vitet e fundit, shërbimet e aksesit broadband nga rrjete fikse kanë pasur rritje të qëndrueshme vjetore gjatë kësaj periudhe kohore.


Numri pajtimtarëve me akses broadband fiks në fund të vitit 2016 arriti në rreth 266 mijë, që përbën një rritje me rreth 9.7% në krahasim me vitin 2015.

Tabela 6- Ecuria e numrit të pajtimtarëve të aksesit broadband nga rrjete fikse 2010-2016

Numri i pajtimtarëve me akses në internet nga rrjete fikse	Albtelecom	Abcom	Abissnet	ASC	OA të tjerë	Total Broadband Fiks
2010	70,597	13,575	7,000	5,666	23,162	120,000
2011	60,055	29,321	15,321	10,129	24,871	139,697
2012	66,757	35,870	17,719	11,777	27,965	160,088
2013	73,242	43,430	20,562	15,432	29,890	182,556
2014	82,747	47,480	23,259	28,489	25,956	207,931
2015	97,597	51,093	24,497	31,357	38,326	242,870
2016	109,851	52,442	29,497	37,650	36,939	266,379
<b>Ndryshimi 2016/2015</b>	12.6%	2.6%	20.4%	20.1%	-3.6%	9.7%

Tabela e mësipërme jep në mënyrë më të detajuar ecurinë e numrit të pajtimtarëve me akses broadband në periudhën 2000-2016 si dhe për operatorët kryesorë në treg. Të gjithë operatorët kryesorë vihet re se kanë ecuri pozitive në 3-4 vitet e fundit. Albtelecom zotëron 41.3% pjesë tregu, që përbën një rritje vjetore me 1.1 pikë përqindje, i ndjekur nga Abcom me 20% pjesë tregu në vitin 2016, por me normë rritjeje më të vogël se operatorët e tjerë kryesorë në këtë treg.

Figura 17- Ecuria e pjesëve të tregut të aksesit Broadband nga rrjete fikse (2010-2016)



Tendencat e kundërta të zhvillimit të aksesit broadband nga rrjete fikse dhe telefonisë fikse vihen re në figurën më poshtë, ku shikohet se pavarësisht se në 2010 numri i pajtimtarëve me akses broadband ishte shumë më i vogël se numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse, në vitet 2015 dhe 2016 numri i pajtimtarëve me akses broadband nga rrjete fikse është më i madh se numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse.

Figura 18- Ecuria e pajtimtarëve të telefonisë dhe të aksesit broadband nga rrjete fikse 2010-2016




Figura e mëposhtëme paraqet ecurinë e penetrimit të aksesit broadband nga rrjete fikse për popullsi dhe familje në periudhën 2011-2016, ku mund të vihet re se të dy treguesit janë dyfishuar gjatë kësaj periudhe. Në fund të vitit 2016 rreth 33% e familjeve (1 në 3 familje) kishin akses broadband nga rrjete fikse. Penetrimi sipas popullsisë ishte 9.3% dhe Tirana dhe Durrësi janë qarqet me penetrim më të madh se niveli mesatar kombëtar, me rreth 17% dhe 11% respektivisht.

Figura 19- Penetrimi i aksesit broadband nga rrjete fikse sipas popullsisë dhe familjeve (2011-2016)





Figura 20- Penetrimi i aksesit broadband nga rrjete fikse sipas Qarqeve (2016)



### ***Paketat e integruara (Bundles)***

Të dhënat e mesipërme tregojnë se shërbimi telefonik për disa vjet tashmë rezultojn të ketë marrë rol dytësor në shërbimet nga rrjete fikse, ndërsa nxitësi kryesor i zhvillimit të këtyre rrjeteve janë shërbimet e aksesit broadband dhe sidomos shërbimet e integruara. Ofrimi i shërbimeve të rrjeteve fikse me paketa (bundles) të shërbimeve të aksesit në Internet, telefonisë fikse dhe TV (CaTV ose IPTV) rezultojn të jetë forma predominuese e konkurrencës midis operatorëve të rrjeteve fikse. Numri i pajtimtarëve të rrjeteve fikse që kanë akses në shërbime të integruara dyfishe ose trefishe (kombinim Telefoni/Internet/TV) në fund të vitit 2016 arriti në rreth 187 mijë, rreth 25 % më shumë se në vitin 2015. Në vitin 2016 pajtimtarët me paketa të integruara përbënin 70% të pajtimtarëve me akses broadband në rrjete fikse, ndërsa 35% janë me paketa trefishe (Telefoni, Internet dhe TV).

*Tabela 7- Numri i pajtimtarëve që kanë akses në shërbime të integruara*

	Totali me paketa të integruara	Telefoni fikse dhe Internet	Telefoni fikse, Internet dhe TV	Internet dhe TV
2014	119,230	78,419	24,330	16,481
2015	149,833	69,755	71,681	8,397
2015 T4	149,833	69,755	71,681	8,397
2016 T1	158,861	75,230	73,058	10,453
2016 T2	174,589	82,236	78,262	14,091
2016 T3	177,248	83,432	80,642	13,174
2016 T4	186,983	76,045	92,932	18,006
Ndryshimi Tremujor	5.5%	-8.9%	15.2%	36.7%
Ndryshimi v-m-v	24.8%	9.0%	29.6%	114.4%

Gjatë vitit 2015, numri i pajtimtarëve me shërbime të integruara në shporta triple play (Telefoni, Internet dhe TV), u rrit rreth 3 herë në krahasim me vitin 2014, ku kontributin më të madh në këtë rritje e kishte Altelecom, që pati rritje me 3 herë të këtij treguesi në vitin



2015. Ndonëse në vitin 2016, norma e rritjes së këtyre pajtimatrëve u ngadalësua në 22% për Altelecom (30% për të gjithë tregun), 69% e përdoruesve me akses broadband të Altelecom ishin me paketa trefishe.

Tabela e mëposhtëme paraqet ecurinë e numrit të pajtimtarëve të Altelecom me akses broadband dhe shërbime të integruara në periudhën 2013-2016. Ndërsa në vitin 2013 shumica e pajtimtarëve të Altelecom ishin me paketa dyfishe (Telefoni dhe Internet) dhe nuk kishte paketa trefishe, në fund të vitit 2016 rreth 69% e pajtimtarëve me akses broadband të Altelecom ishin pajtimtarë të shportave trefishe (Telefoni, Internet dhe IPTV).

*Tabela 8- Numri i pajtimtarëve të Altelecom me shërbime të integruara*

	2013	2014	2015	2016	Ndryshimi 2016/15
<b>Numri total i pajtimtarëve me akses broadband</b>	73,242	82,747	97,597	109,851	13%
<b>Numri i pajtimtareve që kanë akses në shërbime të integruara (TV, Internet, telefoni)</b>	70,961	76,230	93,873	109,034	16%
<b>Telefoni fikse dhe Internet</b>	70,961	60,939	32,293	33,673	4%
<b>Telefoni fikse, Internet dhe IPTV</b>		15,291	61,580	75,361	22%


### ***Teknologjia***

Teknologjia mbizotëruese për ofrimin e aksesit broadband në rrjete fikse është DSL e ndjekur nga kabllor koaksial. Shumica e lidhjeve DSL janë me rrjete të kombinuara fibër optike dhe bakri (FTTN/FTTC).

Figura e mëposhtëme paraqet shpërndarjen e lidhjeve broadband fikse sipas teknologjisë në Shqipëri dhe mesataren në vendet e BE. DSL është teknologjia kryesore në Shqipëri dhe në BE.

Në Shqipëri lidhjet DSL përbëjnë 63% të totalit të lidhjeve broadband fikse dhe shumica e tyre është me kombinim fibër optike + linjë bakri apo FTTN/FTTC.

*Figura 21- Lidhjet broadband fikse sipas teknologjisë Shqipëri v BE 2015/2016*




Burimi: AKEP dhe Digital Agenda Scoreboard KE

Lidhjet me fibër optike në Shqipëri (FTTH/B) përbëjnë 11% të totalit të lidhjeve, nivel i krahasueshëm me BE me 9%. Lidhjet kabllore në Shqipëri përbëjnë 21%, ndërsa NGA kabllor (DOC SIS 3.0 dhe më shumë) përbën 66% të totalit të lidhjeve kabllore, ndërsa në vendet e BE ato përbëjnë 80%. Pajtimtarët me lidhje në NGA (FTTx + NGA kabllorë) në Shqipëri përbëjnë 78% të të gjitha lidhjeve broadband, ku shumica e tyre janë në ADSL në FTTN/C, ndërsa në vendet e BE ky proporcion është 35% ku shumica janë VDSL, FTTH/B dhe Cable DOC SIS 3.0.

### Shpejtësia e aksesit broadband

Figura e mëposhtme tregon shpërndarjen e pajtimtarëve me akses broadband në internet në rrjetet fikse sipas shpejtësive të përdorura në 2014-2016. Siç mund të vihet re shpejtësia më e përdorur është 4-10 Mbps me 58% në 2016. Të dhënat tregojnë se proporcioni i pajtimtarëve me lidhje broadband me shpejtësi më të ulët se 4 Mbps ka ardhur në rënie ndërsa për shpejtësi mbi 4Mbps ka ardhur në rritje. Në 2016 rritjen më të madhe e kishte pjesa e pajtimtarëve me lidhje broadband me shpejtësi 10-30Mbps: nga 12 mijë në 2015 në 40 mijë në 2016.

Figura 22- Shpërndarja e pajtimtarëve me akses broadband fiks sipas shpejtësisë 2014-2016



Të dhënat e mësipërme tregojnë se rreth 93% e pajtimtarëve me akses broadband nga rrjete fikse kanë akses me shpejtësi 2Mbps ose më të lartë. Megjithatë pjesa e pajtimtarëve me shpejtësi më të ulët se 2 Mbps është rritur nga 5% në 2015 në 7% në 2016, ajo zë një peshë

shumë të vogël me totalin e lidhjeve broadband fikse. Të dhëna më të detajuara tregojnë se në intervalin 4-10 Mbps, pjesa më e madhe e përdoruesve janë me shpejtësi 4-6Mbps, ndërsa sipas ofertave të operatorëve kryesorë shpejtësia mbizotëruese në intervalin “256 kbps deri në < 2 Mbps” rezulton të jetë 1 Mbps.

#### 7.1.4.3 Përdorimi i përbashkët i infrastrukturës aktive dhe pasive në rrjetet fikse

Me qëllim promovimin e përdorimit të përbashkët të infrastrukturës aktive dhe pasive të rrjeteve fikse AKEP në vitin 2016 ka miratuar një sërë dokumentash si analizat e tregut të LLU, aksesit broadband me shumicë (bitstream) dhe linjave me qira në vitin 2014 dhe 2016 dhe rregulloren për përdorimin e përbashkët të faciliteteve në vitin 2015.

Disa prej këtyre masave rregulluese filluan të japin efekt në vitin 2015, dhe në vitin 2016 u vu re një rritje e përdorimit të elementëve aktivë (linja/kapacitete me qira) dhe elementëve pasivë të infrastrukturës së rrjeteve fikse. Gjatë vitit 2016 në ofrimin e kapaciteteve me qira rritje të ndjeshme pati ofrimi i linjave ndërkomëbate me rreth 5 herë duke arritur në rreth 8Gbps nga 1.4 Gbps në 2015. Zhvillime positive shënuan edhe ofrimi i infrastrukturës pasive si aksesit në dark fiber, tubacione, të cilat u rritën me 65% dhe 21% respektivisht. Kontribuesi kryesor në rritjen e aksesit në këto element pasivë ishte Albtelecomi, i cili ka rritur aksesin në 2016 me 170 km dark fiber dhe 23 km tubacione si dhe ATU me 147 km rritje të dhënies së aksesit në dark fiber. Albtelecom është ofruesi kryesor i aksesit me shumicë në elementët aktivë dhe pasivë të infrastrukturës në rrjete fikse. Në vitin 2016, 52% e fibrës optike dhe 82% e aksesit në tubacione janë ofruar nga Albtelecom, i ndjekuar nga ATU me 19% në dark fiber. Vlen të theksohet se Albtelecom ka kryer disa reduktime të tarifave me shumicë të aksesit në elementët aktivë dhe pasivë të rrjetit.

Tabela 9- Ofrimi me shumicë Linja/kapacitete me qira 2014-2016

	2014	2015	2016	Ndryshimi 2016/15
Ofrim akses në infrastrukturë aktive				
Numri I linjave/lidhjeve të dhëna	345	508	532	5%
Kombëtare	328	489	508	4%
Ndërkombëtare	17	19	24	26%
Kapaciteti total I dhënë me qira (Mbps)	34,793	36,826	44,423	21%
Kombëtare	33,392	35,346	36,464	3%
Ndërkombëtare	1,401	1,480	7,959	438%
Ofrim Akses në Infrastrukturë Pasive (Km)	-			
Dark fiber	927	924	1,529	65%
Akses në tubacione	19	61	74	21%

## 7.2 Tregu i Shërbimeve Postare

Kuvendi i Shqipërisë më datë 7.05.2015 miratoi Ligjin Nr. 46/2015, “Për shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë”. Ky ligj zëvendësoi Ligjin nr. 8530, datë 23.9.1999, “Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Ligji i ri paraqet një ndryshim të madh sa i përket liberalizimit të tregut të shërbimeve postare (Ligji 46/2015 është hartuar në përputhje të plotë me kuadrin ligjor të BE për sektorin postar), duke mundësuar në këtë mënyrë përshtatjen graduale të tregut me zhvillimet dhe dinamikën e ndryshimeve në fushën e teknologjisë së informacionit. Në bazë të përcaktimeve të ligjit 46/2015, AKEP paraqet në Kuvend raportin vjetor të veprimtarisë lidhur me shërbimin postar, i cili duhet të përmbajë:

- Informacion mbi ecurinë dhe tendencat e tregut të shërbimeve postare
- Veprimtarinë e AKEP-it për fushën e shërbimit postar
- Statusin e ofrimit të shërbimit postar.

### ***7.2.1 Informacion mbi ecurinë dhe tendencat e tregut të shërbimeve postare***

Subjektet e pajisur nga AKEP me “Çertifikatë të Konfirmimit të Njoftimit” për ofrimin e shërbimeve postare, të regjistruar në rregjistrin e AKEP deri në datën 31.12.2016 janë:

- Ofruesi i Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare sh.a.
- Ofruesit e shërbimeve postare (10 subjekte):
  1. Albanian Cargo Service sh.p.k (A.C.S)
  2. Albanian Courier sh.p.k (A.C)
  3. Albanian Delivery Express sh.p.k (ADEx)
  4. DHL International (Albania) sh.p.k
  5. RAD MAIL sh.p.k
  6. Sky Net Logistic sh.p.k
  7. TNT Express Albania sh.p.k
  8. Ulysses Enterprises sh.p.k (Fedex)
  9. United Transport sh.p.k (Uni Trans)
  10. Youth Albania Professional Services (YAPS)

#### ***7.2.1.1 Volumi i objekteve postare***

Numri total i objekteve postare të pranuar gjatë vitit 2016 nga Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare ishte 24,402,694. Numri i objekteve të pranuar nga Posta Shqiptare gjatë vitit 2016 është rritur me rreth **19 %** ndërsa numri i përgjithshëm i objekteve të pranuar nga Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare ka pësuar një rritje me **13 %** krahasuar me vitin 2015. Posta Shqiptare sh.a vazhdon të ruajë pozicionin e saj dominues në tregun e shërbimeve postare, duke zënë rreth **94 %** të tregut të shërbimit postar kundrejt **6 %** që zënë ofruesit e tjerë të shërbimeve postare.

*Figura 23- Ecuria e objekteve postare 2012-2016*




Tabela e mëposhtme paraqet numrin e objekteve postare, sipas kategorive kryesore, të pranuar nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare gjatë vitit 2016.

*Tabela 10- Të dhëna mbi kategorite kryesore të objekteve postare (2015-2016)*

Nr	Shërbime postare të ofruara	Objekte postare 2015	Objekte postare 2016	Ndryshimi 2016/2015
<b>Posta Shqiptare</b>				
<b>1</b>	<b>Shërbimi Universal Postar</b>			
1.1	Postë Brenda vendit	16,819,386	18,416,556	
1.2	Postë ndërkombëtare	1,702,982	1,221,931	
<b>1.3</b>	<b>Totali (1.1 + 1.2)</b>	<b>18,522,368</b>	<b>19,638,487</b>	<b>6%</b>
<b>2</b>	<b>Shërbim ekspres</b>			
2.1	Postë brenda vendit	686,680	679,095	
2.2	Postë ndërkombëtare	31,888	23,221	
<b>2.3</b>	<b>Totali (2.1 + 2.2)</b>	<b>718,568</b>	<b>702,316</b>	<b>-2%</b>
<b>3</b>	<b>Shërbim jo universal</b>			
3.1	Poste Brenda vendit	n/a	2,479,064	
3.2	Poste nderkombetare	n/a	6,534	
<b>3.3</b>	<b>Totali (3.1+3.2)</b>	<b>n/a</b>	<b>2,485,598</b>	
<b>3.4</b>	<b>Totali (1.3+2.3+3.3)</b>	<b>19,240,936</b>	<b>22,826,401</b>	<b>19%</b>
<b>Ofrues të shërbimeve postare</b>				
<b>4</b>	<b>Shërbim ekspres</b>	n/a		
4.1	Postë brenda vendit	n/a	1,216,225	
4.2	Postë ndërkombëtare	n/a	182,996	
<b>4.3</b>	<b>Totali (4.1+4.2)</b>	<b>n/a</b>	<b>1,399,221</b>	
<b>5</b>	<b>Shërbim jo universal</b>	n/a		
5.1	Poste Brenda vendit	n/a	167,275	


5.2	Poste nderkombetare	n/a	11,408	
5.3	<b>Totali (5.1+5.2)</b>	n/a	178,683	
<b>6</b>	<b>Shërbim ekspres/jo univer-sal</b>			
6.1	Postë brenda vendit	1,924,140	n/a	
6.2	Postë ndërkombëtare	195,171	n/a	
6.3	<b>Totali (6.1+6.2)</b>	2,119,311	n/a	
6.4	<b>Totali (4.3+5.3+6.3)</b>	2,119,311	1,577,904	
<b>7</b>	<b>Gjithsej(1.3+2.3+3.3+4.3+5.3+6.3)</b>	21,360,247	24,225,622	<b>13%</b>

Sipas të dhënave të dërguara nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare për vitin 2016, disa nga treguesit kryesorë të shërbimeve postare, për ofrimin e shërbimeve postare në raport me popullsinë dhe sipërfaqen e Republikës së Shqipërisë rezultojnë të jenë:

- Objekte postare gjithsej **24, 225,622** në raport me popullsinë (banorë rezident) 2.886.026 janë: **8.4 objekte / banorë**. (Tabela 10)
- Numri i zyrave postare të hapura për publikun 883 në raport me popullsinë 2.886.026 janë: **3,200 banorë / zyrë**. (Tabela 12)
- Numri i zyrave postare të hapura për publikun 883 në raport me sipërfaqen 28,748 Km<sup>2</sup> janë: **32.5 Km<sup>2</sup> / zyrë**. (Tabela 12)

Përdorimi mesatar për banor i shërbimeve postare në Shqipëri ( 10.1 objekte/banorë) vazhdon të jetë më i ulët në krahasim me vëndet e BE dhe të rajonit dhe pse shërbimet postare në këto vënde vazhdon të shënojë rënie të ndjeshme në sasi totale të objekteve postare (50-252 letra/banorë).

Figura 24- Objekte postare per banore ne vendet e BE



Burimi: WIK Consult

### 7.2.1.2 Tregues të rrjetit postar

Posta Shqiptare e cila ofron shërbim universal në të gjithë vendin me **559** zyra të hapura për publikun ka treguesit më të mirë të rrjetit, e ndjekur nga Albanian Courier, United Transport, Albanian Cargo Service, Albanian Delivery Express, DHL International Albania, etj. Në

përgjithësi prezenca e zyrave postare të ofruesve të tjerë, përveç Postës Shqiptare, është në qytetet kryesore të vendit.

Përsa i përket infrastrukturës së mjeteve postare, Posta Shqiptare ka në përdorim **430** mjete transporti, Albanian Courier **41**, Rad Mail **30**, TNT Express Albania **21**, Albanian Delivery Express **16**, DHL International Albania **13**, të pasuar nga Ofruesit e tjerë.

*Tabela 11- Numri i Zyrave postare të hapura për publikun (2015-2016)*

Ofrues te sherbimeve postare	2015	2016
Posta Shqiptare	552	559
Ofr. Te tjere	443	324
<i>Totali</i>	995	883


*Tabela 12- Tregues të rrjetit teknik sipas viteve 2012-2016*

Segmenti kohor	Zyra postare të hapura për publikun	Zyra postare jo të hapura për publikun
Viti 2012	839	21
Viti 2013	1278	34
Viti 2014	928	23
Viti 2015	995	28
Viti 2016	883	45

### **7.2.1.3 Të punësuarit**

Sektori postar karakterizohet nga përdorimi intensiv i forcës së punës dhe në shumë vende të BE, operatori postar publik është një ndër punëdhënësit më të mëdhenj të ekonomisë. Nga të dhënat statistikore të mbledhura nga Posta Shqiptare sh.a dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare, për vitin 2016 në sektorin postar ishin të punësuar 2,595 punonjës, duke ruajtur thuasë të njëjtin nivel punësimi me 2015. Më poshtë jepet ecuria e numrit të të punësuarve në sektorin e shërbimit postar për vitet 2012-2016.

*Figura 25- Ecuria e numrit të të punësuarve 2012-2016*



Posta Shqiptare ka 2,315 të punësuar, apo 74% të punësuarve në sektorin postar. Operatorët e tjerë postarë kanë një numër shumë më të vogël të punësuarish dhe operatori me numrin më të madh të të punësuarve është Albanian Courier me 57 punonjës në vitin 2016.

#### **7.2.1.4 Ankesat e përdoruesve (Reklamacionet)**

“Posta Shqiptare” ka pranuar gjatë vitit 2016, 871 ankesa, për të cilat ka zgjidhur 631 me një shumë kompensimi rreth 890 mijë lekë.

Gjatë vitit 2016 pranë subjekteve ofrues të shërbimeve postare janë depozituar 60 reklamacione të cilat kanë gjetur zgjidhje të gjitha nga ofruesit e shërbimeve postare, me një shumë kompensimi komplekse rreth 178 mijë lekë.

### **7.3 Rezultatet Financiare në tregun postar**

#### **7.3.1 Të ardhurat**

Bazuar në të dhënat e raportuara për vitin 2016 nga ofruesi i shërbimit universal postar dhe ofruesit e shërbimeve postare, të ardhurat financiare në tregun postar rezultojnë të jenë 2,079,437,005 Lekë. Pjesën më të madhe në këtë treg e zotëron Posta Shqiptare me një total të ardhurash 1,189,116,187 Lekë dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare kanë realizuar të ardhura në total 890,320,818 Lekë.

Të ardhurat nga shërbimet postare për vitin 2016 kanë pësuar rënie të lehtë me 0.3 % në krahasim me vitin 2015.



Tabela 13- Të ardhurat nga shërbimet postare për vitin 2016

Emri i personit (Juridik/ Fizik)	Totali i të ardhurave	Investime
ALBANIAN COURIER	87,990.693	3,693.014
Albanian Cargo Service	264.059	240.321
ADEX	41,686.573	4,963.003
DHL International Albania	335,938.359	4,774.852
Posta Shqiptare	1,189,116.187	194,715.354
RAD MAIL	50,230.226	12,623.077
SKY NET LOGISTIC	8,171.950	0.00
TNT EXPRESS ALBANIA	164,829.310	0.00
ULYSSES ENTERPRISES	124,451.303	0.00
UNITED TRANSPORT	57,220.719	5,226.156
YAPS	19,537.625	1,424.710
<b>Totali</b>	<b>2,079,437.004</b>	<b>227,660.487</b>

Në tabelat e mëposhtme paraqiten të ardhurat e realizuara nga sektori postar për vitin 2016, të ndarë midis të ardhurave të Postës Shqiptare dhe ofruesve të tjerë postar, si dhe të ardhurat e realizuara nga Posta Shqiptare të ndarë sipas shërbimeve.

Tabela 14- Të ardhurat e Posta Shqiptare sipas shërbimeve

<b>Posta Shqiptare Viti 2016</b>	
<b>Të ardhurat nga shërbimet postare</b>	1,189,116,187
Shërbimi postar universal	940,639,439
Shërbimi postar jo universal	45,335,044
Shërbimi postar ekspres	203,141,704

Në grafikët e mëposhtëm jepet shpërndarja e pjesëve të tregut postar bazuar në të ardhurat për vitin 2016 dhe të ardhurat sipas shërbimeve. Posta Shqiptare zotëron 57 % të tregut, e pasuar nga DHL Albania me 16 % të tregut dhe më pas nga TNT Express Albania me 7.9 %, Ulyses Enterprises 6 %, Albanian Courier me 4 %, dhe United Transport me 2.8 %.

Figura 26- Pjesët e tregut në të ardhura - 2016





Figura 27- Pjesë tregu në të ardhura sipas shërbimeve




### 7.3.2 Investimet

Gjatë vitit 2016, në sektorin postar janë realizuar investime rreth 227 milion Lekë, ose 68% më shumë se në vitin 2015.

Në figurën më poshtë paraqitet ecuria e të ardhurave dhe investimeve në tregun postar për periudhën 2012-2016.

Figura 28- Totali i të ardhurave/investimeve në sektorin postar gjatë periudhës 2012-2016



## II Puna gjatë vitit paraprak (2016)

### 8. Mbikqyrja e tregut të komunikimeve elektronike

Puna e AKEP gjatë vitit paraprak është udhëhequr nga angazhimi maksimal për zbatimin dhe përmbushjen e:

- Detyrimeve dhe objektivave rregullatore të përcaktuar në legjislacionin material,
- Politikat e zhvillimit sektorial të Këshillit të Ministrave,
- Rekomandimeve të Kuvendit,
- Direktivave të fushës të Komisionit dhe Parlamentit Europian,
- Akteve të BEREC, ERGP dhe ITU,
- Rekomandimeve sektoriale të Progres Raportit të KE për Shqipërinë,
- Programit vjetor të punës për vitin në vazhdim të paraqitur në Raportin vjetor të veprimtarisë së AKEP për vitin 2014.

#### 8.1 Mbikqyrja dhe rregullimi ekonomik i tregut

Ligji nr. 9918 parashikon që tregjet përkatëse kombëtare të komunikimeve elektronike dhe produktet përkatëse, të cilat justifikojnë rregullimin dhe janë subjekte të rregullimit të veçantë, përcaktohen në përputhje me përcaktimet e këtij ligji, me parimet e ligjit për konkurrencën dhe kushtet aktuale të tregut shqiptar, duke patur parasysh kërkesat e rregullimit të veçantë në sektor dhe rekomandimet e Bashkimit Evropian për tregjet përkatëse të produkteve dhe shërbimeve.

Përcaktimet e tregjeve, analizat e tyre dhe përcaktimi i sipërmarrësve, që kanë FNT, në tregjet përkatëse, bëhet nga AKEP në mënyrë periodike, por jo më pak se një here në dy vjet, në bazë të një rregulloreje, të hartuar në zbatim të këtij ligji dhe në përputhje me rekomandimet e BE-së.

##### 8.1.1 Rregullimi ekonomik i tregut të komunikimeve elektronike

AKEP, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9918, dhe Rregullores “Për Analizën e Tregut”, gjatë vitit 2016 për analizat e tregut u fokusua në:

- Kryerjen e procesit të analizës së tregut të shërbimeve më shumicë të aksesit broadband dhe linjave me qira (Këshillim Publik dhe vendimet përkatëse);
- Analizën e tregut celular (këshillim Publik).

### 8.1.1.1 Analiza e tregut të aksesit broadband dhe linjave me qira

AKEP gjatë vitit 2016 kreu procedurat e analizës së tregjeve me shumicë të aksesit broadband dhe linjave me qira. Periudha e këshillimit publik për dokumentin e “Analizë e tregjeve me shumicë të aksesit broadband ne Internet dhe Linjave me Qira- Keshillim Publik” tregut u krye në periudhën 15.06-15.08.2016, ndërsa për rregullimin e tarifave të shërbimeve më shumicë të operatorëve të propozuar me FNT, AKEP kreu një proces të veçantë këshillimi publik më 7.07-15.09.2016 për dokumetin “Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të aksesit broadband dhe në infrastrukturën aktive dhe pasive në rrjete fikse – Këshillim Publik”. Dokumenti i analizës së tregut përmbante rishikimin e përfundimeve të dy dokumentave të analizës së tregjeve me shumicë të aksesit në broadband si dhe të linjave me qira, të kryera në vitin 2014, duke marrë në konsideratë ri-përkufizimin e tregjeve përkatës nga Komisioni European në rekomandimin e vitit 2014.

Në përfundim të procesit të këshillimit publik pas shqyrtimit të komenteve të palëve të interesuara, AKEP më 22.12.2016 miratoi versionet finale të dy dokumentave të nxjerrë në këshillim publik dhe përcaktoi Altelecom si sipërmarrës me FNT dhe masat përkatëse rregulluese në tregjet e mëposhtëme:

- a. Tregun me shumicë të aksesit në nivel lokal në vendndodhje fikse (WLA)
- b. Tregun me shumicë të aksesit në nivel qendror për produkte të tregut të përgjithshëm (WCA)
- c. Tregun me shumicë të aksesit me cilësi të lartë në vendndodhje fikse (WHQA);

Masat përkatëse rregulluese për FNT të Altelecom përfshijnë ndër të tjera detyrimin e Altelecom për të dhënë akses në elementët aktivë dhe pasivë të rrjetit si LLU, akses bitstream dhe akses në tubacione në nivel lokal (zona urbane) dhe me tarifa nën-rregullim. Një theks i veçantë në këtë analizë tregu i’u kushtua aksesit në tubacione në nivel lokal (urban) dhe kombëtar (ndërrurbane). Në përfundim të procesit AKEP vendosi të sanksionojë si tarifa maksimale (tavan) për t’u aplikuar nga Altelecom për aksesin në tubacione në zona urbane tarifat e reduktuara nga vet Altelecom për këtë shërbim me 50% në Tetor 2016.

Tabela 15- Tarifat e aksesit në tubacione në rrjetin Altelecom (2015-2016)

	Tarife Filles-tare (Euro/km)	Tarifa Mujore (euro/km)								Ndryshimi ne %
		Deri me 30.09.2015	1.10.2015			1.10.2016				
	Distanca (Km)	Dia-metri (mm)	20 mm	deri ne 10 mm+0.5	>10-20 mm+0.5	>20-30 mm+0.5	deri ne 10 mm+0.5	10-20 mm+0.5	20-30 mm+0.5	20 mm
<b>D1</b>	<0.2	100	200	180	190	220	<b>80</b>	<b>90</b>	<b>100</b>	<b>-55%</b>

D2	0.2-5	80	160	120	145	179	60	73	90	-54%
D3	5-20	80	150	109	136	170	55	68	85	-55%
D4	20-40	80	140	104	128	160	52	64	80	-54%
D5	40-80	80	130	96	120	144	48	60	72	-54%
D6	80-160	80	120	88	112	136	44	56	68	-53%
D7	160-300	80	110	80	99	120	40	50	60	-55%
D8	>300	80	100	64	92	104	36	46	52	-54%

*Shënim: Tarifat në Euro pa TVSH*

Për aksesin në tubacione në nivel ndër-urban, ku ofrues të vetëm janë ATU dhe Albtelecom, AKEP gjykoj se problematika e mundshme mund të adresohet me instrumenta të tjerë ligjorë si zgjidhja e mosmarrveshjeve sipas Ligjit 9918, tarifat benchmark të publikuar nga AKEP për këtë shërbim dhe parashikimet më të detajuara dhe aktet nën-ligjore të Ligjit Nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”, të miratuar më 24.11.2016, ligj i cili ka për qëllim të lehtësojë e nxisë ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë (broadband), dhe synon të rregullojë jo vetëm aksesin në infrastrukturën e rrjeteve të sipërmarrësve të komunikimeve elektronike por edhe aksesin në llojet e tjera të infrastrukturës që zotërohen nga sipërmarrës në sektorë të tjerë si energji, ujë, transport rrugor etj, dhe që mund të përdoren për rrjetet e komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë.

Për tarifatat me shumicë e aksesit bitstream dhe LLU të Albtelecom AKEP përcaktoi rregullimin e tyre sipas metodës së përcaktimit të çmimit maksimal (dhe minimal për aksesin bitstream), duke i reduktuar ato me 18% nga niveliet e Tetor 2016. Këto vlera të reja të tarifave të këtyre shërbimeve u përcaktuan të hynë në fuqi më 1.07.2017 dhe ato përbënin një reduktim me 18% deri në 32% nga version i propozuar nga AKEP në këshillim publik. Bazuar në ankimin administrative të Albtelecom, AKEP në muajin Mars 2017 filloi një proces të ri këshillimi publik për vlerësimin e kërkesës së Albtelecom për rishikimin i tarifave të aksesit bitstream dhe LLU të miratuara me Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP me nr. 2703 dhe 2704, datë 22.12.2016

### **8.1.1.2 Analiza e tregut celular-këshillim Publik**

AKEP më 1.12.2016 miratoi nxjerrjen në këshillim publik të dokumentit “Analizë e tregut të shërbimeve celulare: tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare–Këshillim Publik”, dhe më 22.12.2016 publikoi për këshillim publik dokumentin “Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare – Këshillim Publik”.

Dokumenti i analizës së tregut përmban rishikimin e përfundimeve të analizës së tregut celular 2014, përfshirë analizën e zhvillimeve të ndodhura në treg dhe pritshmëritë në të ardhmen dhe masat rregulluese të propozuara për sipërmarrësit e vlerësuar me FNT, përfshirë për

propozimin për rregullimin e tarifave të terminimit celular, për të cilin u publikua një dokument më vehte i cituar më sipër. Nëpërmjet dy dokumentave të nxjerrë në këshillim publik AKEP ka propozuar ndër tjera:

- përcaktimin e katër operatorëve celularë me FNT për terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre respektive;
- vendosjen e masave rregulluese për FNT në terminim për të katër operatorët:
  - o Detyrimi i Mosdiskriminimit (përfshirë vijimin e detyrimeve për mos-diskriminim në tarifatat me pakicë të thirrjeve on-net/off-net);
  - o Detyrimi i transparencës;
  - o Detyrimi për akses dhe interkoneksion dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit;
  - o Detyrimi për kontroll të tarifave të terminimit;
- Aplikimin e tarifës 1.22 lek/minutë për terminimin e thirrjeve në rrjetet katër operatorëve celularë duke filluar nga 1.09.2017.

Periodha e këshillimit publik për dy dokumentat u mbyll më 07.02.2017, por AKEP bazuar në kërkesën e një prej operatorëve celularë vendosi për shtyrjen e këtyre proceseve deri në një afat maksimal dy mujor.


### ***Tarifatat e terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare***

Pas fillimit të zbatimit të vendimeve të AKEP në 2014-2015, për masat rregulluese për tarifatat e terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare dhe mos-diskriminimin në tarifatat me pakicë të thirrjeve on-net/off-net, AKEP në vitin 2016 mori dy vendime në muajt Janar dhe Prill 2016, të cilat përcaktuan shtyrjen me 3 muaj të afatit të fillimit të simetrisë së tarifës së terminimit të thirrjeve në rrjetin Plus (në nivelin 1.48 lek/minutë) me tre operatorët e tjerë celularë nga 1.01.2016 në 1.04.2016.

Këto vendime si dhe vendimet e Mars 2015, janë ankimuar në gjykatë dhe janë në nivele të ndryshme të gjyqimit në sistemin gjyqësor. Gjithsesi, vendimet e deritanishme kanë qenë për shfuqizime të vendimeve të AKEP, duke krijuar dhe probleme në lidhje me interpretimin juridik të pasojave dhe efekteve të lidhura me tarifën e terminimit të thirrjeve në rrjetin Plus. Së fundmi, Gjykata Administrative e Tiranës në vendimin e saj më datë 18.01.2017, ka bërë një sqarim në lidhje dhe me vendime të tjera të sistemit gjyqësor duke u shprehur se tarifa e terminimit të thirrjeve në rrjetin Plus Communication duke filluar nga data 1.04.2015 e në vijim duhet të jetë 6.52 lek/minutë sipas vendimeve të deritanishme të sistemit gjyqësor.

Figura e mëposhtme paraqet tarifat mesatare të terminimit MTR në secilin prej vendeve të BEREC të aplikuara më 1 Korrik 2016, si dhe tarifat mesatare në nivel BE 28 dhe në të gjitha vendet e BEREC (37 vende). Në këtë publikim për herë të parë përfshihet dhe Shqipëria<sup>14</sup> si vend që aderohet në BEREC.

Figura 29- Tarifat MTR sipas vendeve të BEREC (Korrik 2016)



Burimi: BEREC, BoR (16) 218, Dhjetor 2016

Nga informacioni i mësipërm rezulton se:

- Tarifa mesatare e thjeshtë e 28 vendeve anëtare të BE në 1 Korrik 2016 ishte 1.44 lek/minutë, ndërsa tarifa mesatare e ponderuar ishte 1.50 lek/minutë. Këto vlera janë shumë të përafërta me nivelin aktual të MTR në Shqipëri prej 1.48 lek/minute, me ndryshim +1% dhe -2%;
- Tarifa mesatare e thjeshtë e 37 vendeve të BEREC (që përfshin edhe vende të rajonit dhe Shqipërinë) më 1 Korrik 2016 ishte 1.57 lek/minutë, ndërsa mesatarja e ponderuar 1.76 lek/minutë. Këto vlera janë 6% dhe 19% më të larta se niveli aktual prej 1.48 lek/minutë në Shqipëri.

<sup>14</sup> Për Shqipërinë tarifa e terminimit më 1.07.2016 është raportuar në nivelin 1.48 lek/minutë për të katër operatorët sipas vendimeve të AKEP, me shënimin se tarifa e terminimit në rrjetin Plus Communication është objekt i Vendimeve të Gjykatave të RSH.



## 8.2 Administrimi i burimeve të fundme, autorizimet dhe facilitetet

Një aspekt shumë i rëndësishëm i veprimtarisë së AKEP-it është administrimi i regjistrimit të sipërmarrësve, burimeve natyrore të fundme (spektri i radiofrekuencave dhe numeracioni) si dhe çertifikatave e liçencave. Kjo veprimtari bazohet në kompetencat ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 9918/2008, i ndryshuar, sipas të cilave për të përmbushur qëllimin dhe objektivat rregullatorë të përcaktuara nga ky ligj AKEP-i ka kompetencë:

- Regjistrimin e sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike në përfundim të procesit të njoftimit;
- Bashkëpunon me Ministrin për hartimin e Planit Kombëtar të Frekuencave;
- Përgatit Planin e Përdorimit të Frekuencave dhe administron brezat e frekuencave të caktuara për qëllime civile, për përdorim publik ose privat, me përjashtim të brezit të frekuencave, të caktuara për transmetime radio e televizive, të cilat administrohen nga AMA;
- Lëshon autorizimet individuale për përdorimin e frekuencave;
- Kryen procedurat e përcaktuara, sipas këtij ligji, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, pas miratimit përkatës;
- Bashkërendon punën me administratat e vendeve fqinje dhe të vendeve të tjera për caktimin dhe përdorimin e radio-frekuencave, për pjesën e spektrit që administron;
- Harton, miraton dhe administron Planin Kombëtar të Numeracionit për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë;
- Cakton numrat dhe seritë numerike të sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike publike dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike;
- Siguron disponueshmërinë e një baze qendrore të dhënash për portabilitetin e numrit;
- Merr masat që, sipërmarrësit të zbatojnë detyrimet, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e interesave të vendit, të sigurisë publike edhe në rast lufte apo gjendje të jashtëzakonshme;
- Krijon, mirëmban dhe përditëson bazën e të dhënave elektronike për sektorin e komunikimeve elektronike dhe siguron që këto të dhëna, në formë informacioni, t'i bëhen të vlefshme publikut, në përputhje me rregullat për informimin publik dhe të ruajtjes së konfidencialitetit;
- Administrimin e informacionit mbi infrastrukturën e rrjeteve dhe të drejtën e kalimit.

Në zbatim të këtyre kompetencave dhe detyrave ligjore, AKEP, gjatë vitit 2016 ka kryer këtë veprimtari:

### **8.2.1 Autorizimi për të ofruar rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike sipas regjimit të autorizimit të përgjithshëm**

#### **8.2.1.1 Regjistrimi i Njoftimit**

Sipas ligjit 9918/2008, i ndryshuar autorizimi për të ofruar rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë bëhet:

- a) Përmes njoftimit, kur ofrimi i rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike nuk kërkon përdorimin e burimeve natyrore të kufizuar;
- b) Pas njoftimit dhe dhënies së të drejtës së përdorimit, në rastin kur ofrimi i rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike kërkon përdorimin e burimeve natyrore të fundme.

Ligji 9918/2008 përcakton kompetencën e AKEP-it për regjistrimin e sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike në përfundim të procesit të njoftimit, kompetencën e hartimit të rregullave për funksionimin e shërbimit të radiondërlidhjes bregdetare, si dhe rregullave dhe kërkesave teknike për funksionimin e shërbimeve radioamatore.

Autorizimi i hyrjes në treg të subjekteve për ofrim rrjetesh dhe shërbimesh publike të komunikimeve elektronike gjatë vitit 2016, është bazuar në dispozitat e rregullores “Për Autorizimin e Përgjithshëm” miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr. 1774 datë 02.02.2012, e ndryshuar gjatë vitit 2014 me qëllim përshtatjen e ndryshimeve ligjore të ligjit 9918 dhe për të përmirësuar aplikimin përkatës *on-line*.

Aplikimi *on-line* bazuar në kushtet e anekseve të rregullores, ka bërë të mundur marrjen e një informacioni të detajuar dhe të nevojshëm mbi:

- rrjetet/shërbimet që ofron sipërmarrësi;
- statusin ligjor, shoqëruar me ekstraktin e QKR-së;
- teknologjinë e përdorur dhe mediumet e komunikimit;
- kushtet e ofrimit të aksesit dhe shërbimit pajtimtarit-kontrata tip;
- të dhënat mbi masat e marra nga sipërmarrësit për garantimin e sigurisë së rrjetit.

AKEP, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9918/2008, dhe Rregullores “Për Autorizimin e Përgjithshëm”, mbi administrimin e Regjistrimit të Sipërmarrësve për Ofrimin e Rrjeteve dhe Shërbimeve Publike të Komunikimeve Elektronike përfshirë këtu edhe regjistrimin e operatorëve Audiovizivë, Regjistrimit të Liçencave të Përgjithshme të Operatorëve Publikë dhe Ofruesve të Shërbimeve Postare, si dhe Regjistrimit të Informacionit Periodik të Raportuar nga Sipërmarrësit, përgatit informacione periodike mujore për sipërmarrësit që kanë njoftuar

online për fillim/ndryshim/mbyllje aktiviteti për rrjetet dhe shërbimet publike të komunikimeve elektronike dhe i publikon ato në faqen elektronike të AKEP. Sipërmarrësit bëjnë përditësimin e ndryshimeve në Rregjistrin nëse ndryshimet kanë ndodhur më parë në Rregjistrin Tregtar të QKR.

Përmbushja e kushteve dhe ofrimi i rrjeteve dhe / ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike nga ana e sipërmarrësve që regjistrohen konform regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm, është e lidhur ngushtë edhe me zbatimin e rregulloreve të miratuara nga AKEP.

Sa i takon procesit të regjistrimit dhe trajtimit të aplikimeve për regjistrim si ofrues rrjetesh dhe ose shërbimesh publike të komunikimeve elektronike, në kuadër të zbatimit të Rregullores së Autorizimit të Përgjithshëm, DABFAF është angazhuar për të dhënë kontribut në përmirësimin e kuadrit rregullator konkretisht, Rregullores së Autorizimit të Përgjithshëm, për sa i takon ofrimin e shërbimit si MVNO. Për këtë qëllim janë draftuar rregullat dhe kushtet për ofrimin e këtij shërbimi.

#### ***8.2.1.2 Dhënia e autorizimeve, liçencave dhe çertifikatave për shërbimet ajrore/detare etj.***

Liçencat për stacion radio bregdetar, stacion radio në anije, stacion radio në avion, çertifikata për gmdss, radioa amatorë, janë lëshuar në përmbushje të kushteve dhe parashikimeve të:

- a. Rregullore Nr.7, datë 23.12.2008, “Për dhënien e licencës “Për stacionet radio të anijes”,
- b. Rregullore Nr.6, datë 23.12.2008, “Për dhënien e “Çertifikatës Operatorit Radiodetar”,
- c. Rregullore datë 23.12.2008, “Për dhënien e licensës “Për stacionet radio të avionit””.
- d. Rregullore Nr.5, datë 23.12.2008, “Për dhënien e Autorizimit “Për stacionet radio bregdetare”,
- e. Rregullore Nr.14, datë 13.04.2010, “Për dhënien e licencës “Autoritet i Llogarive Detare dhe Kodin AAIC”,
- f. Rregullore datë 13.04.2010, “Për shërbimet radioamatore në Republikën e Shqipërisë”,
- g. Rregullore Nr.21, datë 18.03.2011, “Për dhënien e Licencës së Përgjithshme për Ofrimin e Shërbimeve Postare”.

Këto rregullore pas përmirësimit të procedurës së aplikimit online nga subjektet e interesuara për t’u pajisur me liçencë/autorizim/çertifikatë, kanë bërë që afatet e trajtimit të këtyre aplikimeve të jenë më të shkurtra, duke zvogëluar edhe kostot për aplikantët.

#### ***8.2.1.3 Administrimi dhe publikimi i regjistrave të sipërmarrësve dhe liçencave.***

Gjatë vitit 2016 përveç regjistrit të sipërmarrësve janë përditësuar dhe regjistrat e shërbimeve të tjera me të dhënat e kërkuara sipas ligjit nr. 9918 dhe akteve rregullatore përkatëse, duke kryer periodikisht publikimin e tyre në “web site” të AKEP.

Sipas rregullores “Për shërbimet radioamatore në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me VKD të AKEP Nr.1222, datë 13.04.2010, e ndryshuar, është vijuar procesi për ndjekjen e procedurave për pajisje me liçencë dhe çertifikatë për radioamatorë, mbajtja e korrespondencës me aplikantët dhe zbardhja e liçencave të përkohshme për radioamatorët e huaj.

Gjatë vitit 2016, sipas procedurës së trajtimit të kërkesave për shërbimet e lëvizshme ajrore dhe detare, është vazhduar me regjistrimin e subjekteve aplikuese për liçenca/autorizime dhe çertifikata. Sipas kërkesave të parashikuara në rregulloret për shërbimet e lëvizshme ajrore dhe detare, janë evidentur në regjistra të veçantë të dhënat për subjektet e liçensuara për stacionet radio të anijes, stacionet radio të avionit, stacionet radio bregdetare, për autoritetin e llogarive detare dhe kodin AAIC dhe personat e pajisur me çertifikatën e operatorit radiodetar, të cilat janë publikuar në faqen web të AKEP.

Më poshtë paraqiten në mënyrë tabelare sipërmarrësit dhe autorizime /liçenca/ çertifikata të regjistruara në AKEP deri në fund të vitit 2016 si dhe të ndarë edhe për disa nga shërbimet kryesore të ofruara.

*Tabela 16- Regjistri i Sipërmarrësve që kanë njoftuar për ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike deri më 31.12.2016*

<b>Regjistri i Sipërmarrësve që kanë njoftuar për ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike, periudha 01.01.2011-31.12.2016</b>			
<b>Sipërmarrës të regjistruar sipas regjimit AP</b>	<b>Të regjistruar</b>		<b>Të çregjistruar</b>
Sipërmarrës të regjistruar për ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike;	198		89
Sipërmarrës që ofrojnë rrjete të komunikimeve elektronike që mundësojnë transmetimin e programeve audiovizuale	132		11
<b>Telefoni - 81</b>	<b>Fiks</b>	<b>Mobile</b>	<b>Kartë me parapagim</b>
	81	4	1
<b>Internet</b>	165		
<b>Shërbim me vlerë të shtuar</b>	24		
<b>Transmetim të dhënash</b>	44		
<b>Linja me qera</b>	20		

Deri më 31.12.2016:

- janë të regjistruar në total 198 sipërmarrës që ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime të komunikimeve elektronike, ku 33 prej tyre janë të regjistruar për vitin 2016;
- janë të çregjistruar me kërkesën e tyre (*kërkesë për mbyllje shërbimi*) në total 89 sipërmarrës që ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime të komunikimeve elektronike, 17 prej tyre janë çregjistruar në 2016;
- janë të regjistruar në total 132, sipërmarrës që ofrojnë rrjete të komunikimeve elektronike që mundësojnë transmetimin e programeve audiovizuale, ku 8 prej tyre janë të regjistruar për vitin 2016;
- janë të çregjistruar në total 11, sipërmarrës që ofrojnë rrjete të komunikimeve elektronike që mundësojnë transmetimin e programeve audiovizuale, ku 3 prej tyre janë çregjistruar në 2016.

Subjektet e pajisur me Çertifikata/Liçenca për periudhën: 1 janar 2016 - 31 dhjetor 2016 janë:

1. Çertifikatë Operatori Radiodetar të lëshuara	- 30
2. Liçencë për stacionet radio anije të lëshuara	- 7
3. Liçencë Radioamator i Huaj të lëshuara	- 15
4. Liçencë Radioamator shqiptar të lëshuara	- 10
5. Autorizim për stacionet radio avion të lëshuara	- 4
6. Autorizim për stacionet radio bregdetar të lëshuara	- 5

### **8.2.2 Harmonizimi i pajisjeve radio / Konfirmimi i miratimit të tipit / Njoftimet për 2.4/5.8**

Në veprimtarinë e DABFAF, përfshihen dhe procedurat e njohjes së konformitetit të pajisjeve radio të telekomunikacioneve dhe kushtet/kërkesat teknike të përdorimit të frekuencave pa autorizim.

Këto procedura DABFAF i kryen në zbatim të rregulloreve:

- Rregullore Nr. 25, datë 14.06.2012 “Për Pajisjet Radio dhe Fundore të Telekomunikacioneve dhe Njohjen e Konformitetit të tyre”;
- Rregullore nr. 33, datë 15.05.2014 “Për kushtet e përdorimit të frekuencave pa autorizim individual dhe kërkesat teknike për pajisjet radio që përdoren në këto breza”;

Në total për vitin 2016 janë lëshuar 6 konfirmime të Njohjes së Konformitetit të Pajisjeve dhe janë kryer 411 deklarime për brezin 2.4/5.8 GHz nga 12 sipërmarrës në sistemin e aplikimeve.

## 8.2.3 Veprimtaria për administrimin e spektrit të frekuencave dhe numeracionit

### 8.2.3.1 Lëshimi i autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave

Drejtoria e Administrimit të Burimeve të Fundme, Autorizimeve dhe Faciliteteve një ndër detyrat kryesore të saj ka edhe trajtimin e aplikimeve dhe pajisjen me autorizim individual për përdorimin e frekuencave.

Bazuar në nenin 4, pika 2 e Rregullores Nr.30 “Për dhënien e autorizimit individual për përdorimin e frekuencave”, miratuar me VKD nr. 2395, datë 05.12.2013, procedura e aplikimit për Autorizimin Individual për përdorimin e frekuencave, bëhet duke plotësuar nga aplikanti/kërkuesi që kërkon të pajiset me Autorizim Individual, format përkatëse të cilat gjenden të publikuara në faqen elektronike të AKEP web: [www.akep.al](http://www.akep.al) në seksionin e-Aplikime.

Një subjekt mund të aplikojë për caktim dhe përdorim frekuencash:

- Në brezat VHF, UHF. Sisteme Radiokomunikimi;
- Në brezat VHF, UHF. Sisteme Radioalarmi;
- Për Lidhje Fikse. Sisteme Pikë-pikë;
- Për Stacion Satelitor;
- Për Sisteme Tetra;
- Për Lidhje Fikse. Brezi i Frekuencave deri 1 GHz;
- Për Studim, Kërkim, Prove dhe Eksperimentim.

Në muajin Gusht 2016, AKEP vuri në funksion një platformë të re të aplikimeve online, sistemin RevZone. Mënyra e aplikimit është e njejtë por ka disa përmirësime në menaxhimin e aplikimeve.

Nga fillimi i vitit 2016, për operatorët e shërbimeve të komunikimeve elektronike janë lëshuar nga AKEP:

a) 23 autorizime individuale për përdorimin e frekuencave në 475 lidhje fikse të reja/ndryshuara, nga të cilat:

- Vodafone Albania - 12 (79 lidhje të reja, 256 ndryshime, 49 revokime)
- Plus Communication - 1 (7 revokime)
- Të tjera - 22 (342 lidhje të reja, 16 revokime)

Revokimi i lidhjeve fikse nga ana e sipërmarrësve ka ndodhur si pasojë e këtyre faktorëve kryesore:

- kalimi i lidhjeve në fibër optike,

- rikonfigurimi i sistemeve si pasojë e brezava te rinj të frekuencave të marra në përdorim.
- b) Aktualisht, kemi në total **230 subjekte** të pajisur me Autorizim Individual për përdorimin e frekuencave në sisteme PMR radiokomunikimi/radioalarmi. Nga këta 9 subjekte kanë shtrirje më të madhe duke mbuluar me shërbim pothuajse gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Pjesa tjetër e subjekteve kanë sisteme PMR në një zone më të kufizuar shërbimi.

Gjatë vitit 2016, Sektori i Administrimit dhe Koordinimit të Frekuencave dhe Numeracionit pas verifikimit të aplikimeve të ardhura ka konfirmuar 193 aplikime nga të cilat:

- 121 aplikime janë për sisteme të reja
- 28 aplikime për ndryshime në autorizimin ekzistues
- 44 aplikime për revokimin e frekuencave.

### **8.2.3.2 Revokimi i autorizimit individual për përdorimin e frekuencave të subjekteve debitorë me nismën e AKEP**

Lidhur me masat e marra për subjektet debitorë për moskryerjen e pagesave për caktim dhe përdorim të frekuencave, AKEP, bazuar në:

- Ligjit Nr.9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; pika 4 e nenit 62 “Administrimi i spektrit të frekuencave” dhe gërma d, pika 2, neni 76 “Revokimi i Autorizimit Individual”,
- Rregullores Nr.30, datë 05.12.2013 “Për dhënien e Autorizimit Individual për përdorimin e frekuencave”, miratuar me VKD Nr. 2395, datë 05.12.2013, gërma f, pika 3, neni 9,

më datë 30.06.2016, me anë të shkresave zyrtare ka përcjellë njoftimin për revokimin e Autorizimit Individual për përdorimin e frekuencave subjekteve debitorë të mëposhtme:

<b>Nr.</b>	<b>Subjekti</b>
1	Klaron sh.p.k.
2	Ylli - 01 sh.p.k.
3	Classic Radio Taxi sh.p.k.
4	Egnatia Televizion sh.a.
5	Radoja sh.p.k.
6	Rozafa sh.p.k.
7	Security and Protection Group sh.p.k.

## **8.2.4 Mbi procedurat për koordinimin e frekuencave dhe notifikimit të satelitëve që ndiqen nga AKEP**

### **8.2.4.1 Shtojca 30B të RR ITU, publikuar në BR IFIC.**

Spektori i Administrimit dhe Koordinimit të Frekuencave dhe Numeracionit administron seksionet speciale lidhur me shtojcën 30B të RR ITU, publikuar në BR IFIC. Nga verifikimet e kryera në softin BR IFIC në seksionin Publikime, Seksioni Special si dhe në fax-et e ardhura nga ITU bëhen konstatimet e njoftimeve për vendosjen në përdorim të rrjeteve satelitore.

Nisur nga të dhënat teknike të Seksionit Special identifikohen administratat e prekura, referuar pikave 6.3, 6.5 të nenit 6 dhe Aneks 4 (ANNEX 4 (Rev.WRC-12) Criteria for determining whether an allotment or an assignment is considered to be affected)) si dhe nenit 6.6 të Shtojcës AP30B (Appendix 30B, Rev.WRC-12).

Për rrjetet satelitore ku (ALB) identifikohet sipas pikës 6.6 të shtojcës 30B të RR së ITU (pranimi i nënshkrimit të një marrëveshje dypalëshe për përfshirjen e territorit të Shqipërisë në zonën e mbulimit me shërbim të rrjetit satelitor nën ekzaminim) vijohet procedura në përputhje me dispozitat e nenit 6 të Shtojcës 30B të Radio Rregullores së ITU.

Sa më sipër, Spektori Administrimit dhe Koordinimit të Frekuencave dhe Numeracionit ka nisur procedurat e koordinimit duke u kërkuar administratave të mëposhtme draft marrëveshjet për rrjetet satelitore:

- *BLR-FSS2-51.5E Satellite Network* (Ministry of Communications and Informatization of the Republic of Belarus);
- *BULSAT-30B-1.9E-s Satellite Network* ( Bulgaria Regulator – CRC);
- *MCO-FSS-52EA Satellite Network* (Direction des Communications Electroniques, Monaco);
- *KAZSAT-30B-58.5E-2 Satellite Network* (Ministry of Investment and Development Communication and Informatization Committee of the Republic of Kazakhstan)
- *IK-16W-F, IK-47.5W-F, IK-78E-F satellite networks* (Radio Frequency Service/ General Radio Frequency Centre/ Federal State Unitary Enterprise, Russian Federation).

Bazuar në pikën 5 dhe 6, të nenin 5, të Ligjit Nr. 9918 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, datë 19.05.2008, i ndryshuar, si dhe praktikave të vendeve të tjera lidhur me procedurën sipas Shtojcës 30B të RR së ITU (qëllimi i së cilës është garantimi për të gjitha vendet anëtare të CEPT, qasje të barabartë në orbitën satelitore gjeostacionare në brezat e frekuencave, të shërbimit fiks satelitor), AKEP ka përcjell për kompetencë te MIAP kërkesat e administratave të mësipërme.



#### **8.2.4.2 Seksioni CR/C i softit SpaceCom**

Forma e koordinimit nën të cilën kërkohen komentet është sipas dispozitës SS-TS (në përputhje me përcaktimet e pikës 9.11 dhe 9.14 të RR së ITU).

*Dispozita 9.14:-* Procedura për koordinim lidhur me vendet e afektuara “për transmetimin e stacionit hapsinor të një rrjeti satelitor për të cilin kërkesa për koordinim përfshihet në Tabelën e caktimit të frekuencave referuar kësaj dispozite ose dispozitës 9.11A të RR, në lidhje me stacionet marrëse të shërbimeve tokësore satelitore ku vlerat threshold janë tejkaluar”.

Sektori i Administrimit dhe Koordinimit të Frekuencave dhe Numeracionit, bën komentet përkatëse “Coordination Requested” në mënyrë që të sigurohet mbrojtja e frekuencave tona kombëtare, në brezat e përcaktuara në raportin e gjeneruar në BR IFIC.

#### **8.2.5 Bashkërendimi i punës me administratat e vendeve fqinje dhe të vendeve të tjera, për caktimin dhe përdorimin e radio-frekuencave për pjesën e spektrit që administrojnë**

AKEP vitet e fundit ka shtuar të gjitha përpjekjet për të bërë të mundur nënshkrimin e marrëveshjeve teknike me qëllim koordinimin ndërkufitar. Kryesisht është punuar për arritjen e marrëveshjeve të koordinimit për sistemet GSM/DCS1800 për të shmangur në maksimum interferencat në zonat kufitare. Janë në fuqi marrëveshjet me Autoritetin e Kosovës, të Malit të Zi dhe Autoritetin Maqedonas. Ndërkohë AKEP vazhdon bashkëpunimin me Autoritetin e Malit të Zi dhe Kosovës për menaxhimin e parametrave teknike të stacioneve të përcaktuara në marrëveshjet përkatëse dhe vendosjen e tyre në normat e lejuara.

#### **8.2.6 Hartimi, miratimi dhe administrimi i planit kombëtar të numeracionit për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë**

Në datën 01.07.2016 hyri në fuqi Vendimi i Këshillit Drejtues Nr.2631, datë 29.10.2015, me anë të së cilit AKEP miratoi “Përfundimin e këshillimit publik të dokumentit “Ndryshime në Planin Kombëtar të Numeracionit” dhe:

- Miratimin e ndryshimeve në Planin Kombëtar të Numeracionit,
- Miratimin e ndryshimeve në Rregulloren për Caktimin dhe Përdorimin e Numrave dhe Serive Numerike”.

Duke marrë në konsideratë ndryshimet e propozuara në PKN, AKEP ka rishikuar Rregulloren Nr.10 për “Caktimin dhe Përdorimin e Numrave dhe Serive Numerike dhe Planit Kombëtar të Numeracionit”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 932, datë 11.08.2009, e ndryshuar me VKD nr. 2350, datë 13.09.2013.

Janë bërë disa përmirësime në tekstin e rregullores së numeracionit më tepër të karakterit redaktiv duke e përshtatur me ndryshimet e ndodhura dhe janë përmirësuar disa përkufizime duke i përputhur ato me përkufizimet e dhëna në Ligjin nr.9918, datë 19.05.2008 "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Sa i përket ndryshimeve që janë bërë në PKN ata kanë të bëjnë përveç të tjerash dhe me përshtatjen e ndarjes së re administrative, Ligji 115/2014 "Për ndarjen administrativo - territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë" si dhe me kalimin në një rajon gjeografik, pa prekur strukturën dhe konfiguracionin aktual të ndarjes së NDC-vë.

Në PKN janë bërë përpjekjet për të përshtatur emërtimet e reja në përputhje me Ligjin 115/2014 "Për ndarjen administrativo - territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë" si:

- Njësia administrative
- Bashkia
- Qarku

Për të argumentuar ruajtjen e NDC-ve për një periudhë kohe të pacaktuar është përshtatur ndarja e re e territorit në njësi, bashki e qarqe me ndarjen e mëparshme në PKN sipas komuneve, bashkive të vogla dhe bashkive bazë.

Është bërë kujdes që të ruhen përcaktimet ligjore për rajonin gjeografik dhe ndarjet aktuale në zonat gjeografike (NDC) sipas njësisve administrative dhe bashkive me qëllim ruajtjen e parimit të alokimit parësor të deritanishëm.

Si përfundim AKEP, me këto ndryshime realizoi kalimin nga 12 rajone gjeografike në një rajon gjeografik duke hequr informacionin gjeografik në përdorimin e numrave (rajonet) dhe pa prekur në thelb planin e numërformimit.

Ky ndryshim thelbësor rrit efektivitetin e përdorimit të numrave, i përgjigjet:

- ndryshimeve të mëdha demografike që kanë ndodhur në Shqipëri dekadën e fundit, veçanërisht rritja e madhe e popullimit të zonave urbane si Tirana, Durrësi etj.
- Zhvillimit të rrjeteve të gjeneratës së re, nëpërmjet të cilave bëhet i mundur ofrimi ishërbimeve broadband dhe nëpërmjet saj reflektimi i ndikimeve në PKN të migrimin të rrjeteve TDM në rrjetet NGN, si dhe
- zgjerimit të zonës gjeografike për portabilitetin e numrit.

#### ***8.2.6.1 Caktimi i numrit dhe serive numerike të sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike publike dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike***

Aplikimi për numrat dhe seritë numerike është pothuaj i automatizuar duke eliminuar kështu thuajse të gjitha procedurat ndërmjetëse administrative që zgjasnin këtë proces. Është ngritur sistemi i menaxhimit të Planit të Numeracionit që përfshin të gjithë kategoritë e numrave dhe matricën e ndërfaqur online.

Gjatë vitit 2016 janë përpunuar dhe procesuar:

- Alokime numra dhe seri numerike, janë trajtuar 38 aplikime.
- Anullim numeracioni, janë trajtuar 22 aplikime

#### ***8.2.6.2 Procedura e anulimit të numeracionit***

Në zbatim të Urdhrit të Krytarit për inspektimin në distancë, Drejtoria e Administrimit të Burimeve të Fundme, Autorizimeve dhe Faciliteteve, në bashkëpunim edhe me Drejtorinë e Menaxhimit Financiar dhe Pagesave, ka ndërmarrë kryerjen dhe verifikimin e përmbushjes së detyrimeve lidhur me shlyerjen e pagesave nga subjekte të cilët janë pajisur me numeracion dhe me anë procedurës së inspektimit në distancë, është administruar informacionit i përfutur.

Subjektet e pajisur me numeracion janë inspektuar, lidhur me përmbushjen e detyrimeve dhe zbatimin e:

- Ligjit nr. 9918/2008 i ndryshuar dhe rregulloreve të nxjerra në zbatim të tij;
- Rregullores nr. 20, datë 19.2.2010 “Për pagesat për mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike” e ndryshuar;
- Kushteve të përcaktuara në Autorizimin Individual për përdorimin e frekuencave;
- Rregulloren Nr.10 datë 11.8.2009 për “ Caktimin dhe Përdorimin e Numrave dhe Serive Numerike dhe Planit Kombëtar të Numeracionit”;
- VKM nr. 599, datë 23.07.2010 “Për miratimin e pagesave që kryhen në Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, të numrave dhe të serive numerike” ndryshuar.

Në përfundim të këtij verikimi, është konstatuar se disa prej subjekteve të cilëve ju është caktuar numeracion, për ofrimin e rrejteve/shërbimeve publike të komunikimeve elektronike: *Ofrim shërbimi telefonik publik; Ofrimi shërbimi me vlerë të shtuar SMS, VAS etj*, nuk kanë zbatuar detyrimet lidhur me kryerjen e pagesave në AKEP, konform VKM nr. 599, datë 23.07.2010.

Në përfundim të këtij verifikimi, nga DABFAF, në zbatim të Rregullores nr. 10, datë 11.08.2009 neni 30, e në vijim, është proceduar me anulimin e numeracionit për subjektet debitorë. Në përfundim të këtij procesi, janë anuluar numeracionet për 11 subjekte.

### **8.2.7 Mbikqyrja e Faciliteteve**

Në zbatim të Planit Kombëtar të Zhvillimit të Broadband miratuar me VKM 300, datë 08.04.2015, i ndryshuar, drejtoria DABFAF, ka ndjekur në vijimësi përmbushjen e detyrimeve të marra përsipër nga sipërmarrësit Albtelecom sh.a., Telekom Albania sh.a. dhe Vodafone Albania sh.a., për mbulimin me shërbime broadband në zonat me densitet të ulët të popullsisë dhe të zonave për përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar.

Për të koordinuar veprimet mes sipërmarrësve të lartpërmendur dhe institucioneve si Autoriteti Rrugor Shqiptar, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, AKEP, ka nënshkruar Marrëveshje Bashkëpunimi, ku palët bien dakord të koordinojnë veprimet dhe shkëmbejnë informacionin e nevojshëm në fushën e ndërtimit të infrastrukturës së komunikimeve elektronike. Në këtë kontekst, informacioni i marrë nga këto institucione ARRSH, FSHZH dhe Bashkitë përkatëse iu është vënë në dispozicion operatorëve duke u publikuar edhe në faqen e AKEP.

Nga DABFAF në mënyrë periodike është ndjekur procesi i përmbushjes së detyrimit për mbulim me shërbime broadband nga operatorët, duke iu kërkuar në mënyrë periodike të raportojnë për ecurinë e procesit gjatë gjithë 2016. Gjatë këtyre raportimeve, përveç të tjerave, operatorët kanë ngritur problematika në lidhje me procedurat e pajisjes me leje infrastrukturore, në disa zona të caktuara ku kanë hasur vështirësi në realizimin e investimeve, duke theksuar procedurat e tejzgjatura të dhënies së lejeve nga disa Bashki. Me qëllim përshpejtimin e procesit të marrjes së këtyre lejeve nga operatorët, AKEP iu është drejtuar Ministrisë së Zhvillimit Urban, Ministrisë së Kulturës, Ministrisë së Mjedisit, Ministrit të Shtetit për Cështjet Vendore. Këto institucione i janë përgjigjur menjëherë kësaj kërkesë duke ofruar bashkëpunim dhe ndihmë në këtë proces, duke sensibilizuar edhe Bashkitë e zonave përkatëse.

#### **8.2.7.1 Atlasi**

Në zbatim të ligjit nr. 9918/2008, AKEP ka miratuar rregullore lidhur me përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe aseteve të rrjeteve të komunikimeve elektronike publike dhe Rregullore për Përmbajtjen, formën dhe funksionimin e regjistrit elektronik të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë, i cili përmban informacion mbi: rrjetet publike të komunikimeve elektronike, objektet e komunikimeve elektronike, të dhëna për rruge kabllore dhe për radio transmetuesit. Ky informacion hidhet nga Operatorët e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike të cilët kane akses online në regjistrin elektronik.

Në vijim të bashkërendimit të veprimeve me të gjithë aktorët e interesuar për shkëmbim i informacioni për rrjetin e komunikimeve elektronike vlen për t'u theksuar miratimi akteve si më poshtë:

- Ligj nr. 120/2016 për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 851, datë 7.12.2016, që ka parashikuar kushtet për kalimin e të dhënave mbi shtrirjen e rrjetit të infrastrukturës inxhinierike tek bashkitë.

Akses tek ky regjistër elektronik, kanë edhe subjekte të tjerë të interesuar për të dhënat mbi rrjetet e komunikimeve elektronike si Bashkitë apo njësitë e tjera administrative. Sipërmarrësit dhe përfaqësuesit e bashkive, janë njoftuar në vazhdimësi nga AKEP në lidhje me mundësimin e aksesit duke u pajisur me kodet përkatëse.

Në kuadër të zhvillimit të mëtejshëm të kësaj infrastrukture dhe për të rritur nivelin e sistemit ekzistues është parë mundësia e përmirësimit të sistemit aktual dhe veçanërisht në penetrimin me informacion deri në njësinë fundore të rrjetit, kryerjen e analizave ad-hoc, gjenerimin e raporteve të rregullta etj.

Në kuadër të “Projektit të Binjakëzimit” me Rregullatorin Polak<sup>15</sup>, janë shkëmbyer vizita mes palëve, me qëllim vlerësimin në praktik të sistemit ekzistues të AKEP dhe njëkohësisht marrjen propozimeve lidhur me hartimin e specifikimeve teknike për t’u bërë pjesë e dokumentit të tenderit. Gjithashtu është përgatitur Raporti teknik mbi “Upgrade” in e sistemit, duke u fokusuar në specifikimet teknike të nevojshme për plotësimin e dokumentacionit të tenderit për sistemin e hartës së rrjeteve broadband në Shqipëri. Pas marrjes së raportit final nga konsulenti me specifikimet teknike të cilat do të jenë pjesë e procedurës për zbatimin e projektit “Upgrade i Sistemit të Përqendruar të Informacionit për rrjetet e komunikimeve elektronike” u përcaktua vlera e projektit në shumën 14,000,000 lekë, e cila do të përfshihej në planin e investimeve të AKEP.

Projekti konsiston në:

- Përmirësim (Upgrade) dhe mirëmbajtje e platformes Web GIS - Atlasi Elektronik i AKEP;
- Konsulencë teknike për shtesa në standardin e formatit të të dhënave të shkëmbyera për rrjetet e komunikimit elektronik dhe përmirësimin e bazës së të dhënave për menaxhimin optimal të shtresave hapësinore;
- Krijimi i një sistemi për pranimin, monitorimin dhe administrimin e të dhënave të rrjeteve të komunikimeve elektronike;
- Implementimi i një rregulli dhe analizë "ad hoc" në varësi të kërkesave të AKEP-it;
- Sigurimi i mbështetjes profesionale teknike në menaxhimin e të dhënave dhe konsulencë GIS.

---

<sup>15</sup>Eksperiencia e shtetit Polak në lidhje me sistemin e pasqyrimin në hartë të infrastrukturës së broadband –it është vlerësuar si eksperiencia më e mirë në BE.

### **8.2.7.2 QoS project**

Gjithashtu, në kuadër të programit të binjakëzimit, nën kujdesin e ITU-së, AKEP ka finalizuar Dokumentin “Technical Terms of Reference (ToR) për QoS PROJECT”. Me qëllim shkëmbimin e njohurive, përvojës dhe zgjidhjet në lidhje me matjet e QoS në Poloni, janë kryer vizita në të dy vendet, Shqipëri dhe Poloni, si nga ekspertët e AKEP ashtu edhe ata të ITU.

## **8.3 Monitorimi i spektrit të frekuencave, cilësisë dhe inspektimit**

Për të garantuar ushtrimin e kompetencës ligjore lidhur me mbikëqyrjen, kontrollin dhe monitorimin e veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike, në përputhje me këtë ligj dhe aktet e tjera në zbatim të këtij ligji, veçanërisht të zbatimit të kushteve të përgjithshme të përcaktuara në Autorizimin e Përgjithshëm si dhe të përdorimit të frekuencave dhe numeracionit në përputhje me kushtet e përcaktuara në Autorizimet Individuale, AKEP-i kryen në mënyrë të vazhdueshme inspektimin e veprimtarisë së sipërmarrësve, monitorimin e cilësisë së shërbimit dhe monitorimin e përdorimit të spektrit prej tyre.

Detyrat për ushtrimin e veprimtarisë së inspektimit, monitorimit të cilësisë dhe monitorimit të spektrit si dhe vendosja e masave administrative kryhen nga Drejtoria e Monitorimit të Frekuencave, Cilësisë dhe Inspektimit (DMFCI).

AKEP ka realizuar të gjitha objektivat e përcaktuara për vitin 2016, duke punuar me përgjegjësi, profesionalizëm dhe përkushtim me qëllim përmbushjen e detyrave, në zbatim të kuadrit ligjor dhe nënligjor aktual, si pjesë përbërëse aktive e Drejtorisë së Monitorimit të Frekuencave, Cilësisë dhe Inspektimit pranë Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

### **8.3.1 Ndjekja e Inspektimeve dhe problematika të sipërmarrësve të komunikimeve elektronike.**

Zyra e Koordinimit të Inspektimit, në zbatim të rregullores Nr.34, datë 23.12.2014 “Për Inspektimin, monitorimin e spektrit të frekuencave dhe masat administrative”, ndryshuar me Rregulloren Nr.46, datë 27.10.2016 “Metodika e Inspektimit të Veprimtarisë së Sipërmarrësve të Rrjeteve dhe Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike”, Nr.2695, datë 27.10.2016 dhe Urdhërit Nr.1390 prot, datë 22.01.2015 "Për procedurën e inspektimit në distancë, administrimin e informacionit të përfutur dhe planifikimit të tematikës të inspektimit dhe monitorimit”, për në vitin 2016 ka kryer gjithësej 51 inspektime tek sipërmarrësit e komunikimeve elektronike të regjistruar në regjistrin e sipërmarrësve që ofrojnë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike sipas regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm.

Gjatë këtyre inspektimeve u konstatua se 15 sipërmarrës ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike në përputhje me kushtet e Autorizimit të Përgjithshëm (disa prej të cilëve ju lanë disa detyra dhe rekomandime), dhe 36 sipërmarrës nuk kishin zbatuar rregulloret e miratura nga AKEP dhe për këto shkelje u vendosën masa administrative me gjobë dhe u çregjistruan sipas ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Objekti i inspektimeve sipas planit vjetor ka qenë verifikimi i zbatimit të:

- Kushteve të përcaktuara në Autorizimin e Përgjithshëm
- Kushteve të përcaktuara në Autorizimin Individual për përdorimin e frekuencave.
- Kushteve të përcaktuara në aktet normative të AKEP

### ***8.3.2 Ndjekja e arkëtimeve të pagesave nga debitorët e AKEP***

Vëmendje e veçantë i është kushtuar çështjes së arkëtimit të pagesave të pashlyera nga sipërmarrësit sipas parashikimeve ligjore dhe Zyra Koordinimit të Inspektimeve nga data 19 shtator - 30 Dhjetor 2016 ka mundur të arkëtojë në llogarinë bankare të AKEP përkatësisht shumën 3.898.022 lekë për sipërmarrësit debitorë.

Sipërmarrësve të kontaktuar nga Zyra Koordinimit të Inspektimeve i’u dhanë faturat me detyrimet financiare për shlyerjen e detyrimeve financiare në llogarinë bankare të AKEP. Në çdo rast Zyra Koordinimit të Inspektimeve i’u bëri me dije sipërmarrësve të kontaktuar detyrimet që rrjedhin nga ligji nr. 9918 datë 19.05.2008, i ndryshuar Udhëzimi Nr.28, datë 6.10.2014 “Për caktimin e tarifës së shërbimit për shërbimin e radiokomunikimit”, si dhe VKM Nr. 599, date 23.07.2010 “Për miratimin e pagesave që kryhen në AKEP, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave të numrave dhe serive numerike”.

### ***8.3.3 Marrjen e masave organizative dhe operative për detyrimin e sipërmarrësve lidhur me zbatimin e rregullave teknike për rrjetet.***

Për zbatimin e rregullave teknike të përcaktuara në ligjin nr. 9918 dhe Rregulloren Nr.22 datë 24.06.2011 “Mbi kushtet teknike për ndertimin e infrastruktures së rrjeteve kabllore urbane dhe rrjeteve me fibra optike nderurbane të komunikimeve elektronike”, është punuar për detyrimin e sipërmarrësve të cilët ndërtojnë ose përdorin rrjete të komunikimeve elektronike dhe ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike, që të zbatojnë kushtet e parashikuara në legjislacion për të mos rrezikuar jetën dhe shëndetin e qytetarëve.

Gjatë vitit 2016 u arrit të bëhet një përmirësim rrënjësor i këtyre rrjeteve në qytetet kryesore të vendit, ku u shmangën rrjetet e komunikimeve elektronike nga rrjetet e energjisë dhe në shumicën e rrugëve kryesore dhe qendra tashmë kanë përfunduar ose është në proces përmbyllja e shmangieve.

Kjo është një arritje e rëndësishme për garancinë e rrjeteve në uljen e rrezikshmërisë të këtyre instalimeve të rrezikshme për jetën e personelit të sipërmarrësve, përmirësimi i mirëmbajtjes si të rrjeteve të komunikimeve elektronike, por dhe të energjisë dhe ndriçimit.

Masat e marra deri tani kanë sjellë në zonat e ndërhyra një gjendje krejtësisht tjetër si në sigurimin teknik dhe treguesit e cilësisë së shërbimit por edhe në aspektin estetik dhe urbanistik të këtyre zonave. AKEP ka krijuar mundësinë e konsultimit me web-in e AKEP në adresën: <http://www.akep.al/foto-galeri>).

AKEP vazhdimisht ka informuar me shkresë dhe njoftime zyrtare sipërmarrësit e rrjeteve, me përjashtim të zonave shumë problematike ose që janë në proces ndërtimi të infrastrukturës ose të lejeve nga Bashkitë, ku ka një plan me AKEP, për pjesën tjetër mbas datës 1 Janar 2017 nuk do ketë asnjë shtyrje dhe do të aplikohen penalitetet që parashikon ligji.

Ashtu si AKEP ka deklaruar, viti 2016 dhe 2017 janë vite të stabilizimit të rrjeteve dhe infrastrukturës urbane dhe instalimeve në segmentin e fundit.

Fillimisht Plani i zbatimit u perqendrua në disa rrugë kryesore të bashkisë Tiranë të evidentuara si zona me problematikë të lartë përsa u përket rrjeteve kabllore.

Plani filloi zbatimin me Rrugën e Fortuzit dhe rrugët e gjithë lagjeve të asaj zone. U larguan kabllot nga qindra shtylla elektike dhe shtylla ndriçimi si dhe nga dhjetëra traversime të ulëta. Me tej u vijua me rrugët Zona e Laprakës si rrugë shumë e ngarkuar me kabllot në shtyllat elektrike dhe ndriçimit. Edhe në këtë rrugë u pastruan dhjetëra shtylla nga kabllot e rrjeteve.

Puna vijoi pastaj në pothuajse të gjitha rrugët brenda Unazës së Vogël të Tiranës ku gradualisht u pastruan kabllot në shtyllat në shumicën e këtyre rrugëve, ndërkohë që vazhdon largimi i kabllave nga vetë operatorët në ato rrugë të parashikuara në Planin e Veprimit.

Në Tiranë përfunduan zonat tek Posta Shqiptare, Rr.Rreshit Collaku, Hotel Evropa dhe zona e Shallvareve. Tani po punohet tek Pallatet Agimi, Zona Moskate - Nikolla Tupe dhe më tej në zonën e Tiranës së Re, kryesisht në grup pallatet e ndërtuara para viteve 90 ku instalimet janë jashtë cdo kushti teknik dhe estetik, sipas planit të veprimit të koordinuar nga AKEP.

Duke bashkëpunuar dhe me Bashkinë e Tiranës, aty ku ka ndërtime ose rikonstruksione të infrastrukturës, po përfundojnë ose kanë përfunduar rrjetet në zona Don Bosko, Selita, rruga Ali Shefqeti, Fadil Rada si dhe në cdo investim të ri .

Qendra e vemendjes ka qene eliminimi i intersektimeve të çrregullta, që krijojnë imazhin e një “fole merimange” në cdo bllok banimi dhe rrugë. Në këtë aspekt, do të sistemohen fasadat në gjendje shumë të rënduar me rrjete kabllore, ku nga puna e kryer deri tani, rezulton se më shumë se 80% e tyre janë jashtë funksioni dhe janë kthyer në një shqetësim edhe për komunitetin, të cilin AKEP e mbështet në cdo nismë për mos lejimin e instalimit nga operatorët, të kabllave ajrorë në shkelje të kushteve teknike të Rregullores Nr.22.



Llojet e kabllave u evidentuan fibra optike, kablllo dyfillore telefonie, kablllo koaksiale, kablllo ethernet, etj. Vlen të theksohet se gati 50 % e kabllave në shtylla nuk përdoren nga operatorët e rrjeteve dhe ishin lënë nëpër shtylla pa u hequr kur abonentët ose grupe abonentësh largoheshin nga operatori përkatës.

Puna vazhdoi edhe në qytetet e tjera të vendit ku përmendim Durrësin, Fierin, Lezhën, Lushnjën, Elbasanin, Pogradecin, Gjirokastrën, Vlorën, etj. Nga rrugët kryesore të këtyre bashkive u pastruan dhe sistemuan kabllot në mijra shtylla të OSHEE dhe shtylla të ndriçimit të bashkive, duke eliminuar rrezikshmërinë nga këto kablllo, peshën e tyre në shtylla, anën estetike të kabllave dhe duke liruar hapësira të tëra publike nga këto lloj kablllosh.

Vlen të përmendet që në disa qytete u vërejt ndërhyrja e bashkive për rikonstruksionin e rrugëve dhe bulevardëve, gjë e cila solli edhe sisteminimin e kabllave në këto rrugë nga kablllo ajrore, operatorët i kaluan në kablllo nëntokësore duke shtrirë tubacionet e tyre, të përbashkëta ose veç e veç ose duke kaluar në tubacionet e bashkisë përkatëse.

Sistemimi i kabllave në shtyllat e rrugëve kryesore të bashkive ka sjellë dhe përmirësimin e vetë rrjeteve të operatorëve, sepse:

- Rrjetet nëntokësore janë më të garantuara përsa i përket funksionalitetit dhe janë shumë më pak të ekspozuara ndaj dëmtimeve, qoftë njerëzore dhe qoftë atmosferike;
- Shumë pjesë të rrjeteve janë zëvendësuar me fibra optike çka përmirëson rrjetin e operatorit, ndryshon teknologjitë në bashkëkohore dhe siguron cilësi shërbimi shumë më të lartë për abonentin;
- Janë riorganizuar shumë nyje (pika shpërndarje) të rrjeteve të operatorëve me qëllim rritjen e performancës së rrjetit.

AKEP gjatë gjithë vitit 2016 ka mbikëqyrur vazhdimisht punën e vetë sipërmarrësve të rrjeteve për largimin dhe sisteminimin e kabllave të rrjeteve të tyre dhe ndërhyrjen në fasadat e apartamenteve në disa zona të nxehta të Tiranës.

Sipërmarrësit në përgjithësi kanë bashkëpunuar me AKEP si në trajtimin e problematikave të trajtuara shkresërisht, në takimet që AKEP ka organizuar për këtë problem, në terren me punonjës të specializuar dhe AKEP pret sërish bashkëpunimin e tyre gjatë vitit 2017 për vijimin e këtij procesi.

Vërehet gjithashtu rritja e përgjegjshmërisë së sipërmarrësve të rrjeteve ndaj këtij problemi, pasi sisteminimet e kabllave pas largimit nga shtyllat bëhen në mënyrë më të kujdesshme dhe tentohet drejt instalimeve të teknologjive bashkëkohore me preferencë fibrën optike ku siç dihet një fibrë optike zëvendëson shumë kablllo të tjera.

AKEP, ashtu si ka vepruar deri tani, do të koordinojë punën mes operatorëve dhe bashkëpunimin me OSHEE, për koordinimin e punëve në zona ku ka ndërthurje të rrjeteve si dhe do të jetë në ndjekje të planit në dinamikë.

Kjo ndërhyrje është e domosdoshme dhe në kohën e duhur dhe do të kërkohet bashkëpunim dhe nga istancat lokale, për sa ato janë përgjegjës për të disiplinuar përfundimisht këtë pjesë shumë problematike dhe jashtë kushteve, në disa raste dhe atyre më minimale, që kërkohen për mirëfunksionimin e tyre në standartet e kërkesave të rrjeteve Broadband.

#### **8.3.4 Monitorimi i spektrit të frekuencave**

Në zbatim të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, i ndryshuar, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, rregullores Nr.44, date 13.10.2016 "Për monitorimin e spektrit të frekuencave" dhe Urdhrit Nr. 1654, datë 30.12.2015, “Për monitorimin periodik të spektrit të frekuencave” në pikat repetitive në territorin e Republikës së Shqipërisë, AKEP ka realizuar objektivat e mëposhtme:

- Monitorimin dhe kontrollin periodik të frekuencave që përdoren në pikat kryesore të transmetimit në territorin e vendit,
- Monitorimin dhe zgjidhjen e problematikave të dala nga interferencat e operatorëve/ sipërmarrësve të komunikimeve elektronike,
- Bashkëpunimin ndërinstytucional,
- Bashkëpunimin rajonal lidhur me problematikat që dalin në harmonizimin e përdorimit të frekuencave në rajonet kufitare dhe interferencat.

##### **8.3.4.1 Monitorimi i radiolidhjeve fikse në pikat transmetuese të vendit**

Monitorimi është kryer minimumi një herë në vit për pikat kryesore të trasmetimit sipas tabelës së mëposhtme:

*Tabela 17- Monitorimi i radiolidhjeve fikse*

	<b>Vendi ku do kryhen matje</b>	<b>Qyteti</b>	<b>Periudha e matjeve</b>
<b>1</b>	Kodër Mucaj, Ardenicë	Vorë, Fier	Gjatë muajit Janar
<b>2</b>	Pinet, Kodër Durrës	Tiranë, Durrës	Gjatë muajit Shkurt
<b>3</b>	Likovun, Petresh	Fier, Elbasan	Gjatë muajit Mars
<b>4</b>	Tarabosh, Tyrbe	Shkodër, Lezhë	Gjatë muajit Prill
<b>5</b>	Cervenakë, Cardhakë	Pogradec, Korçë	Gjatë muajit Maj
<b>6</b>	Sopot, Mile	Gjirokastrë, Sarandë	Gjatë muajit Qershor
<b>7</b>	Midë, Selishtë	Pukë, Peshkopi	Gjatë muajit Korrik
<b>8</b>	Kërcullë, Gllavë	Gjirokastrë, Tepelenë	Gjatë muajit Gusht
<b>9</b>	Pepellash	Kolonjë	Gjatë muajit Shtator
<b>10</b>	Dajt	Tiranë	Gjatë muajit Tetor

11	Çarçovë	Përmet	Gjatë muajit Nëntor
12	Arapaj, Kërtushaj	Durrës, Tiranë	Gjatë muajit Dhjetor

### 8.3.4.2 Monitorimi Fiks i Spektrit të frekuencave 20– 3000 MHz nga Stacionet Fikse në Krujë dhe Pinet

Monitorimi i spektrit të frekuencave në diapazonin 20 MHz – 3 GHz, kryhet nëpërmjet stacioneve Fikse të Monitorimit në Pinet dhe Krujë, sipas Planit, në tabelën e mëposhtme:

Tabela 18- Monitorimi Fiks i Spektrit të frekuencave 20– 3000 MHz

ID*	BREZI I FREKUENCAVE (MHz)		SHËRBIMI
F 01 M	68.00	85.00	TOKESOR I LEVIZSHEM (PMR)
F 02 J	87.50	108.00	AUDIOVIZUAL (BROADCAST FM)
F 03 D	108.00	138.00	AERONAUTIK (NAVIGACION/KOMUNIKIM)
F 04 M	144.00	146.00	AMATOR
F 05 J	146.40	156.00	TOKESOR I LEVIZSHEM (PMR/PAMR)
F 06 J	156.00	174.00	TOKESOR I LEVIZSHEM (PMR/PAMR) / DETAR
F 07 M	174.00	225.00	AUDIOVIZUAL (BROADCAST)
F 08 D	243.00	310.00	RADIONAVIGACION AERONAUTIK
F 09 M	380.00	399.00	TOKESOR I LEVIZSHEM (TETRA)
F 10 M	399.90	406.10	RADIOBEACONS (406,0 - 406,1 MHz)
F 11 J	406.10	430.00	TOKESOR I LEVIZSHEM (PMR)
F 12 M	430.00	440.00	AMATOR
F 13 J	440.00	450.00	TOKESOR I LEVIZSHEM (PMR/PAMR)
F 14 J	450.00	470.00	TOKESOR I LEVIZSHEM (PMR/PAMR)
F 15 M	470.00	790.00	AUDIOVIZUAL (BROADCAST DVBT/2)
F 16 J	790.00	862.00	AUDIOVIZUAL (BROADCAST) / I LEVIZSHEM
F 17 J	860.00	960.00	I LEVIZSHEM (GSM/LTE)
F 18 D	960.00	1215.00	RADIONAVIGACION AERONAUTIK
F 19 J	1215.00	1300.00	RADIOPERCAKTIM (RADAR) / GPS / AMATOR
F 20 J	1300.00	1350,00	RADIONAVIGACION AERONAUTIK

<b>F 21 J</b>	1559.00	1625.5	RADIONAVIGACION AERONAUTIK
<b>F 22 M</b>	1710.00	1900.00	I LEVIZSHEM (GSM/LTE)
<b>F 23 J</b>	1900.00	2200.00	I LEVIZSHEM (IMT200/LTE)
<b>F 27 M</b>	2400.00	2500.00	FIKS, I LEVIZSHEM (WIFI/WAS/RLAN)
<b>F 28 J</b>	2500.00	2690.00	I LEVIZSHEM (MFCN/LTE)
<b>F 29 J</b>	2700.00	2900.00	RADIONAVIGACION AERONAUTIK

#### **8.3.4.3 Subjektet që ofrojnë Shërbim Audiovizual**

Gjatë monitorimit të pikave të mësipërme janë identifikuar disa subjekte, kryesisht ato që ofrojnë shërbim audiovizual (broadcast), të cilat përdorin lidhje fikse pa u pajisur me Autorizim Individual. Për këto subjekte në disa raste u mbajt proces-verbal ku u njoftuan për të aplikuar në Modulin e Aplikimeve Online për pajisje me Autorizim Individual për lidhje fikse pikë më pike dhe në disa raste të tjera u morr masa e sekuestrimit të pajisjeve.

#### **8.3.4.4 Subjekte që ofrojnë shërbimet internet dhe data**

Gjatë monitorimit të pikave të mësipërme janë identifikuar disa subjekte të cilat përdorin lidhje fikse mikrovalore, për të cilat u morr masa e sekuestrimit të pajisjeve dhe vendosjes së gjobave bazuar në nenin 134, 135 dhe 137 të ligjit 9918, datë 19.05.2008 “Per komunikimet elektronike ne Republikën e Shqipërisë” datë 19.5.2008 (i ndryshuar).

#### **8.3.4.5 Subjekte të cilat ofrojnë internet nëpërmjet sistemeve që operojnë në brezin e frekuencave 2.4 dhe 5.8 GHz**

Gjatë monitorimit të pikave në të gjithë territorin e vendit janë identifikuar shumë subjekte që shpërndajnë internet duke mos respektuar rregulloren Nr. 33 datë 15.05.2014 për "Kushtet e përdorimit të frekuencave pa Autorizim Individual dhe kërkesat teknike për pajisjet radio që përdoren në këto breza". Pikat ku përdoren më shumë këto frekuenca janë: Mali i Dajtit, Petresh, Ardenicë, Likovun, Tyrbe, Tarabosh, Prezë dhe Vorë. Gjatë monitorimit janë bërë matje të frekuencave në këto 87 breza dhe është marrë masa e sekuestrimit të pajisjeve për të gjitha subjektet që përdorin këto breza.

Disa nga këto subjekte kanë aplikuar në AKEP, për tu pajisur me Autorizim Individual për përdorimin e frekuencave në lidhje fikse radio. Në monitorimin që u bë në 6-mujorin e dytë të vitit u vu re se shumica e këtyre subjekteve të cilat përdornin brezin 2.4 dhe 5.8 GHz nuk I përdornin më këto frekuenca, duke gjetur alternativa të tjera për shpërndarje interneti si shpërndarje me fibër optike etj.

### **8.3.5 Interferenca që shfaqin rrezikshmëri**

Gjatë vitit 2016 në zbatim të Rregullores Nr. 35 date 23.12.2014 Per “Administrimin e interferencave”, miratuar me Vendim Nr. 2529, date 23.12.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP, ligjin 9918, datë 19.05.2008 “Per komunikimet elektronike ne Republikën e Shqipërisë”, datë 19.05.2008 (i ndryshuar), janë trajtuar ankesa nga subjektet e radionavigacionit brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë si:

- Ankesë për interferencë nga Ministria e Transportit, Infrastruktures dhe Rrjetit të Republikës së Greqisë).  
Në ankesën e bërë nga Ministria e Transportit, Infrastruktures dhe Rrjetit të Republikës së Greqisë, lidhur me interferencat e shkaktuara në brezin 800 MHz e cila përdoret për teknologjinë LTE. Burimet e sinjaleve interferues vijnë nga territori i Republikës së Shqipërisë të cilat janë transmetime analoge të sipërmarrësve audiovizivë. Për këtë problematikë AKEP bëri me dijeni Autoritetin e Mediave Audiovizive e cila ka në administrim këtë brez të frekuencave dhe i kërkoi ndërhyrjen e menjëherëshme për zgjidhjen e këtyre problemeve.

### **8.3.6 Interferenca që dëmtojnë cilësinë e shërbimit**

Për sipërmarrësin Vodafone Albania sh.a nga monitorimet e kryera në teknologjinë UMTS në Gjirokaster interferenca nuk është e vazhduar po shfaqet në mënyrë peridike gjë cila bën të vështirë identifikimin burimit në një kohë të shkurtër.

Për sipërmarrësin Telekom Albania sh.a ne zonen e Vaut te Djes nga matjet e kryera nuk rezulton prezencë e ndonjë burimi interference në zonën e monitoruar Bazuar në matjet e kryera, provat me transmetuesit e tjerë në atë zonë si dhe me karakteristikat e interferencës së shfaqur, AKEP sugjeron kontrollin teknik të pajisjeve pasi egziston mundësia e shfaqes së një interference të brenshme nga vetë antena transmetuese e sipërmarrësit. Në zonën e Sarandës Interferenca shkaktohet nga transmetuesi i subjektit “Krenar Avdulla” me anë të emetimit të shkaktuar nga harmonika e rendit të dytë, e shkaktuar nga mungesa e filtrimit të sinjalit në transmetim, në këtë rast u mor masa e bllokimit te funksionimit te transmetuesit dhe ju la detyrë sipërmarrësit të rregullojë parametrat teknik të transmetimit përpara së të vendosi në punë këtë transmetues.

Për sipërmarrësin Plus Communications sh.a në zonën e Freskut, Tiranë nga matjet e kryera Interferenca shkaktohej nga transmetuesi i subjektit “Radio Nacional” me anë të emetimit të shkaktuar nga radiolidhja fikse e përdorur në frekuencë 1972 MHz pa Autorizim Individual, Grupi i punës mori masën e bllokimit të funksionimit të pajisjes radio e cila emeton sinjalin nga studio e subjektit “Radio Nacional” në drejtim të pikës transmetuese në Dajt. Gjithashtu subjektit “Radio Nacional” i lihet afat 3 (tre) ditë nga konstatimi i shkeljes të marrë masa për tu pajisur me Autorizim Individual për të përdorur frekuencën me autorizimin përkatës si dhe në përputhje me Planin Kombëtar të Frekuencave. Ne zonen e Lushnjes, nga matjet e kryera rezulton se interferenca shkaktohet nga transmetuesi i subjektit “Margit TV” me anë të

emetimit të shkaktuar nga radiolidhja fikse e përdorur në frekuencë 1978 MHz pa Autorizim Individual, Grupi i punës mori masën e bllokimit të funksionimit të pajisjes radio e cila emeton sinjalin nga studio e subjektit “Margit TV” në drejtim të pikës transmetuese në kodren “Blerimi”. Gjithashtu subjektin “Margit TV” i lihet afat 3 (tre) ditë nga konstatimi i shkeljes të marrë masa për tu pajisur me Autorizim Individual për të përdorur frekuencën me autorizimin përkatës si dhe në përputhje me Planin Kombëtar të Frekuencave.

Për Agjencinë e Mbrojtjes së Konsumatorit në zonën e Tiranës nga matjet e kryera rezultoi prezencë e një burimi interference në zonën e monitoruar, për arsye se këto pajise janë në përmasa të vogla, reflektimeve të ndërtesave si dhe shkyccjes në momentet e investigimit nuk është bere i mundur identifikimi i burimit interferues, AKEP kërkoi bashkëpunimin e banorëve të kësaj zone për vendosjen e një njoftimi të shkruar në objektin e dyshuar, si dhe për të marre dijeni në rast se interferenca do të shfaqet në të ardhmen, në mënyrë që të jepet një zgjidhje përfundimtare

Masat janë marrë në përputhje me ligjin 9918, date 19.05.2008 “Per komunikimet elektronike ne Republikën e Shqipërisë” datë 19.05.2008 (i ndryshuar), rregullores Nr. 35 date 23.12.2014 Per “Administrimin e interferencave”, miratuar me Vendim Nr. 2529, date 23.12.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP.

### ***8.3.7 Bashkëpunimi ndërinstitucional***

AKEP ka bashkëpunuar ngushtësisht me AMA-n për marrjen e masave ndaj subjekteve broadcast që shkaktojnë interferenca. Njëkohësisht është koordinuar me veprime të përbashkëta me Ablcontrol për mbajtjen në kontroll të brezit të frekuencave të cila përdoren për shërbime radionavigimi.

Bashkëpunimi rajonal lidhur me problematikat që dalin në harmonizimin e përdorimit të frekuencave në rajonet kufitare dhe interferencat.

Gjatë vitit 2016 janë mbajtur marrëdhënie institucionale dhe është bashkëpunuar me rregullatorin e Malit të Zi EKIP dhe Ministria e Transportit, Infrastrukturës dhe Rrjetit të Republikës së Greqisë, për trajtimin e problematikave që janë shfaqur në rastet e ndërferncave të shkaktuara.

### ***8.3.8 Monitorimi i cilësisë së shërbimit***

Për të garantuar ushtrimin e kompetencës ligjore lidhur me mbikëqyrjen, kontrollin dhe monitorimin e veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike, në përputhje me ligjin 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet e tjera në zbatim të këtij ligji, veçanërisht të zbatimit të kushteve të përgjithshme të përcaktuara në Autorizimin e Përgjithshëm sektori i planifikimit dhe koordinimit të monitorimit dhe

inspektimit krahas detyrave të tjera kryen në mënyrë të vazhdueshme monitorimin e cilësisë së shërbimit. Më poshtë po paraqesim veprimtarinë përgjatë vitit 2016.

Gjatë vitit 2016 AKEP ka kryer monitorimin e cilësisë së shërbimit të qyteteve dhe akseve rrugore për teknologjitë GSM/UMTS/LTE për tre operatorët mobile në Republikën e Shqipërisë përkatësisht: TELEKOM ALBANIA, VODAFONE ALBANIA dhe ALBtelecom të pajisur me autorizime për ofrimin e shërbimit për këto teknologji, si dhe për teknologjitë GSM/UMTS për operatorin PLUS Communication, si më poshtë:

## 1. Për shërbimet GSM/UMTS/LTE

- 1.1 Qytetet: Tiranë, Durrës, Kavajë, Rogozhinë, Elbasan, Peqin, Cërrik, Divjakë, Lushnje, Fier, Berat, Kucovë, Çorovodë, Vlorë, Orikum, Sarandë, Ksamil, Pogradec, Korçë, Devoll, Ersekë, Leskovik, Përmet, Gjirokastrë, Tepelenë, Ballsh, Maqellarë, Peshkopi, Kukës, Krujë, Fushë Krujë
- 1.2 Plazhet: Velipojë, Shëngjin, Tale, Patok, Gjiri i Lalzit, Durrës, Golem, Qerret, Plazhi i Gjeneralit, Spille, Divjakë, Seman, Vlorë, Radhim, Orikum, Palasë, Drimadhes, Dhërmi, Jalë, Livadh, Himarë, Llaman, Qeparo, Borsh, Bunec, Lukovë, Kakome, Sarandë, Plazhi i Pasqyrave, Ksamil si dhe akset rrugore drejt tyre.
- 1.3 Zonat turistike: Kepi i Rodonit, Kanionet Skrapar, Laguna e Karavastas, Zvërnec, Llogara, Butrint, Voskopojë, Dardhë, Gërmenjë, Qafë Shtamë, si dhe akset rrugore drejt tyre.
- 1.4 Akset rrugore: Tiranë–Durrës–Kavajë–Lushnje–Krutje–Divjakë–Rogozhinë; Tiranë–Elbasan–Peqin–Rogozhinë; Tiranë–Lezhë–Shkodër; Lushnje–Fier–Kucovë–Berat–Çorovodë; Vlorë–Himarë–Sarandë–Ksamil–Butrint; Elbasan–Pogradec–Korçë–Devoll–Ersekë–Përmet–Gjirokastrë–Tepelen–Ballsh–Fier; Fushë Krujë–Milot–Burrel–Maqellarë–Peshkopi–Kukës–Kalimash–Milot; Fushë Krujë–Krujë–Qafë Shtamë.
- 1.5 Janë hartuar raportet përmbledhëse mbi treguesit e cilësisë së shërbimit për teknologjitë GSM/UMTS/LTE për tre operatorët mobile: TELEKOM ALBANIA, VODAFONE ALBANIA dhe ALBtelecom, si dhe për teknologjitë GSM/UMTS për operatorin PLUS Communication, të cilët u janë dërguar operatorëve për marrjen e masave dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit në zonat problematike.

## 2. Mbi përdorimin e shërbimit UMTS

- 2.1 Monitorimi mbi verifikimin e shtrirjes së shërbimit UMTS në territorin e Republikës së Shqipërisë nga operatori PLUS Communication sipas grafikut të autorizimit të përgjithshëm.
- 2.2 Është hartuar raporti përmbledhës mbi treguesit e cilësisë së shërbimit për teknologjinë UMTS për operatorin PLUS Communication, për zonat në të cilat

ofrohet dhe i është dërguar operatorit për marrjen e masave dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit në zonat problematike.

### **8.3.9 Përmirësimi dhe zgjerimi i shërbimit Broadband**

Me qëllim përmirësimin dhe zgjerimin e shërbimit broadband në territorin e Republikës së Shqipërisë sipas marrëveshjes së arritur midis operatorëve mobile përkatësisht: TELEKOM ALBANIA, VODAFONE ALBANIA dhe ALBtelecom, do të kryhet matje përgjatë vitit 2017 për verifikimin e tyre sipas specifikimeve:

Për investime të përbashkëta të operatorëve mobilë për shtimin dhe përmirësimin e shërbimeve GSM/UMTS/LTE përkatësisht:

- Vermosh Qendër,
- Valbona Qendër,
- Gërmenj,
- Kepi i Rodonit,
- Shkopet,
- Grykë Nokë.

Për bashkëpunim midis operatorëve mobile për shtimin dhe përmirësimin e shërbimeve GSM/UMTS/LTE përkatësisht:

- Qafë Shtama,
- Lura Fshat,
- Qafa e Vishës,
- Thethi,
- Gorica,
- Tri Porti (Vlorë).

Shkak i shtrirjes së verifikimit përgjatë vitit 2017 të marrëveshjes së operatorëve mobile në Republikën e Shqipërisë për zonat e mësipërme është bërë vonesa e marrjes së lejes së ndërtimit të stacioneve, si dhe planifikimi i buxhetit të investimeve të operatorëve për vitin 2017.

### **8.3.10 Verifikimi i marrëveshjes së koordinimit ndërkufitar**

1. Gjatë vitit 2016 janë realizuar matje të përbashkëta ndërkufitare për verifikimin e zbatimit të Marrëveshjes së Koordinimit Nr. 0102-707/1 datë 07.02.2014 për brezat GSM 900/1800 të firmosur në Podgoricë midis Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare të Republikës së Shqipërisë (AKEP) dhe Agjencisë së Komunikimeve Elektronike dhe Shërbimeve Postare të Republikës së Malit të Zi (EKIP), të segmentëve rrugorë Hani i Hotit-Velipojë-Muriqan, Muriqan-Shirokë, Shkodër-Lezhë.



2. Janë hartuar raportet përmbledhëse mbi nivelin e fuqisë së sinjalit GSM 900/1800, si dhe të përdorimit të kanaleve jo-preferenciale (për ato kanale të cilat vazhdojnë të përdoren) në territorin e Republikës së Shqipërisë, nga operatorët mobile që ushtrojnë aktivitetin e tyre në Republikën e Malit të Zi.
3. Raportet janë dërguar Rregullatorit të Malit të Zi për marrjen e masave për respektimin e marrëveshjes së firmosur më datë 07.02.2014 në Podgoricë midis Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare të Republikës së Shqipërisë (AKEP) dhe Agjencisë së Komunikimeve Elektronike dhe Shërbimeve Postare të Republikës së Malit të Zi (EKIP).
4. Është bërë njohja e operatorëve mobile Shqiptar me raportin e përgatitur nga rregullatori i Malit të Zi.
5. Janë njoftuar të katër operatorët e shërbimit mobile për marrjen e masave për respektimin e marrëveshjes së koordinimit ndërkufitar, uljen e fuqisë së trasmetimit dhe përdorimi i kanaleve preferencialë.
6. Janë planifikuar matje të përbashkëta ndërkufitare për vitin 2017 mbi verifikimin e zbatimit të masave të marra nga operatorët mobile të të dy vendeve fqinje.

### ***8.3.11 Zhvillimi i projektit “Sistemi Kombëtar i Monitorimit të Spektrit të Frekuencave për Shqipërinë”***

Në vijim të zbatimit të “Projektit për ngritjen e Sistemit Kombëtar të Monitorimit të spektrit të frekuencave” hartuar me konsulencën e ekspertëve të ITU-se, është bërë i mundur ndërtimi i 2 (dy) Stacioneve Fikse të Monitorimit (RFMS) në Pinet dhe Krujë, për monitorimin e zonave të rëndësishme Tiranë – Durrës – Aeroporti i Rinasit, si zona mjaft të okupuara nga radiokomunikimet dhe është në proces ndërtimi i dy stacioneve fikse monitorimi në Shkodër e Vlorë.

Me datë 21.03.2016 është zhvilluar procedura e prokurimit me objekt “Zhvillimi i Sistemit Kombëtar të Monitorimit të Spektrit të Frekuencave, pajisje për Stacion të Thjeshtë Fiks, Monitorimi (SRFMS) në Shkodër dhe Vlorë”. Procedura ka kaluar në disa faza ankimimi, proces gjyqësor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë dhe Gjykatën Administrative të Apelit. Në datë 14.12.2016 vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit është pezulluar me vendim të Gjykatës të Lartë, e cila nuk ka dalë akoma me vendim përfundimtar.

#### ***I. Në muajin Qershor u publikua dokumenti standart i tenderit me objekt prokurimi “SoftWare Support për Qendrën Kombëtare të Lëvizshme të Monitorimit të Cilësisë”.***

Me përfundimin e procedurës në muajin Qershor u bë i mundur sigurimi i suportit teknik i nevojshëm për software-it TEMS nga specialistë të ASCOM, për Qendrën Kombëtare të Lëvizshme të Monitorimit të Cilësisë. Gjithashtu për pjesën fikse të monitorimit (serverit dhe call generator) u siguroa suporti i nevojshëm teknik nga ana e ASCOM.

Duke qenë se licensat për programet e QKLMC janë për një periudhë 1 (një) vjeçare në mbarim të procedurës u siguruan licensat për 1 (një) vit kalendarik License Premium TEMS

Investigation, Liçense Premium Premium TEMS Discovery, Liçense Premium TEMS Pocket, Liçense Premium Call Generator.

*II. Në muajin Dhjetor u publikua dokumenti standart i tenderit me objekt prokurimi “Upgrade Argus”.*

Qëllimi i kësaj procedure ishte Upgrade i programit të monitorimit Argus i cili ishte përditësuar në vitin 2013 në versionin 5.4.2 në verisonin ARGUS 6.

ARGUS shërben për kontrollin e stacioneve ne distance nga Qendra Kombetare e Monitorimit te Frekuencave dhe për programimin e matjeve që dëshirohet të kryhen nga aparaturat e montuara në Qendrën e Lëvizshme të Monitorimit të Frekuencave (QLMF), Stacionin Fiks të Monitorimit (RFMS) në Pinet dhe Krujë, komandimin e këtyre aparatrave gjatë realizimit të detyrave të programuara dhe përgatitjes së raporteve të ndryshëm me rezultatet e këtyre matjeve të realizuara.

*III. Në muajin Nëntor u publikua dokumenti standart i tenderit me objekt prokurimi “Analizator spektral me opsion drejtim gjetës për interferenca”.*

Qëllimi i kësaj procedure ishte pajisja e Qendrës Kombëtare të Monitorimit të Frekuencave, me një Marrës portabël për radiomonitorim dhe antenë omni direksionale drejtim gjetëse. Marrës për gjetjen e interferencave i cili do të shërbejë në zgjidhjen e problemeve në ambjentet në të cilat është e vështirë për të kryer monitorim. Ne disa raste me anë të stacioneve fikse të monitorimit nuk është e mundur të monitorohen pjesë në të cilat stacionet nuk kanë line of site, në këto kushte përcaktimi i vendndodhjes së burimit të interferencës bëhet i vështirë. Për shkak të afërsisë ndërmjet ndërtesave, ripërdorimit shumë të shpeshtë të frekuencave për efekt kapaciteti në transmetim zonat e mbuluar janë shume të vogla, ndërhyrjet që shkaktohen brenda ndërtesave nga transmetues me rreze të shkurter veprimi nuk mund të trajtohen pa bërë matje në afërsi të objekteve. Marrësi realizon matje të cilat i eksporton në nje raport sipas vlerave që mat dhe sipas vendodhjes ku kryhen matjet dhe vendndodhjes së burimit të sinjalit interferues. Marrësi ofron mundësinë e realizimit të matjeve drive test për te frekuencat e telefonisë së lëvizshme në zonat urbane ku problemet janë më të shpeshta. Marrësi lejon kryerjen e matjeve në terrene të vështira ku mund të shkohet vetëm me pick up car në tarracat e godinave ose në zona malore ku mund të shkohet vetëm me këmbë. Mundësia e përdorimit të direction finder si dhe gjenerimi i pozicionit të burimit të interferencës në hartë krijon mundësinë që me anë të gjetjes së këndit me tre drejtime të bëhet e mundur përcaktimi i saktë i vendndodhjes së burimit të interferencës.

*IV. Në muajin Korrik u publikua dokumenti standart i tenderit me objekt prokurimi “Sistem sigurie, kamera, sistem kondicionimi, UPS dhe akses kontrolli të kontrollueshem në distancë për Stacionin Fiks të Monitorimit (RFMS) në Shkodër, Vlorë dhe Korçë”.*

Qëllimi i kësaj procedure ishte zhvillimi i projektit të qendrës kombëtare të monitorimit AKEP dhe vënia në funksionim të Sektorëve Rajonalë të Monitorimit dhe Inspektimit, në

qyetet e Shkodrës, Vlorës dhe Korçës. Për të vënë në funksionim këto pika të monitorimit ishte e nevojshme zhvillimi i infrastruktures IT, Komunikimit dhe Sigurisë. Kjo infrastrukturë konsistoi në realizimin e rrjetit kompiuterik & telefonik, rrjetit elektrik dhe ndriçimit, Akses kontrollin për hyrje-daljet i monitorueshëm në distancë, Sistemin e monitorimit me kamera, Sistemin e mbrotjes nga zjarri, Sistemin e mbrojtjes nga hyrjet e padëshiruara si dhe kondicionimin e ambienteve.

### **8.3.12 Amendime të rregulloreve**

Gjatë vitit 2016, me qëllim përmirësimin e kuadrit rregullator, Drejtoria e Monitorimit të Frekuencave, Cilësisë dhe Inspektimit ka hartuar dhe paraqitur për miratim në KD Aktet Administrative:

#### *I. Rregullore Nr.46, datë 27.10.2016 " Metodika e inspektimit të veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike"*

Drejtoria e Monitorimit të Frekuencave, Cilësisë dhe Inspektimit ka hartuar dhe paraqitur për miratim në KD Aktin Administrativ Rregullor nr.46, date 27.10.2016 "Metodika e inspektimit të veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike"

Dokumenti Rregullor "Metodika e inspektimit të veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike", është hartuar me qëllim, rregullimin e veprimtarisë inspektuese të AKEP sipas legjislacionit për inspektimin në Republikën e Shqipërisë, në kushtet specifike teknike dhe metodike, të fushës, ku ushtrohet veprimtaria, të parashikuara në ligjin nr.9918, datë 19.05.2008 dhe përshtatjen e rregullave të inspektimit të veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike me drejtimitet e përgjithshme të zhvillimit dhe kryerjes së inspektimit sipas Manualit të Përgjithshëm të Inspektimit, miratuar me Urdhër nr.13, datë 23/04/2015 për "Miratimin e Manualit të Përgjithshëm të Inspektimit në Republikën e Shqipërisë" të Inspektorit të Përgjithshëm dhe legjislacionit për inspektimin në Republikën e Shqipërisë.

Dokumenti Rregullor "Metodika e inspektimit të veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike" i propozuar nga grupi i punës është i drejtë, i bazuar ligjërisht dhe në përputhje me synimet dhe funksionet e AKEP për përmbushjen e objektivave rregullatore të përcaktuara në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008.

#### *II. Rregullore Nr.44, datë 13.10.2016 "Për monitorimin e spektrit të frekuencave "*

Drejtoria e Monitorimit të Frekuencave, Cilësisë dhe Inspektimit ka hartuar dhe paraqitur për miratim në KD Aktin Administrativ Rregullor nr.44, date 13.10.2016 "Për Monitorimin e spektrit të frekuencave"

Dokumenti është hartuar me qëllim, hartimin e procedurave të monitorimit të spektrit të frekuencave, të caktuara në Planin Kombëtar të Frekuencave në mënyrë që, përdorimi i frekuencave të dhëna me autorizim të jetë në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, në zbatim të kushteve të autorizimit, spektri i frekuencave të përdoret vetëm nga përdoruesit e lejuar, sipas dispozitave të ligjit nr. 9918 datë 19.5.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të krijojë një mjedis të përshtatshëm dhe pa interferenca të dëmshme për operimin e sistemeve dhe të stacioneve të transmetimit radio, që do të përdoren për qëllime private ose publike, në përputhje me parashikimet përkatëse ligjore dhe nënligjore si dhe kompetencat e AKEP, të ofrojë të dhëna të vlefshme për procesin e administrimit të spektrit lidhur me përdorimin aktual të kanaleve të frekuencave dhe brezave të frekuencave, verifikimin e karakteristikave teknike reale të sinjaleve të transmetuara, të ofrojë informacione të monitorimit për kërkesat për asistencë të veçantë të administratave të vendeve fqinje në eliminimin e interferencave të dëmshme, si dhe identifikimin e pastrimit të transmetimeve jashtë brezi.

Në përgatitjen e dokumentit (GP) ka marrë në konsideratë: Përcaktimet e Radio Rregullore të Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve (ITU) dhe Udhëzues mbi Monitorimin e Spektrit (*Handbook on Spectrum Monitoring - ITU*) si dhe *Rekomandimet për vitin 2016*, të përcaktuara në Rezolutë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2015.

Dokumenti paraqet një hap të rëndësishëm në procesin të përmirësimit të vazhdueshëm të kuadrit rregullator dhe qasjen me risitë në procesin e monitorimit në nivel evropian.

#### **8.4 Ushtrimi i funksioneve rregullatore në teknologjinë e informacionit dhe zhvillimit të broadband**

Legjislacioni i fushës parashikon një rol dhe funksione të rëndësishme të AKEP për shërbimet me brez të gjerë, aksesin në internet dhe administrimin e cctld.al. Gjithashtu një aspekt shumë të rëndësishëm të punës përbën dhe mbështetja teknike për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e rrjetit të brendshëm dhe aplikacioneve që përdoren për ofrimin e shërbimeve ndaj sipërmarrësve dhe të tretëve.

Për mbulimin e kësaj veprimtarie në strukturën dhe organikë të AKEP është ngritur Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit dhe Zhvillimit të Broadband.

Funksionet kryesore të drejtorisë janë:

- Administrimi i domain cctld.al, nën domainet e tij si dhe ENUM,
- Trajtimi i çështjeve që lidhen me aksesin në internet, shërbimet me brez të gjerë dhe masat mbrojtëse,
- Administrimi i sistemeve on line të shërbimeve administrative dhe rregullatore që kryen AKEP,

- Administrimi i aplikacioneve të AKEP,
- Studime, analiza dhe hartimi akte rregullatore për çështje që lidhen me objektin e veprimtarisë së drejtorisë.

#### 8.4.1 Administrimi i domain

Nr. i domain-eve të regjistruar për vitin 2016 është **5799** dhe kemi një numër total prej **18078** domain-e. Në total verifikohet një rritje mbi 12% të domain-eve krahasur me vitin 2015.

Edhe për vitin 2016 është evidentuar një rritje e konsiderueshme e domain-eve tek regjistrarët e akredituar duke e lënë AKEP nga regjistrari dominues në vendin e tretë. Dhe pse ka patur fluks aplikimesh pranë AKEP, ka patur dhe shumë transferime të domain-eve nga AKEP tek regjistrarët e tjerë. Numri i domain-eve sipas regjistrarëve është paraqitur në tabelën më poshtë:

Tabela 19- Numri i domain-eve sipas regjistrarëve

Regjistrari	Nr. Domain në 2015	Regjistrime në 2016	Nr. Domain në 2016
AKEP	3423	417	3068
Albtelecom sh.a	49	37	68
ShqipëriaCom sh.p.k	6497	2269	7272
Webhost sh.p.k	4342	2657	5885
Keminet sh.p.k	1028	210	1105
Studio Driar	636	171	680

Është kryer administrimi dhe mirëmbajtja e sistemit të menaxhimit të regjistrimit të *domain name* dhe të *root server-ave* të *.al*, procesimi i aplikimeve kryesisht për regjistrim dhe modifikim teknik në përputhje me Rregulloren nr.2. Për regjistrimin e domain-eve nën zonën *.al* dhe nën domain-eve *.gov.al*, *.edu.al*, *.org.al*, *.com.al*, *.mil.al*, *.net.al*

Bazuar në numrin e domain-eve të regjistruar gjatë vitit 2016 dhe në numrin e tyre në fund të vitit 2016, rezulton se më shumë se 3000 domain-e nuk janë rinovuar. Për këtë arsye dhe rritja e numrit të domain-eve të regjistruar është në vlerën e rreth 13%.

Më poshtë janë paraqitur në formë tabelare të dhënat e detajuara të numrit të domain-eve.

Tabela 20- Të dhënat e detajuara të numrit të domain-eve

Domain	Numri i domain-eve të regjistruar, deri 2011	Numri i domain-eve të regjistruar, deri 2012	Numri i domain-eve të regjistruar, deri 2013	Numri i domain-eve të regjistruar, deri 2014	Numri i domain-eve të regjistruar, deri 2015	Numri i domain-eve të regjistruar, deri 2016
<b>.al</b>	6,200	8,334	11,466	12,530	14,621	<b>16,529</b>
<b>.com.al</b>	544	630	748	676	774	<b>899</b>

<b>.gov.al</b>	273	301	337	265	275	<b>296</b>
<b>.org.al</b>	116	134	165	145	145	<b>159</b>
<b>.edu.al</b>	124	133	129	106	120	<b>137</b>
<b>.net.al</b>	23	28	35	30	37	<b>56</b>
<b>.mil.al</b>	8	8	8	2	3	<b>2</b>
<b>Total</b>	7,387	9,568	12,888	13,760	15,975	<b>18,078</b>

Gjithashtu është kryer administrimi i sistemeve mbështetëse të cctld.al si:

- Monitorim i aksesit të jashtëm të Sistemit DNS, lidhjet përkatëse me ISP, ku shërbimi është ofruar nga 2 ISP, linja primare nga ABCOM dhe linja sekondare me Albtelecom kanë qënë në nivelin e kërkuar, pra një aksueshmeri në internet prej 100% për cctld .al.
- Monitorim dhe administrim i sistemit FRED, sistem i menaxhimit të domain .al.
- Ndjekja e problematikës dhe implementimi i zgjidhjeve për raportimet e regjistruësve të akredituar.

Sa i përket sistemit qëndror të administrimit të domain-eve .al janë kryer disa përmirësime në shërbimet e ofruara për regjistrarët e akredituar dhe në administrimin e domain-eve në tërësi. Janë shtuar shërbimet e njoftimit dhe raportimit si më poshtë:

- Njoftimi me e-mail i regjistrarit përkatës dhe AKEP (në adresën domain@akep.al) në rastet e mos-aprovimit të domain-eve;
- Njoftimi me e-mail tek domain@akep.al sa herë që një një domain shtohet ose hiqet nga lista e emrave të ndaluar/rezervuar në sistem;
- Përmirësimi i shërbimit who-is për kërkimin e domain-eve në sistemin qëndror dhe shtimi i funksionit identifikues dhe të domain-eve të cilët janë në listën e emrave të ndaluar/rezervuar. Pra të pasqyrohen si emra të cilët nuk mund të regjistrohen;

Është përmirësuar komunikimi i regjistrarëve nga API dhe janë shtuar funksionalitetet si vijon:

- Ofrimi i mundësisë për ndryshimin e (transfer key ) për domain-et nga regjistrarët;
- Single Domain Info (Status), një komandë që të listojë gjendjen e domainit - PSH: akep.al, Pending – Nëse nuk është miratuar akoma; Aktive - Nëse është miratuar; Expiring – Nëse është duke skaduar, pra ka hyrë në 30 ditëshin që bëhet remove nga DNS; Refuzuar – Nëse është refuzuar nga AKEP;
- Domain Requests, në API të jepet mundësia e listimit dhe të domain-eve që janë në atë moment në Web Interface të AKEP;
- Gjenerimi i çertifikatave të reja të sigurisë për regjistrarët (nga sistemi qendror);

Shërbimet e mësipërme u shtojnë më shumë lirshmëri veprimi dhe komunikimi regjistrarëve të akredituar si dhe përmirësojnë komunikimin e sistemin qendror të administrimit të domain-eve .al.

Gjithashtu janë përmirësuar dhe janë shtuar shërbimet në nivelin e administrimit të domain-eve:

- Gjenerimi i raporteve mbi poseduesit e domain-eve në bazë të shteteve;
- Gjenerimi i raporteve mbi numrin e domain-eve të fshirë (që kanë skaduar dhe nuk janë rinovuar);
- Gjenerimi i raporteve statistikor mbi transferimet;
- Gjenerimi i raporteve mujorë mbi regjistrimet, fshirjet, transferimet dhe rinovimet e domain-eve;

Është kryer përmirësimi i Hardware mbi të cilat funksionon ccTLD.al si dhe janë përmirësuar komunikimet e tij në ndërfaqet API dhe Web.

Gjatë gjithë vitit janë raportuar disa probleme në komunikimin e regjistrarëve me sistemin qendror të cilave u është dhënë zgjidhje imediate.

Janë kryer auditime të sistemit në disa raste me kërkesën e regjistrarëve në lidhje me regjistrimin apo skadimin e disa domain-eve.

AKEP ne rolin e regjistrarit ka kryer procedurat e administrimit të domain-eve të regjistruar. Janë kryer njoftimet për rinovim dhe është koordinuar me Drejtorinë e Financës për lëshimin e faturave përkatëse në kohë dhe brenda afateve si dhe dërgimi i faturave me e-mail në adresat përgjegjëse. Gjithashtu është rakorduar rinovimi i domain-eve të cilët kanë kryer pagesën përkatëse për rinovim.

Janë ndjekur çështjet gjyqësore lidhur me domain-et .al në bashkëpunim me juristët e AKEP. Gjatë vitit 2016 ka patur çështje gjyqësore lidhur me domain-et:

- europcar.al
- njoftime.al
- hertz.al

Në këto çështje AKEP ka qënë i thirrur si palë e tretë dhe qëndrimi i mbajtur ka qënë neutral kundrejt palëve ndërgjyqëse.

Në çështjen lidhur me domain-et:

- -aagroup.al
- -hertz.al

AKEP ka qënë i paditur. Këto çështje janë në gjykim dhe nuk ka përfunduar akoma shqyrtimi në gjykatat e shkallës së parë.

#### **8.4.2 Portabiliteti i Numrit**

Objektivat e AKEP janë funksionimi dhe operimi normal i sistemit të CRDB sipas Rregullores dhe realizimi i procesit të bartjes së numrave për pajtimtarët. Edhe gjatë vitit 2016 është kryer menaxhimi i sistemit dhe komunikimit midis operatorëve dhe ofruesit të CRDB. Gjenerimi i raporteve përkatëse periodike në lidhje me mbarvajtjen nga ana teknike të procesit të bartjes së numrit dhe operatorëve.

#### **8.4.3 Ndjekje e procesit të zbatimit nga ana e sipërmarrësve të detyrimeve ligjore lidhur me marrjen e masave për sigurinë e rrjeteve dhe/ose shërbimeve.**

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare – AKEP në kuadër të Strategjisë Kombëtare të Sigurisë dhe vecanërisht kapitullit të sigurisë së komunikimeve elektronike, gjatë vitit 2016 i kushtoi një rëndësi të vecantë sigurisë së rrjeteve dhe informacionit nga sipërmarrësit që janë pajisur me autorizim të përgjithshëm të shërbimeve të komunikimeve elektronike.

Në bashkëpunim me grupin e punës të ngritur sipas Urdhër Nr.1556 datë 26.10.2015 “Për ngritjen e grupit të punës për ndjekjen e zbatimit nga ana e sipërmarrësve të detyrimeve ligjore lidhur me marrjen e masave të nevojshme mbrojtëse teknologjike për sigurinë e rrjeteve dhe informacionit”, AKEP ndjek procesin e raportimeve nga sipërmarrësit e komunikimeve elektronike në lidhje me zbatimin e detyrimeve ligjore lidhur me masat mbrojtëse për sigurinë e rrjeteve dhe informacionit bazuar në shkronjën d) dhe j) të nenit 15 dhe nenit 122 të ligjit nr.9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”I ndryshuar dhe sipas Aneksit 3 dhe nenit 9, pika 1 të Rregullores Nr.37 “ Mbi Masat Teknike dhe Organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”.

Më konkretisht, Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit dhe Zhvillimit të Broadband (DTIZHB) në bashkëpunim me grupin e punës të formuar sipas Urdhërit Nr.1556, datë 26.10.2015 , kanë kryer gjatë vitit 2016 këto detyra në lidhje me zbatimin nga ana e sipërmarrësve të detyrimeve ligjore lidhur me marrjen e masave për sigurinë e rrjeteve dhe/ose shërbimeve:

- Grupi i Punës, pas dërgimit të shkresës zyrtare me Nr. Prot 2032 të datës 12.11.2015 me lëndë “Mbi Zbatimin e Detyrimeve për masat mbrojtëse dhe kushtet e sigurisë në komunikimet elektronike”, në zbatim të Urdhërit Nr.1556, datë 26.10.2015, filloi më datë 11.01.2016 komunikimin e vazhdueshëm me sipërmarrësit me anë të dërgimit të njoftimit nëpërmjet postës elektronike, por edhe përmes formave të tjera të komunikimit në mënyrë që sipërmarrësit të realizonin në kohë detyrimin për raportimin e masave të sigurisë për të garantuar integritetin dhe sigurinë e rrjeteve



dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike. Janë dërguar njoftime zyrtare sipërmarrësve të komunikimeve elektronike përmes postës elektronike në datat 27.01.2016, 25.02.2016, 19.05.2016 dhe 30.05.2016 për të plotësuar sa më shpejt detyrimin për raportimin e masave të sigurisë për të garantuar integritetin dhe sigurinë e rrjeteve duke vendosur datën 10.06.2016 si afat përfundimtar .

- Në mënyrë më të detajuar, në kuadër të përcaktimeve të Rregullores Nr.37 datë 29.10.2015 “Mbi masat teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”, grupi i punës i vlerësoi raportimet sipas 6 fushave kryesore të mëposhtme, që minimalisht duhet të kenë dhe të aplikojnë sipërmarrësit e komunikimeve elektronike që të vendosin masat bazë teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike:
  1. Sigurinë fizike të ambienteve dhe aseteve të sipërmarrësve,
  2. Sigurinë e rrjeteve, sistemeve dhe aplikacioneve mbështetëse,
  3. Plani i trajtimit ose reagimit ndaj incidenteve të sigurisë dhe Plani i Vazhimit të Biznesit,
  4. Politikën e Sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale në ruajtje, procesim dhe transmetim,
  5. Politikat e aksesit të kontrollit , rolet dhe përgjegjësitë e punonjësve që merren me çështjet e sigurisë,
  6. Regjistër/ regjistra të shkeljeve ose incidenteve të sigurisë ku të specifikohet shkelja,
  7. kategorizimi i saj, shkaku, pasoja, masat e ndërmarra etj sipas pikës 7 të nenit 6.

Në këtë mënyrë, grupi i punës vendosi një standard minimal për të vlerësuar raportimet e dërguara nga sipërmarrësit e komunikimeve elektronike.

Grupi i punës i ka vlerësuar raportimet e sipërmarrësve duke përcaktuar rast pas rasti se cilat pika janë plotësuar në raport dhe cilat pika nuk janë adresuar, gjithnjë duke pasur në konsideratë origjinalitetin e këtyre raportimeve, pra faktin që raporti të përshkruaj realisht sistemet, pajisjet, masat dhe zgjidhjet që ata kanë të instaluar dhe në përdorim në rrjetet e tyre dhe të mos përmbaj të dhëna të rreme apo të kopjuara.

- Pas vlerësimit të raportimeve në bazë të 6 kritereve të përcaktuara në pikën e mësipërme, Grupi i punës kreu një kategorizim të sipërmarrësve të komunikimeve elektronike sipas shkallës së mospërmbushjes së detyrimeve mbi masat teknike dhe organizative mbi sigurinë e rrjetit dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike në sipërmarrës raportimi i të cilëve është:
  - Kthyer për rishikim për 6 arsye;
  - Kthyer për rishikim për 5 arsye;
  - Kthyer për rishikim për 4 arsye;

- Kthyer për rishikim për 3 arsye;
  - Kthyer për rishikim për 2 arsye;
  - Kthyer për rishikim për 1 arsye;
- Grupi i punës, sipas planit të veprimit dhe kategorizimit të sipërmarrësve sipas pikës së mësipërme, në bashkëpunim me Drejtorinë e Monitorimit të Frekuencave dhe Cilësisë dhe Inspektimit (DMFCI), ka vendosur masa administrative për sipërmarrësit për shkak të mosrrespektimit të detyrimit të dorëzimit të raportit mbi masat teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike, të përcaktuar sipas pikës 1 të nenit 9 të Rregullores Nr.37, datë 27.10.2015. Në total, gjatë vitit 2016, janë vendosur gjithsej 27 masa administrative.
  - Në fund të vitit 2016, në konkluzion nga evidentimi i 151 sipërmarrësve, 82 sipërmarrës kishin përmbushur detyrimet ligjore dhe ato rregullatore përkatëse dhe 69 sipërmarrës nuk përmbushin detyrimet ligjore dhe ato rregullatore përkatëse.

Nga 69 sipërmarrës, raportimet e 6 sipërmarrësve janë kthyer për rishikim për 5 arsye, raportimet e 18 sipërmarrësve janë kthyer për rishikim për 4 arsye, raportimet e 13 sipërmarrësve janë kthyer për rishikim për 3 arsye, raportimet e 5 sipërmarrësve janë kthyer për rishikim për 2 arsye dhe raportimet e 5 sipërmarrësve janë kthyer për rishikim për 1 arsye.

Ndërkohë nga 27 sipërmarrës, që kanë marrë masë administrative për shkak të mosrrespektimit të detyrimit të dorëzimit të raportit mbi masat teknike dhe organizative të sigurisë, 5 sipërmarrës i kanë përmbushur detyrimet ligjore dhe ato rregullatore përkatëse në lidhje me masat e sigurisë së rrjeteve dhe informacioneve ndërsa 22 sipërmarrës janë në proces të përmbushjes së këtyre detyrimeve përkatëse.

- DTIZHB ,në bashkëpunim me Drejtorinë e Administrimit të Burimeve të Fundme, Autorizimeve dhe Faciliteteve (DABFAF), ka vlerësuar raportet në lidhje me masat e sigurisë së informacionit dhe rrjeteve nga sipërmarrësit që kanë aplikuar për autorizim të përgjithshëm të komunikimeve elektronike. DTIZHB i ka shqyrtuar këto raporte nëse ato janë konform përcaktimeve të Rregullores Nr.37 datë 27.10.2015 “ Mbi Masat Teknike dhe Organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”.

#### ***8.4.4 Administrimi dhe mirëmbajtja e sistemeve informatike dhe rrjetit kompjuterik të AKEP***

Bazuar në detyrat funksionale të D.T.IZH.B. është kryer administrimi dhe manaxhimi i sistemeve IT, ku vlen të theksohet se ecuria dhe gjendja e sistemeve ka qënë optimale dhe nuk ka patur ndërprerje të shërbimeve për punonjësit e AKEP, përveç disa shkëputjeve të shkurtra

të aksesit në internet nga ana e ISP, por që janë brenda kushteve në të cilat është prokuruar ky shërbim dhe mirëmbajtje rutinë e sistemeve dhe platformave IT.

#### **8.4.5 Ndjekja e zbatimit të strategjisë së AKEP për broadband**

Bazuar në detyrat funksionale gjatë këtyre muajve janë kryer:

- I. Analizë e shërbimeve me Brez të Gjërë (Broadband) si:
  - a. Planin Kombëtar për Zhvillimin e Broadband miratuar me VKM nr. 468 datë 30.05.2013.
  - b. Analizën e tregut me shumicë të aksesit broadband internet: Tregu me shumicë i aksesit në infrastrukturën e rrjeteve fizike (përfshirë aksesin e plotë dhe të përbashket-LLU) nga vendodhje fikse; si dhe Tregu me shumicë i aksesit broadband (bitstream) miratuar me VKD nr. 2416 datë 04.02.2014.
  - c. Strategjinë e Qeverisë Shqiptare për Kalimin nga Transmetimet Analoge në Transmetimet Dixhitale e Këshillit të Ministrave.
  - d. Dokumentet e AKEP miratuar me VKD që kanë lidhje me shërbimet me brez të gjerë.
  - e. Dokumente të tjera të rëndësishme
- II. Zbatimi i detyrave funksionale
  1. Është punuar për formulimin e Strategjisë së AKEP për Broadband çështje e cila është në ndjekje e sipër dhe që kërkon kohe si dhe kontribut nga të gjitha drejtoritë e AKEP, për të përfshirë të gjitha detyrimet ligjore, VKM-të, aktet rregullatore dhe VKD-të e AKEP, rekomandimet e ITU, BEREC etj në këtë Strategji.
  2. Me qëllim vlerësimin dhe analizimin e situatës së Broadband në Shqipëri, është kryer përgatitja e informacionit (të dhënave) që do t'u kërkohen operatorëve dhe kryesisht për:
    - a) Internet Exchange Points dhe Data Rooms, etj.
    - b) Kapacitetet e aksesin ndërkombëtar në internet dhe kapacitetet me shumicë që ju shesin ISP-ve të vogla në Shqipëri.
    - c) Internetin në shkolla.
    - d) Numrin e përdoruesve Internet 3G/Edge.
    - e) Km e fibres se shtire nga operatorët kryesorë të fibres optike dhe në vecanti për FTTH të shtrirë, në shtrirje apo në planet e afërta për tu shtrirë (zonat, numri i FTTHve, FTTH aktive, etj).
    - f) Shpërndarjen e abonentëve nëpër rrethe, bashki dhe komuna, mënyrat e lidhjes së tyre, plane të afërta për rritjen e shtrirjes, etj).
    - g) Abonentët biznes të tyre.
    - h) Shërbimet Triple Play.

i) Kërkesa të tjera sipas Analizes Broadband miratuar me VKD nr. 2416 datë 04.02.2014

3. Në zbatim të Urdhërit nr. 1003 datë 07.08.2013 “Për ngritjen e komisionit të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve midis pajtimtarëve dhe sipërmarrësve” dhe në zbatim të rregullores nr. 29 datë 29.05.2013 “Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis pajtimtarëve dhe sipërmarrësve” në bashkëpunim me ish Drejtorinë Juridike është punuar për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve Pajtimtar-Sipërmarrës.

#### **8.4.6 Bazuar në Planin e Punës për vitin 2016 janë përfunduar me sukses këto projekte kryesore**

##### **8.4.6.1 “Sistemi dhe rrjeti i komunikimit të Q.K.M.F. me pikat e monitorimit në distancë”**

AKEP ka përfunduar fazën e ngritjes së Qendrës Kombëtare të Monitorimit të Frekuencave dhe ka përfunduar ngritjen e stacioneve të monitorimit të frekuencave në distance në Krujë, Pinet, Shkodër dhe Vlorë. Ky projekt synonte ngritjen e një sistemi komunikimi duke përdorur teknologjinë për komunikim të sigurt. Në kuadër të funksionimit on-line të Qendrës Kombëtare të Monitorimit të Frekuencave dhe komunikimit elektronik me stacionet, AKEP ka siguruar lidhjen data dhe komunikimin online e të sigurtë të stacioneve remote të tij duke marrë me qera linja të dedikuara nga ofrues të shërbimit të aksesit data dhe duke kaluar trafikun në pajisje të prokuara për këtë projekt të cilat e enkriptojnë informacionin.

##### **8.4.6.2 “Zëvendësimi dhe Rinovimi i pajisjeve IT”**

AKEP me qëllim rinovimin dhe zgjerimin e kapaciteteve ekzistuese IT për administratën, duke krijuar kështu kushte më të mira për përmbushjen sa më mirë të detyrave funksionale dhe për tu përshtatur sa më mirë me zhvillimet teknologjike gjithashtu për të rritur produktivitetin në zyrat e AKEP ka kryer zëvendësimin dhe rinovimin e një pjese të pajisjeve kompjuterike si PC, printer, etj.

- Ka patur angazhimin maksimal në Njësinë e Përherëshme të Prokurimit të AKEP dhe ndjekjen e tenderave të zhvilluar. Përgatitja e dokumentacionit përkatës, ngarkimi i dokumentave dhe ndjekja e proceseve përkatës në sistemin online të Prokurimeve Publike,
- Gjithashtu nga ana e DTIZHB është marrë pjesë në mënyrë aktive në grupe inspektimi dhe monitorimi, sipas urdhërave përkatës.

## 8.5 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve dhe mbrojtja e konsumatorit

Ligji nr. 9918 parashikon që AKEP

- zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, në rastet kur ato lidhen me zbatimin e këtij ligji dhe të rregullave të nxjerra në zbatim të tij;
- nëse një mosmarrëveshje me një pajtimtari dhe një sipërmarrësi që ofron shërbime të komunikimit elektronik publik nuk mund të zgjidhet nëpërmjet procedurave për trajtimin e ankesave, sipas nenit 107 të këtij ligji, pajtimtari mund të kërkojë nga AKEP-i të zgjidhë mosmarrëveshjen.

Ligji nr. 46/2015 parashikon që AKEP:

- zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet ofruesve të shërbimeve postare dhe përdoruesve, kur të tilla mosmarrëveshje kanë të bëjnë me të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji;
- zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet ofruesve të shërbimit postar që lidhen me zbatimin e këtij ligji dhe rregullave të nxjerra në zbatim të këtij ligji.

Për ushtrimin e këtyre funksioneve, të shqyrtimit të ankesave administrative ndaj akteve të nxjerra nga AKEP, sipas procedurës së parashikuar në legjislacionin e procedurave administrative, përfaqësimit në shqyrtimin gjyqësor çështjeve ku AKEP është palë, si dhe të hartimit të projektakteve që nxjerr AKEP-i dhe interpretimit administrativ të legjislacionit kur paraqitet nevoja, në strukturë dhe organikën e institucionit është ngritur dhe funksionon drejtoria e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe mbrojtjes së konsumatorit.

Në këtë kuadër gjatë vitit 2016, kryerja e detyrave për sigurimin e mbështetjes në aspektin ligjor të veprimtarisë së AKEP gjatë ushtrimit të kompetencave dhe funksioneve rregullatore dhe administrative, si dhe mbrojtjes së përdoruesve, nga DZMMK ka konsistuar në:

### 8.5.1 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve midis sipërmarrësve

Gjatë vitit 2016, në rastet kur AKEP-i është investuar për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis sipërmarrësve, ka ushtruar kompetencat e tij rregullatore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative sipas procedurave ligjore dhe rregullatore. Mosmarrëveshjet e shqyrtuara në vitin 2016 në varësi të problematikës dhe objektit të tyre grupohen kryesisht në:

- mosmarrëveshje interkoneksioni, midis operatorëve.

### ***8.5.2 Shqyrtimi i ankesave dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve midis pajtimtarëve dhe sipërmarrësve***

Rastet e ankesave të paraqitura në AKEP kanë qenë nga persona fizikë dhe persona juridikë. Këto ankesa kanë patur objekt kryesisht problematikën lidhur me:

- zbatimin e kushteve të kontratës me pajtimtarin, përmbushjen e detyrimeve kontraktuale;
- faturimi i shërbimeve të ofruara;
- cilësia e shërbimeve të kontraktuara;
- shërbimi i portabilitetit të numrit.

të cilat pasi janë shqyrtuar administrativisht, zgjidhja e tyre është ofruar nga AKEP nëpërmjet nxjerrjes së rekomandimeve dhe përgjigjeve përkatëse me shkrim.

### ***8.5.3 Ankesa administrative***

Gjatë vitit 2016, janë paraqitur nga sipërmarrësit dhe persona të tjerë ( fizik/juridik) 10 (ankime administrative) kundrejt akteve të nxjerra nga AKEP-i, të cilat duke u nisur nga problematika e ngritur konsistojnë në:

- 3 (tre) ankime administrative kundër vendimmarrjes së AKEP për monitorimin e efekteve të mos diskriminimit të tarifave *on net/off net* dhe ecurinë e skemës për reduktimin e asimetrisë së tarifave të terminimit në nivel shumice në tregun celular;
- 3 (tre) ankime administrative kundër vendimmarrjes së AKEP për procedura të tenderimit publik;
- 2 (dy) ankime administrative kundër vendimmarrjes së AKEP për lënien në fuqi të gjobave të vendosura;
- 1 (një) ankim administrative kundër vendimmarrjes së AKEP në lidhje me ndryshimin e Vendimit të Këshillit Drejtues nr.2689 datë 22.09.2016 për miratimin e dokumentit "Rregullore për mënyrën e zbatimit të Portabilitetit të Numrit";
- 1 (një) ankim administrative për moszbatim të rregullt dhe ligjor të procedurës së dhënies dhe caktimit të domain-it nga AKEP.

### ***8.5.4 Mosmarrëveshjet gjyqësore***

Pjesë e veprimtarisë së AKEP-it është edhe ndjekja e çështjeve gjyqësore në të cilat AKEP-i ka qenë Palë Padi tëse, i Paditur apo Palë e Tretë. Gjatë vitit 2016 janë ndjekur 30 (tridhjetë) çështje gjyqësore ( 175 seanca gjyqësore të ndjekura gjithësej) të cilat sipas objektit janë grupuar kryesisht në:

- Çështje gjyqësore në lidhje me marrëdhëniet e aksesit dhe interkoneksionit.
- Çështje gjyqësore për konkurrencë të pandershme.

- Çështje gjyqësore në lidhje me detyrimin e sipërmarrësve për të përmbushur detyrimet financiare të papaguara për faturën e lëshuar nga AKEP.
- Çështje gjyqësore në lidhje me konstatimin e pavlefshmërisë të Vendimeve të Këshillit Drejtues të AKEP dhe shfuqizimin e tyre si dhe detyrimin e AKEP për nxjerrjen e një akti të ri administrativ në përputhje me ligjin.
- Çështje gjyqësore në lidhje me shfuqizimin e vendimeve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë së datës datë 26.11.2009, “Për Lirimin nga detyra të disa prej anëtarëve të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare” dhe detyrimi i palës së paditur të dëshpërblejë paditësin me pagën që do të përfitonte deri në plotësimin e mandatit të anëtarit.
- Çështje gjyqësore kundër akteve të nxjerra nga AKEP për lirimin nga detyra të punonjësve, përfitimin e dëmshpërblimit.
- Çështje gjyqësore për procedurat e prokurimit publik.
- Çështje gjyqësore për anulim të faturave të lëshuara nga AKEP.
- Çështje gjyqësore për të drejtën e emrit domain.

## **8.6 Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe administrimi i brendshëm.**

Me Vendim të Kuvendit të Shqipërisë nr.88/2015 “Për miratimin e strukturës, organikes dhe kategorizimit të pozicioneve të punes të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)” është miratuar struktura organizative dhe organika e AKEP, e përbërë nga 73 punonjës.

Gjatë vitin 2016, AKEP përmbushi detyrimet ligjore që burojnë nga ligji nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë “i ndryshuar, dhe legjislacionin në fuqi të marrdhënieve të punës të nëpunësve civil dhe për punonjësit mbështetës, si për përmbushjen e detyrave funksionale, ashtu dhe për rritjen e performancës.

### **8.6.1 Në drejtim të menaxhimit të burimeve njerëzore është realizuar**

- Implementimi i strukturës së re, miratuar me Vendim të Kuvendit të Shqipërisë nr.88/2015 të Kuvendit të Shqipërisë “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punes të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)” është ndjekur në zbatim të Ligjit Nr.152/2013 “Për nëpunësin Civil” i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi për nëpunësit civil dhe sipas Kodit të Punës për punonjësit mbështetës duke mundësuar rritjen e efikasitetit të stafit dhe cilësisë së kapaciteteve të burimeve njerëzore, në përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe rritjes së fleksibilitetit dhe transparencës në ushtrimin e funksioneve, në gjithë veprimtarinë e punës së AKEP.
- Nëpërmjet strukturës përkatëse janë mbikëqyrur dhe menaxhuar burimet njerëzore, duke zbatuar ndryshimet në legjislacionin për shërbimin civil, në respektim të parimeve kryesore të tij, për të mundësuar reduktimin e subjektivizmit në procesin e

konkurrimit, përzgjedhjes së kandidatëve të kualifikuar profesionalisht, bazuar në merita, transparencë dhe llogaridhënie.

- Në zbatim të Ligjit nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil” dhe akteve nënligjore të tij AKEP ka zhvilluar gjatë vitit 2016 sipas strukturës së miratuar të gjitha procedurat e vendeve vakante të AKEP duke bërë publikimin e tyre në portalin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe në faqen zyrtare të institucionit [www.akep.al](http://www.akep.al). Gjithçka është realizuar duke respektuar detyrimin ligjor të Vendimit nr.243, datë 18.3.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” dhe Vendimit nr. 242, datë 18/03/2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”.
- Janë ndjekur procedurat për punonjësit mbështetës në zbatim të Kodit të Punës dhe akteve nënligjore.
- Janë ndjekur trajnimet e nëpunësve në periudhë prove pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) sipas datave të emërimeve.
- Në zbatimin e Ligjit Nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë” dhe të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005 ” Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, Autoriteti Përgjegjës ka realizuar detyrat duke përmbushur të gjitha detyrimet ligjore të vendosura nga ILDKPKI lidhur me përditësimin e regjistrit të subjekteve që mbartin detyrim për deklarim të interesave private dhe për çdo informacion që kërkohet në lidhje me subjektet e deklarimit në AKEP. Duke dorëzuar të gjitha deklaratat e subjeteve deklarues të AKEP në afat.
- Mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 119, datë 18.9.2014, "Për të drejtën e informimit" nëpërmjet Programit të Trasparencës së AKEP, duke mundësuar azhurnimi në vijmësi të faqes zyrtare të AKEP me informacionet të domosdoshme në zbatim të legjislacionit në fuqi.
- Duke qenë se AKEP është një institucion që mbikëqyr sektorë shumë të specializuar siç janë ato të komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve postare është punuar në vazhdimësi për rritjen e kapaciteteve dhe ngritjen profesionale të stafit të AKEP duke mundësuar pjesëmarrjen në disa aktivitete kualifikuese si seminare, trajnime dhe programe të organizuara nga ITU, UPU, Cullen International dhe agjenci të tjera të specializuara në fushën e telekomunikacioneve. Shfrytëzimi efikas i të gjitha burimeve, në drejtim të trajnimit të punonjësve të AKEP, mendojmë se ka mundësuar realizimin me sukses të objektivave të përcaktuara në legjislacionin e komunikimeve elektronike.
- Duke qenë se dosjet e personelit dhe regjistri themeltar i punonjësve kanë vlerë administrative e juridike është bërë e mundur mirëadministrimi i tyre sipas Kodit të Punës dhe Ligjit të Nënpunësit Civil 152/2013 dhe akteve nënligjore të tij.
- Për shkak të rëndesise së veçantë që kanë të dhënat e personelit është plotësuar në vijim Regjistri Themeltar i Personelit sipas Vendimit të Kuvendit të Shqipërisë nr.88/2015 të Kuvendit të Shqipërisë “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe



Postare (AKEP)” duke u koordinuar edhe me Drejtorinë e Menaxhimit Financiar dhe Pagesave, për të dhënat e nevojshme për pagat, klasat, vjetërsinë në punë etj. Është ndjekur me dinamikë pasurimi i dosjeve të personelit, duke bërë në to ndryshimet përkatëse në bazë të akteve administrative;

- Ka vazhduar puna në informatizimin dhe automatizimin e proceseve të punës në institucion për implementimin e programit Revzone dhe Access Controllit duke administruar fushën HR në programin e Revzone – s. Si dhe është administruar programi HRMIS për hedhjen e të dhënave të punonjësve të AKEP në DAP.
- Është ndjekur procesi i « Vleresimit në Pune » të nëpunësve civil dhe të punonjesve mbështetës të DMBNJAB. DMBNJAB-it ka ndjekur procedurën për sistemin e vlerësimeve dhe mbarëvajtjen e tyre në bashkëpunim me drejtoret e drejtorive.
- Është ndjekur realizimi i trajnimeve “Formimi i vijueshëm profesional të nëpunësve civil të AKEP” nga të gjitha drejtoritë e AKEP sipas planit të miratuar nga Kryetari i AKEP.
- Janë menaxhuar shërbimet mbështetëse të AKEP-it, në të dy godinat, në funksion të institucionit, duke bërë të mundur funksionimin normal të veprimtarisë së tij. Janë ndërmarr masa për sigurimin e kushteve të duhura:
  - në zyrat e marra me qera për punonjësit e administratës
  - në Qendrën Kombetare të Monitorimit të Frekuencave
  - në Zyrat Rajonale
- Është ndjekur korrespondenca me intucionet e tjera ASPA, DAP, Shërbimi Kombëtar i Punësimit etj, në lidhje me çështje të ndryshme të cilat janë ndjekur nga Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Administrimit të Brendshëm.

### **8.6.2 Në drejtim të administrimit të brendshëm janë kryer**

Në zbatim të Ligjit “Për Prokurimin Publik” nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar dhe akteve nënligjore të tij, në bazë të regjistrimit të parashikimeve të prokurimeve publike për vitin 2016, AKEP ka zhvilluar normalisht dhe me efektivitet procedurat e prokurimit publik duke zbatuar të gjitha detyrimet ligjore në fuqi.

Gjatë vitit 2016, janë realizuar 13 procedura prokurimi, kontratat e të cilave janë lidhur në vitin 2016. Në të gjitha procedurat e realizuara, është bërë kujdes dhe janë plotësuar Formularët e deklaramentit të konfliktit të interesave nga antarët e komisionit të vlerësimit të ofertave dhe njësia e prokurimit.

Procedura e prokurimit me objekt “Zhvillim i sistemit kombëtar të monitorimit të spektrit të frekuencave, pajisje për stacion të thjeshtë fiks monitorimi (SRFMS) në Shkodër dhe Vlorë”, nuk është realizuar brenda vitit 2016, për arsye se është pezulluar nga Gjykata e Lartë.

Tabela 21- Regjistri i realizimeve të prokurimit publik për Vitin 2016

Nr	Objekti i prokurimit	Fondi Limit (pa TVSH)	Vlera e kontratës (me TVSH)	Lloji i procedurës së prokurimit	Koha e zhvillimit të procedurës
1	UPGRADE ARGUS	7,750,000	8,940,000	Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës	19.12.2016
2	Blerje pajisje kompjuterike	2,900,000	3,419,508	Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës	05.12.2016
3	Analizator spektri portativ për gjetjen e interferencave dhe pajisjeve gjurmuese të burimit interferues me gjetje drejtimi	5,166,666	6,169,749.6	Kërkese për propozim	30.11.2016
4	Sistem sigurie, kamera, sistem kondicionimi, UPS dhe akses kontrolli të kontrollueshëm në distancë për Stacionin Fiks të Monitorimit (RFMS) në Shkodër, Vlorë dhe Korçë	2,250,000	2,549,760	Kërkese për propozim	23.09.2016
5	Sistem dhe rrjeti i komunikimit të Q.K.M.F me pikat e monitorimit në distancë	2,333,333	2,739,600	Kërkese për propozim	31.08.2016
6	Ruajtja dhe sigurimi i objekteve të AKEP me roje private	7.515.952	8,214,451.17	Kërkese për propozim	21.07.2016
7	Software support për Qendrën Kombëtare të Lëvizshme të Monitorimit të cilësisë (TEMS)	1,916,667	2,293,104	Kërkesë për propozim	12.07.2016
8	Blerje pajisje për zyra	1.250.000	1,429,200	Kërkesë për propozim	16.06.2016
9	Upgrade i sistemit të menaxhimit të cctld.al	4,050,000	4,859,400	Kërkesë për propozim	14.06.2016
10	Mirëmbajtje dhe Operim i CRDB të Portabilitetit të Numrit.	33.333.600	39,997,440	Procedurë e hapur	16.03.2016
11	Upgrade i dhomës së Serverave pranë QKMF	2.000.000	2,289,566.40	Kërkesë për propozim	15.03.2016
12	Blerje Karburanti 2016	2.416.667	2,900,000	Kërkesë për propozim	09.03.2016
13	Blerje e shërbimit të informacionit rregullator	15.000 EURO	15.000 EURO	Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës	19.01.2016

### **8.6.3 Administrimi i shërbimeve mbështetëse për institucionin**

Administrimi i shërbimeve mbështetëse të institucionit ka siguruar mbarëvatjen e veprimtarisë së brendshme të AKEP, në mbulimin e nevojave të burimeve njerëzore me logjistike dhe shërbime mbështetëse, me qëllim sigurimin e kushteve më optimale dhe më efikente në veprimtarinë e institucionit në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### **8.6.4 Dixhitalizimi i Arkivës së AKEP**

Për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe sistemimin e dokumenteve hyrëse dhe dalëse në AKEP ka vijuar me sukses procesi i dixhitalizimit të arkivës i cili mundëson aksesimin e informacionit në kohë reale dhe kërkimin e tyre ndër vite.

## **8.7 Mbikqyrja e tregut të shërbimeve postare**

### **8.7.1 Paketa rregullatore e hartuar dhe miratuar nga AKEP në zbatim të Ligjit 46/2015**

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, me synim përmbushjen e qëllimit të përcaktuar në Ligjin 46/2015, si autoriteti kombëtar përgjegjës për rregullimin dhe mbikqyrjen e shërbimeve postare në Republikën e Shqipërisë, ka përmbyllur detyrimin ligjor mbi hartimin dhe miratimin e kuadrit të plotë rregullator në zbatim të Ligjit 46/2015.

Konkretisht, AKEP gjatë vitit 2016, në fushën e rregullimit të shërbimeve postare ka filluar dhe përfunduar procedurat përkatëse ligjore për hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore si më poshtë:

- I. Me vendimin Nr.2670, datë 3.03.2016, të Këshillit Drejtues të AKEP, është miratuar Rregullorja Nr.41, datë 03.03.2016 *‘‘Mbi ndarjen e llogarive dhe llogaritja e kostos së shërbimit universal postar’’*.

Qëllimi kryesor i këtij dokumenti është plotësimi i kuadrit rregullator të shërbimeve postare, nëpërmjet që janë në përputhje me përcaktimet në Ligjin 46/2015 dhe të rregullave e udhëzimeve të parashikuara në kuadrin rregullator European në sektorin e shërbimeve postare. Konkretisht, ky dokument ka përcaktuar rregullat dhe metodat për mbajtjen e llogarive të ndara në sistemin e kontabilitetit/llogaritjes së kostos dhe procedurat e raportimit të ofruesit të shërbimit universal postar për zbatimin e këtyre detyrimeve.

Rregullorja është nxjerrë në bazë të nenit 31 të Ligjit 46/2015 *‘‘Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë’’*, ku është përcaktuar detyrimi i ofruesit të shërbimit universal postar për të mbajtur llogari të ndara, brenda sistemit të tyre të kontabilitetit, për të dalluar, në mënyrë të qartë, shërbimet dhe produktet që janë pjesë e shërbimit universal postar dhe ato që nuk janë pjesë e këtij shërbimi, me qëllim llogaritjen e kostove neto të shërbimit universal postar.

- II. Me vendimin Nr.2671, datë 3.03.2016, të Këshillit Drejtues të AKEP, është miratuar Rregullorja Nr.42, datë 03.03.2016 ‘*Mbi llogaritjen e kostove neto të shërbimit universal postar*’.

Dokumenti është hartuar dhe miratuar në vazhdim të plotësimit të kuadrit rregullator të shërbimeve postare, në përputhje me përcaktimet në Ligjin 46/2015, dhe të rregullave dhe udhëzimeve të parashikuara nga kuadri rregullator European në sektorin e shërbimeve postare. Qëllimi i këtij dokumenti është të plotësojë kuadrin rregullator për llogaritjen e kostove neto të shërbimit universal postar, dhe procedurën për depozitimin dhe verifikimin e të dhënave për kostot neto.

Ligji 46/2015, parashikon detyrimin e AKEP për të përcaktuar nëpërmjet një rregullore, mënyrën e llogaritjes së kostos neto, si dhe të përfitimeve të patrupëzuara, të cilat duhen mbajtur në vëmendje për llogaritjen e kostove neto për ofrimin e shërbimit universal postar.

- III. Me vendimin Nr. 2694, datë 27.10.2016, të Këshillit Drejtues të AKEP, është miratuar Rregullorja Nr.45, datë 27.10.2016 ‘*Metodikë e inspektimit të veprimtarisë së ofruesve të shërbimeve postare*’.

Hyrja në fuqi e Ligjit të ri 46/2015 ‘Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë’, jo vetëm përditësoi në aspektin normativ fushën e rregullimit të shërbimeve postare por dhe ripërcaktoi kushtet teknike dhe termat specifike sipas të cilave do të ushtrohet veprimtaria e shërbimeve postare, në përputhje të plotë me standartet e vendosura në legjislacionin ndërkombëtar dhe kryesisht me *acquis communautaire* të BE-së. Për rrjedhojë, hartimi dhe miratimi i rregullores së re për inspektimin e veprimtarisë së ofruesve të shërbimeve postare, erdhi si nevojë e përshtatjes së akteve rregullatore dhe të veprimtarisë inspektuese të AKEP me Ligjin 46/2015.

Konkretisht, qëllimi i Rregullores ‘Metodikë Inspektimi i veprimtarisë së ofruesve të shërbimeve postare’, është rregullimi i ushtrimit nga AKEP i veprimtarisë inspektuese sipas legjislacionit për inspektimin në Republikën e Shqipërisë, në kushtet specifike teknike dhe metodike të fushës ku ushtrohet veprimtaria e shërbimeve postare, të parashikuara sipas Ligjit Nr.46/2015, datë 07.05.2015 ‘Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë’, dhe akteve nënligjore dhe rregullatore në zbatim të tij.

Metodika e veçantë e inspektimit ka përcaktuar politikat, standardet dhe procedurat që ndiqen nga AKEP për ushtrimin e veprimtarisë inspektuese në përputhje me përcaktimet e Ligjit Nr.10433, datë 16.06.2011 ‘Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë’, si dhe drejtimet e përgjithshme të zhvillimit dhe kryerjes së inspektimit sipas Manualit të Përgjithshëm të Inspektimit.

### **8.7.2 Mbikqyrja, monitorimi dhe ushtrimi i kontrollit të veprimtarisë së ofruesve të shërbimeve postare**

Në mbështetje të nenit 9, nenit 60 e vijues të Ligjit 46/2015 “Për Shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë”, të Rregullores Nr.45, datë 27.10.2016 “Metodikë e Inspektimit të veprimtarisë së ofruesve të shërbimeve postare”, AKEP ka ndërmarrë masat administrative përkatëse për mbikqyrjen, kontrollin dhe monitorimin e veprimtarisë së ofruesve të shërbimeve postare.

Gjatë vitit 2016, AKEP ushtroi veprimtarinë inspektuese pranë ofruesit të shërbimit universal postar, dhe 5 subjekteve ofrues të shërbimeve alternative postare:

1. Posta Shqiptare – **Ofrues i Shërbimit Universal Postar**
2. T.N.T. Express Albania;
3. Albanian Cargo Service;
4. Sky Net Logistic;
5. Albanian Delivery Express;
6. RadMail.

Në zbatim të Autorizimit të Inspektimit Nr.1797, datë 10.11.2016, grupi i inspektimit të AKEP, ushtroi inspektimin pranë subjektit ofrues të shërbimit universal postar “Posta Shqiptare” Sh.a, me objekt inspektimi:

- a) Kontrollin mbi respektimin e tarifave të shërbimit universal postar në përputhje me përcaktimet e ligjit 46/2015 dhe Rregullores për "Ofrimin e Shërbimit Universal Postar";
- b) Hartimin, publikimin dhe zbatimin e termave dhe kushteve të përgjithshme të përcaktuara në nenin 32 të ligjit 46/2015;
- c) Respektimin e kërkesave thelbësore të përcaktuara në nenin 20 të ligjit 46/2015;
- d) Monitorimin mbi cilësinë e shërbimit/standardet e shërbimit universal postar dhe shërbimit postar ekspres;
- e) Organizimin e rrjetit postar dhe shërbimet postare të ofruara;
- f) Procedurën mbi zgjidhjen e mosmarrëveshjeve/ankesave ndërmjet:
  - ofruesve të shërbimeve postare dhe ofruesit të shërbimit universal postar,
  - përdoruesve dhe ofruesve të shërbimit postar.
- g) Verifikimin mbi zbatimin e kërkesave të përcaktuara në Udhëzimin Nr.4038, datë 4.09.2015, "Për përcaktimin e shërbimeve universale postare që ofrohen pa pagesë për personat e verbër dhe pjesërisht të verbër";
- h) Verifikimin mbi zbatimin e kërkesave të përcaktuara në Urdhërin Nr.6174, datë 16.12.2015, "Për përcaktimin e dëndësisë së pikave të aksesit për ofrimin e shërbimit universal postar".

Në përfundim të inspektimit pranë subjektit ofrues të shërbimit universal postar, grupi i inspektimit konstatoi konkretisht si më poshte:

- Posta Shqiptare sh.a. kryen pjesërisht dorëzimin e paketave të vogla dhe kolipostave në adresën e marrësit sipas përcaktimit në pikën 1 të nenit 40 të Ligjit 46/2015, dhe për paketat e vogla dhe kolipostave që dorëzohen në zyrat postare duke ndjekur procedurën e njoftimit me shkrim dhe nëpërmjet telefonit dhe në këtë rast tarifohet (sipas tarifave të miratruara) shërbimi i lajmërimit për tërheqjen e paketave të vogla postare.
- Subjekti ofrues i shërbimeve postare “Posta Shqiptare” sh.a. nuk ka përcaktuar asnjë praktike apo procedurë të qartë mbi respektimin e kerkesave ligjore për mbrojtjen e mjedisit siç është parashikuar në pikën 5), të nenit 32 të Ligjit 46/2015.
- Në analizë të nenit 5 të dokumentit “Rregullore për Shërbimin Universal Postar”, parashikohet kufizimi apo pezullimi i përkohshëm i ofrimit të shërbimeve postare në rastet e situatave të jashtëzakonshme, dhe kështu nuk përcaktohet asnjë plan veprimi me qëllim ofrimin e shërbimeve postare në situata të jashtëzakonshme.
- Ofruesi i Shërbimit Universal Postar “Posta Shqiptare” ka realizuar testet përkatëse mbi shërbimin universal postar ndërkombetar, për objektet postare të nisura nga Posta Shqiptare drejt vendeve të tjera, vetëm me operatorin postar të Kroacisë.

Grupi i Inspektimit të AKEP, për mangësitë e konstatuara gjatë ushtrimit të veprimtarisë inspektuese pranë ofruesit të shërbimit universal postar “Posta Shqiptare”, me qëllim marrjen e masave brënda afateve kohore të parashikuara në ligj nga ofruesi i shërbimit universal, ka vendosur detyrat përkatëse për zbatim.

Veprimtaria inspektuese pranë ofruesve të shërbimeve postare jouniversal për vitin 2016, është fokusuar kryesisht mbi kontrollin dhe mbikqyrjen e objektivave dhe kerkesave të përcaktuara në ligjin 46/2015, të cilat jepen të renditura konkretisht si më poshtë:

- a) Hartimi dhe publikimi i termave dhe kushteve të përgjithshme për ofrimin e shërbimeve postare sipas përcaktimit të nenit 32 të ligjit 46/2015;
- b) Respektimi i kerkesave thelbësore të përcaktuara në nenin 20 të ligjit 46/2015;
- c) Kontrolli mbi cilësinë e shërbimit / standardet e shërbimit postar ekspres;
- d) Organizimi i rrjetit postar dhe shërbimet postare të ofruara;
- e) Ndjekja e procedurave për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve/ankesave ndërmjet:
  - ofruesve të shërbimeve postare dhe ofruesit të shërbimit universal postar,
  - përdoruesve dhe ofruesve të shërbimit postar.
- f) Respektimi i detyrimeve të përcaktuara në VKM Nr.788, datë 26.11.2004, i ndryshuar me VKM Nr.711, datë 21.08.2013 “Për caktimin e tarifës dhe peshës të shërbimeve të rezervuara për operatorin publik postar”:
  - për kontratat e lidhura me subjektet;
  - për përdoruesit e thjeshtë.

Subjekteve ofrues të shërbimeve alternative postare të kontrolluara, ju caktuan detyra mbi plotësimin dhe publikimin e dokumentacionit mbi termat dhe kushtet e përgjithshme për ofrimin e shërbimeve postare sipas nenit 32 të ligjit 46/2015 dhe akteve rregullatore të nxjerra nga AKEP, përcaktimin e qartë të procedurave konkrete që duhet të ndiqen për plotësimin e kërkesave thëlbësore për ofrimin e shërbimit postar sipas nenit 20 të ligjit etj.

### ***8.7.3 Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare dhe kombëtare në fushën e rregullimit të shërbimeve postare***

Përgjatë periudhës së raportimit, AKEP ka marrë pjesë në takimet e programuara të Grupit të Rregullatorëve Evropian për Shërbimet Postare (ERGP), duke konfirmuar në vazhdim angazhimin e institucionit në aktivitetet kryesore të ERGP-së. Në fokus të takimeve dhe dokumentave të nxjerrë nga ERGP për vitin 2016, kanë qënë sigurimi i vazhdueshmërisë së shërbimit universal në sektorin postar, ndjekja e praktikave më të mira në fushën e mbrojtjen e konsumatorit, si dhe raporte mbi gjendjen e liberalizimit të tregut postar Evropian, mbi cilësinë e shërbimit postar, shpërndarjen e pakove postare ndërkufitare (e-commerce), liberalizimi i tregut dhe monitorimin e treguesve kryesore të tregut postar.

Në datat 20 Shtator - 7 Tetor 2016 u zhvillua Kongresi i 26-të Universal Postar, në Stamboll, Turqi. Kongresi Universal Postar si autoriteti më i lartë vendimarrës i Unionit Universal Postar mblidhet çdo katër vjet me qëllim përcaktimin dhe miratimin e strategjisë dhe planit të aktiviteteve dhe veprimtarisë që do të ndjek Unioni Universal Postar gjatë ciklit të tij të punës. Në Kongresin e UPU, u diskutuan gjërësisht propozimet mbi ndryshimet strukturore të organizatës ndërkombëtare postare, adresimin e çështjeve me rëndësi për zhvillimin e mëtejshëm të tregut postar gjatë mandatit 2017-2020 nëpërmjet dokumentit strategjik “Istanbul World Postal Strategy”, si dhe u shqyrtuan një numër i madh dokumentash teknik e profesional që shoqërojnë ndryshimet e miratuara në këtë Kongres. Vëndet anëtare të UPU-së ranë dakord, në serinë e vendimeve teknike që miratuan dhe për adaptimin e një sistemi të ri të tarifave ndërkufitare, si dhe krijimin e një Fondi të Përbashkët mbi cilësinë e shërbimit i cili do të shërbejë për të zhvilluar më shumë në shkallë të gjerë projekte globale për përmirësimin e e-commerce.

AKEP ka vazhduar bashkëpunimin me autoritetet rregullatore rajonale, me qëllim shkëmbimin e eksperiencës në fushën e rregullimit të sektorit postar. Në këtë optikë, në muajin Dhjetor 2016 u zhvillua pranë ambienteve zyrtare të AKEP takimi midis përfaqësuesve të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare të Kosovës dhe AKEP. Qëllimi i këtij takimi ishte jo vetëm dhënia e asistencës së AKEP në hartimin e paketës së re rregullatore në zbatim të ligjit të ri për shërbimet postare, por dhe rritja e mëtejshme e bashkëpunimit midis dy autoriteteve në fushën e rregullimit të sektorit postar.

#### **8.7.4 Aktiviteti i bashkëpunimit ndër-institucional dhe marrëdhëniet ndërkombëtare.**

Në kuadër të bashkëpunimit ndër-institucional me autoritetet rregullatore ndërkombëtarë dhe atyre rajonal, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare ka vazhduar të nxisë dinamikën e bashkëpunimit në shkallë ndërkombëtare, duke marrë pjesë aktivisht në takimet e organizatave, shoqatave dhe forumeve të rregullatorëve sektoriale në Europë (BEREC, ITU, ERGP etj.) si dhe ka ndërmarrë nismat përkatëse bilaterale, për shkëmbimin e përvojave dhe të praktikave më të mira.

Konkretisht, AKEP ka ndjekur dhe ka siguruar pjesëmarrjen e stafit të AKEP në takimet e organizuar nga BEREC si dhe ka ndjekur punën në Grupet e punës së BEREC, të cilat janë konkluduar në raportet dhe dokumentat e rëndësishëm të këtij institucioni Europian.

Në vijim, janë ndjekur takimet e Grupit Rregullator Europian të Shërbimit Postar “ERGP”, duke siguruar pjesëmarrjen në takimet e ekspertëve të pasuar nga takimet plenare.

Gjithashtu, përfaqësues të AKEP kanë marrë pjesë në aktivitetet kryesore të ITU për vitin 2016, si dhe në takimet, seminarët dhe workshop të WRC-ITU 2016 dhe WSIS-16.

Gjatë vitit 2016, AKEP ka rritur bashkëpunimin me ente rregullatore të shteteve të rajonit dhe të Europës duke nënshkruar Memorandumet e Bashkëpunimit dhe Shkëmbimit të Informacionit në fushën e komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve postare me Zyrën e Telekomunikacionit të Çekisë, si dhe janë hedhur hapa të mëtejshëm për nënshkrimin e Memorandumeve të Bashkëpunimit me autoritetin rregullator të Malit të Zi dhe përditësimin e Memorandumit të Bashkëpunimit me autoritetin rregullator të Kosovës dhe Turqisë.

Në kuadër të Planit Kombëtar të Integritit Europian 2017-2020, AKEP ka përgatitur dhe dërguar informacione periodike pranë Komisionit Europian në kuadër të zbatimit të MSA, Dokumentit të Partneritetit Evropian (2007), rekomandimeve të Raport Progresit të vitit 2016 dhe rekomandimeve të nënkomiteteve të Stabilizim-Asociimit, për të cilën AKEP është vlerësuar pozitivisht në progres raportin për vitin 2016.

Më poshtë jepen konkretisht raportimet e kryera nga AKEP lidhur me:

- Për Komitetin e Stabilizim-Asociimit mbi zhvillimin e tregut të telekomunikacionit në kuadër të zbatimit të MSA.
- Për nënkomitetin BE-Shqipëri në kuadër të Kapitullit 10 të PKIE - *“Shoqëria e Informacionit dhe Media”- Pjesa mbi Komunikimet Elektronike.*
- Për nënkomitetin BE-Shqipëri në kuadër të Kapitullit 3 të PKIE - *“E drejta e vendosjes dhe liria për të ofruar shërbime”- Pjesa mbi Shërbimet Postare.*
- Për Raport Progresin e Komisionit Europian për vitin 2016.



Më poshtë janë paraqitur në formë tabelare aktivitetet ndërkombëtare në të cilat AKEP ka marrë pjesë përgjatë vitit 2016, duke mos u kufizuar vetëm me njohjen e praktikave më të mira ndërkombëtare sa i përket fushës së komunikimit elektronik dhe postar, por duke luajtur një rol proaktiv dhe bashkëpunues me qëllim adresimin e problematikave dhe sfidave me të cilat përballen sot këta dy sektorë të rëndësishëm.

*Tabela 22- Aktivitetet ndërkombëtare në të cilat AKEP ka marrë pjesë përgjatë vitit 2016*

<b>Nr.</b>	<b>Aktiviteti</b>	<b>Institucioni Organizues</b>
<b>1.</b>	Takimi i Rrjetit të Kontakteve (BEREC CN Meeting)	BEREC
<b>3.</b>	Takimi Plenar i 26-të BEREC	BEREC
<b>4.</b>	Takim Pune AKOS-AKEP (QoS) Projekt i Bnjakezuar	AKEP-AKOS-ITU
<b>5.</b>	Trajnim Tregu Postar	MARKETFORCE
<b>6.</b>	Trajnim Forumin ICC Telekomunikacioni dhe Media	ICC
<b>7.</b>	Konferenca Nderkombeatre e CTU/Memorandum Mirekuptimi CTU (Autoriteti i Komunikimeve të Cekisë) -AKEP	CTU
<b>8.</b>	Workshop Rajonal mbi Menaxhimin e Spektrit dhe Tranzicioni në Transmetimet Dixhitale Toksore për Europën dhe CIS	ITU
<b>9.</b>	Konferencën Rajonale ITU – EC për Europën mbi “ Shërbimin Broadband dhe Mapping i Infrastrukturës	ITU
<b>10.</b>	Nenkomiteti BE-Shqiperi	KE
<b>11.</b>	ITU trajnim Siguria Kibernetike	ITU
<b>12.</b>	Simpoziumi Boterore i Shoqërisë së Informacionit 2016	ITU
<b>13.</b>	2nd BEREC CN Meeting (Takimi i 2-të i Rrjetit të Konatkteve të BEREC)	BEREC
<b>14.</b>	ERGP CN Meeting ( Takimi i Rrjetit të Kontakteve të Grupit European të Rregullatoreve të shërbimit Postare)	ERGP

<b>15.</b>	ITU trajnim Siguria Kibernetike	ITU
<b>16.</b>	27th BEREC plenary Meeting	BEREC
<b>17.</b>	IRG Workshop L2WAP	IRG
<b>18.</b>	AKOS workshop Neutraliteti i Rrjetit	AKOS
<b>19.</b>	Konferenca Nderkombetare e AEK (Rregullatori Maqedonisë)	AEK
<b>20.</b>	ERGP Plenary	ERGP
<b>21.</b>	Extraordinary BEREC plenary	BEREC
<b>22.</b>	BEREC CN Meeting	BEREC
<b>23.</b>	UPU World Congress	UPU
<b>24.</b>	EKIP – ITU International Conference (Rregullatori i Malit të Zi)	EKIP-ITU
<b>25.</b>	ANCOM 25 year Conference (Rregullatori I Rumanisë)	ANCOM
<b>26.</b>	Tak Plenar i 28-të I BEREC	BEREC
<b>27.</b>	Takim Pune ARKEP-AKEP	ARKEP
<b>28.</b>	ERGP CN Meeting	ERGP
<b>29.</b>	RCC Meeting Regional Roaming (Rregullatoret Rajonal)	RCC
<b>30.</b>	EDB Broadband Conference (Banka Europiane Per Zhvillim)	EDB
<b>31.</b>	BEREC CN Meeting	BEREC

<b>32.</b>	Takim Pune UKE-AKEP QoS (Projekt i Binjakezuar AKEP-UKE-ITU)	AKEP-UKE-ITU
<b>33.</b>	ERGP Plenary	ERGP
<b>34.</b>	29th Berec Plenary	BEREC
<b>35.</b>	Mbledhjen Ndërkombëtare të ITU për Vëndet në Zhvillim mbi Përdorimin dhe Menaxhimin e Spektrit	ITU

## 9. Statusi i shërbimit universal për shërbimet publike të komunikimeve elektronike

AKEP në vijim të Planit të Veprimit 2013-2016 për Shërbimin Universal në fushën e komunikimeve elektronike në periudhën Tetor-Nëntor 2016 kreu procesin e këshillimit publik për dokumentin “Statusi i Shërbimit Universal të Komunikimeve Elektronike-këshillim publik”. Qëllimi i këtij dokumenti ishte kryerja e procesit të rishikimit të statusit të SHU, duke evidencuar zhvillimet kryesore në këto vite në tregun e komunikimeve elektronike që kanë lidhje me SHU, si dhe trajtimi i një sërë çështjeve të lidhura me zhvillimin e regjimit të shërbimit universal në Shqipëri.

Më poshtë AKEP ka dhënë disa nga përfundimet kryesore në lidhje me zhvillimet në kuadrin rregullator të BE për SHU dhe aplikimin në vendet e BEREC të SHU, përballueshmërinë e tarifave të komunikimeve elektronike në Shqipëri dhe plani i AKEP për SHU në të ardhmen.

### 9.1 Propozimi i KE për rishikimin e kuadrit rregullator

KE më datë 14.09.2016, publikoi propozimet për rishikimin e kuadrit aktual rregullator të komunikimeve elektronike. Ndër elementët kryesorë të propozimeve të KE, janë:

- Përcaktimin e objektivave jo-detyruese për Shoqërinë Gigabit (Gigabit Society) për vitin 2025 (të gjitha familjet të kenë akses broadband me shpejtësi 100 Mbps, që mund të rritet në shpejtësi me Gigabps);
- Plan veprimi për mbulimin me rrjete celulare 5G;
- Ndërmarja e masave për stimulimin e instalimit të rrjeteve me fibra optike;
- Përcaktimin e afatit minimal prej 25 vitesh për autorizimet e reja individuale për përdorimin e radiofrekuencave;
- Përfshirjen në fushën e SHU të aksesit bazik broadband me çmime të përballueshme;
- Vendosje të tavanëve për tarifën e terminimit në rrjetet fikse dhe celulare;
- Zgjerimi i rolit dhe reformimi i BEREC.

Propozimet e KE për rishikimin e kuadrit rregullator do të jenë objekt i këshillimit me palët e interesuara dhe parashikohet që të miratohen nga Parlamenti dhe Këshilli European fundi i vitit 2017. Në lidhje me SHU, propozimet më të detajuara të KE përfshijnë ndër të tjera:

## A. Fusha e SHU

Dy elementët e detyrueshëm të SHU që duhet të jenë të disponueshme për të gjithë përdoruesit fundorë, me çmime të përballueshme nga vendndodhje fikse janë:

- Shërbimet e komunikimit zanor, d.m.th. shërbime që i ofrohen publikut për të kryer dhe marrë thirrje telefonike nëpërmjet një numri të planit të numeracionit, bazuar në teknologjitë e komutimit në qarqe ose me paketa (circuit switching ose packet switching) propozohet të vijonë të jenë pjesë e SHU.
- Akses funksional në Internet, i përkufizuar si aftësia e të gjithë përdoruesve fundorë për të patur akses në shërbimet bazë (themelore) online që përdoren nga shumica e individëve (p.sh. navigim në faqet web, akses në shërbimet e-Government etj), të dhëna në Aneks V të Direktivës:

(1) E-mail

(2) search engines enabling search and finding of all type of information

(3) basic training and education online tools

(4) online newspapers/news

(5) buying/ordering goods or services online

(6) job searching and job searching tools

(7) professional networking

(8) internet banking

(9) eGovernment service use

(10) social media and instant messaging

(11) calls and video calls (standard quality)

- Detyrimet për numeratorët, shërbimet DES dhe telefonat publikë propozohet të hiqen nga fusha e SHU si detyrime, pasi konsiderohen elementë të vjetëruar, megjithëse vendet që i kanë mund të vazhdojnë ti mbajnë këto detyrime.

B. Kufizime për teknologjinë/llojet e rrjeteve

C. Propozimi i fundit i KE nuk parashikon kufizime se si shërbimet (telefoni dhe akses broadband) mund të ofrohen tek përdoruesi fundor nga vendndodhje fikse, ato mund jenë me rrjete me tela (wired) ose pa tela (wireless).

D. Sigurimi i disponueshëmrisë së SHU për zona ku nuk ka shërbim/mbulim

E. Vendet anëtare do të kenë të drejtë të përcaktojnë një ose disa operatorë si ofrues të SHU për të garantuar disponueshëmrinë e SHU, kur ajo nuk mund të sigurohet nëpërmjet praktikës normale tregtare ose nëpërmjet instrumentave të tjerë të politikave publike si fonde të ndihmës shtetërore ose fonde të BE. Komisioni shpjegon se fokusi duhet të jetë më shumë në përballueshmërinë e konkativitetit aktual se sa në ndërtimin e rrjeteve të reja. Për të stimuluar investimet në rrjete duhet të përdoren instrumenta të tjerë.

F. Përballueshmëria e çmimeve të SHU

- G. Bazuar në analizën e tarifave me pakicë (retail) vendet anëtare mund të vendosin që operatorët të ofrojnë plane tarifore në nivel kombëtar, të ndryshme nga ato të ofruara nga praktika normale komerciale, me qëllim plotësimin e nevojave të përdoruesve me të ardhura të ulëta ose përdoruesit me nevoja specifike (të moshuarit, përdoruesit me aftësi të kufizuara, përdoruesit që jetojnë në zona të largëta). Vendet anëtare gjithashtu mund të vendosin të zgjedhin alternativën e suportit direkt të konsumatorit (p.sh. ofrimi i kuponave).
- H. Refuzimi nga operatorët i ofrimit të SHU për përdorues të veçantë
- I. Operatorët nuk kanë të drejtë të refuzojnë ofrimin e SHU për përdoruesit fundorë, të cilët kanë të drejtë të lidhin kontratë me cilindo operator që ofron akses funksional në Internet dhe komunikim zanor sipas përcaktimeve të SHU. Megjithatë operatorët do të kenë të drejtë të ofrojnë këto shërbime me sistemin me parapagim, me kushtin që njësitë me parapagim të jenë të përballeshme.
- J. Financimi dhe fondi i SHU
- K. Propozimi i KE sjell ndryshim të madh në metodën e financimit të SHU. Sipas propozimit SHU duhet të financohet vetëm nëpërmjet fondeve të buxhetit të shtetit, dhe jo më nëpërmjet fondit të SHU që krijohet vetëm nga kontributet e operatoreve/sectorit të komunikimeve elektronike.

## 9.2 Implementimi i SHU në vendet e BEREC

Dokumenti i BEREC, BoR (17) 41 “*BEREC update survey on the implementation and application of the universal service provisions – a synthesis of the results*” përbën një përditësim të raportit të brendshëm të BEREC të vitit 2014 dhe përmban një përmbledhje/sintezë të rezultateve të sondazhit në lidhje me zbatimin dhe aplikimin e dispozitave të shërbimit universal në 29 vende të BEREC. Dokumenti përmban informacion në lidhje me caktimin e ofruesve të SHU, vlerësimin e kostove neto, mekanizmat e kompensimit, barrës së padrejtë financiare të OSHU, impaktin në konkurrencë dhe masat për përballeshmërinë e tarifave.

Në lidhje me caktimin e ofruesit të SHU, në çdo vend është caktuar të paktën një ofrues, përveç 6 vendeve (nga 29). Mos-caktimi i OSHU nuk nënkupton domosdoshmërisht se shërbimi universal nuk ofrohet, por që SHU mund të sigurohet në mënyre komerciale nga tregu. Mekanizmat e caktimit të SHU kanë ndryshim të madh midis vendeve.

Në lidhje me aksesin broadband vetëm 7 vende kanë deklaruar se kanë përfshirë atë si pjesë të SHU (Spanja, Finlanda, Kroacia, Letonia, Suedia, Malta dhe Çekia):

- Letoni: aksesin broadband si pjesë e SHU është vetëm për përdoruesit me aftësi të kufizuara.
- Kroaci: OSHU ka detyrimin të ofrojë akses broadband me shpejtësi minimale 1 Mbps nga 1 Janari 2015, dhe aktualisht janë 12000 përdorues të këtij shërbimi (pjesë e SHU).

- Spanjë dhe Suedi: shpëjtësia minimale për SHU është 1 Mbps. Në Çeki dhe Finlandë është 2 Mbps, ndërsa në Maltë 4 Mbps
- Austria nuk ka përcaktuar shpejtësi minimale.
- UK është duke vlerësuar përfshjen e aksesit broadband në SHU, por nuk ka vendosur ende në lidhje me specifikimet teknike.

Ndërkohë në lidhje me masat e ndërmarra për promovimin e aksesit broadband jashtë fushës së SHU, shumica e vendeve referojnë se kanë parashikuar në Strategjitë Broadband masa për zhvillimin e infrastrukturës broadband dhe kryesisht me ndihmë shtetërore dhe/ose fonde të BE ndërsa disa vende kanë parashikuar për bashkëfinancim për akses/rrjete broadband në zona të caktuara. Disa vendë përfshijnë detyrime mbulimi me broadband celular në licencat/autorizimet e spektrit të frekuencave të MNO-ve.

### 9.3 Përbalueshmëria e tarifave: Raporti i ITU 2016

Një burim i mirë për krahasimin e tarifave për shërbimet e telefonisë fikse dhe celulare dhe aksesit broadband nga rrjet fikse dhe celular dhe përbalueshmërisë së tyre janë raportet periodike të *ITU Measuring the Information Society Report*. Këto raporte përmbajnë të dhëna për zhvillimin e ICT, duke përdorur ndër të tjera tregues të numrit të përdoruesve të shërbimeve të telefonisë dhe aksesit broadband (rrjete fikse dhe celulare) dhe përbalueshmërisë së çmimeve të këtyre shërbimeve, duke bërë dhe renditje në bazë të indekseve të llogarituar nga ITU. Në dokumentin e nxjerrë në këshillim publik, AKEP publikoi të dhënat e raportit të vitit 2015 të ITU si dhe një vlerësim të AKEP për ecurinë e këtyre treguesve në vitin 2016. Gjatë kësaj periudhe ITU ka publikuar raportin e vitit 2016, dhe AKEP më poshte ka përfshirë të dhëna dhe informacion nga ky raport në lidhje me Shqipërinë.

Tabela 23- Rënditja e Shqipërisë për indeksin e çmimeve të ICT në raportet e ITU 2015-2016<sup>16</sup>

	Rënditja 2014		Rënditja 2015	
	% GNI	Rënditja ITU	% GNI	Rënditja
<b>IPB<sup>17</sup></b>	3.9	106	N/A	N/A
<b>Telefoni Fikse</b>	1.77	91	N/A	N/A
<b>Broadband Fiks</b>	1.77	58	2.57	83
<b>Telefoni celular</b>	8.03	138	1.71	84
<b>Broadband celular</b>	1.26-2.53	58-79	1.18	63-74

<sup>16</sup> Raportet i referohen të dhënave të një viti më parë.

<sup>17</sup> IPB (ICT Price Basket) matet si mesatarja e peshave ndaj GNI të telefonisë fikse, broadband fiks dhe telefoni celular. Shpenzimet për çdo shportë maten sipas metodologjise së ITU. GNI për frymë për Shqipërinë në 2014 ishte 4505USD ndërsa për 2015 është 4450USD. Rënditja kryhet sipas % ndaj GNI nga vlera më ulët në më të madhen për rreth 180 vende.

Në raportin e vitit 2015 Shqipëria renditej në vende të mira përse i përket tarifave të aksesit broadband por në vende më të ulëta për telefoninë, sidomos telefoninë celulare. Situata ka ndryshuar në vitin 2015 për telefoninë celulare për shkak të ndryshimit të metodologjisë së ITU në raportin 2016 dhe ndryshimeve të tarifave të operatorëve celularë në 2015 në Shqipëri pas fillimit të zbatimit të detyrimeve për mos-diskriminimin në tarifat e thirrjeve on-net/off-net dhe masave të tjera rregulluese për ofertat/promocionet e operatorëve celularë. Në raportin 2016 ITU nuk ka matur indeksin total IPB si dhe nuk ka përfshirë të dhëna për tarifat e telefonisë fikse.

Për raportin e vitit 2015 për telefoninë fikse është përdorur paketa Familjare e Altelecom (700 lekë/muaj me TVSH) dhe Shqipëria renditet në vendin 91. Për Shqipërinë, shpenzimet për këtë nën-shportë të shprehura në USD janë më të ulëta në rajon, megjithatë sipas peshës ndaj GNI për frymë Shqipëria renditet pas Kroacisë, Malit të Zi dhe Serbisë në rajon, për shkak të GNI p.c më të ulët në rajon. Për aksesin broadband nga rrjete fikse për vitin 2015 është përdorur paketa Familjare e Altelecom (700 lekë/muaj) e cila përfshin dhe akses broadband 1 Mbps dhe Shqipëria renditej në vendin 58, ndërsa për raportin e vitit 2016 është përdorur paketa ADSL me shpejtësi 2 Mbps dhe 4GB limit (1199 lekë/muaj me TVSH), dhe Shqipëria ka rënë në renditje në vendin 83. Gjithsesi paketa Familjare e Altelecom është ende e disponueshme dhe aksesit broadband me shpejtësi 1 Mbps është pjesë e kësaj pakete me çmim 800 lekë/muaj me TVSH.

Për telefoninë celulare, megjithëse tarifat efektive të paguara nga përdoruesit edhe në vitin 2014 ishin shumë të lira (ARPM dhe ARPU më të ulëta në Evropë), Shqipëria në raportin e ITU 2015 renditej në vende shumë të ulëta (138) për shkak se metodologjia e ITU merrte në konsideratë vetëm tarifat standarde të thirrjeve (pay as you go) për përdoruesit me parapagim. Shpenzimet e llogaritura nga ITU për këtë nën-shportë (rreth 50 minuta kombëtare dhe 100 SMS kombëtare në muaj) me tarifat standarde të Vodafone Albania për paketën Vodafone Club, ishin në nivelin 30USD dhe 8% e GNI për frymë në 2014.

ITU në raportin e vitit 2016, ka marrë në konsideratë tendencën tashmë globale të ofrimit të paketave bundle me parapagim për përdoruesit celularë dhe bazuar dhe në ndryshimet e tarifave të ndodhura gjatë vitit 2015 në Shqipëri<sup>18</sup> renditja e Shqipërisë për nën-shportën celulare është përmirësuar ndjeshëm duke arritur në vendin 84 nga vendi 138 një vit më parë. Shpenzimet mesatare për frymë tashmë zënë 1.71% të të ardhurave mesatare për frymë (GNI) dhe ky nivel konsiderohet i përbalueshëm dhe përmirësimi i renditjes së Shqipërisë për shkak të paketave bundle celulare është cituar edhe nga ITU në raportin e vitit 2016.<sup>19</sup> Pozi-

---

<sup>18</sup> *Prepaid packages with a significantly lower cost than pay-per-use plans are driving down prices in developed countries such as **Albania**, Bulgaria, Croatia, Greece, Italy, Latvia, New Zealand, Romania, the Russian Federation, Slovenia and Sweden.*

<sup>19</sup> *When the GNI p.c. of each country is taken into account in order to assess the affordability of mobile-cellular services, the average price in terms of GNI p.c. in Europe is the lowest of all regions. Most European countries have mobile-cellular prices corresponding to less than 1 per cent of GNI p.c., and all of them are below the 5 per cent of GNI p.c. threshold. **Albania** and Bulgaria were the last European countries to reach this milestone thanks to the price reductions achieved through prepaid bundled packages.*



cioni i mirë i Shqipërisë për shërbimet celulare konfirmohet edhe nga renditja e vendeve sipas përdorimit mesatarë të thirrjeve celulare, ku Shqipëria me 166 minuta thirrje/muaj për përdorues renditet në vendin e 26-të nga rreth 190 vende.

Për shpenzimet për aksesin broadband nga rrjetet celulare (me parapagim nga aparate celulare dhe paspagim me USB) renditja e Shqipërisë nuk ka ndryshime të ndjeshme dhe në raportin e vitit 2016 është në pozicione të mira në vende 63-74. Raporti i ITU i konsideron tarifën e aksesit broadband nga rrjetet celulare në Shqipëri në nivel të përballueshëm (1.18% të GNI) për shkak të nivelit të ulët të tyre<sup>20</sup>.

ITU në raportin 2016 i ka kushtuar një vend të veçantë Shqipërisë (Kutia 2.7 në Raportin 2016) për zhvillimet positive në komunikimet elektronike në vitet e fundit, ku ndër të tjera vihet në dukje:

- Shqipëria renditet e 91<sup>-ta</sup> në IDI për vitin 2016 dhe ka një përmirësim të vlerës së saj nga 4.62 pikë për vitin 2015 në 4.92 pikë për 2016.
- Progresi më i rëndësishëm në vend është bërë në aksesin e internetit dhe rritjen e familjeve me një kompjuter nga 4.9% në vitin 2006 në 25.7% në vitin 2015. Shkalla e penetrimit fiks-broadband ka pësuar një rritje të lehtë nga 6.5% në vitin 2014 në 7.6% në vitin 2015.
- Shpenzimet për shportën e aksesit broadband fiks kanë rënë nga 29.79 USD në muaj për vitin 2008, në 9.52 USD për vitin 2015.
- Shpenzimet për shportën e aksesit broadband celular kanë pësuar ulje nga 32.13 USD në vitin 2008 në vetëm 6.35 USD në vitin 2015. Ulje të këtyre shpenzimeve janë vënë re edhe në periudhën 2012 – 2015.
- Rritja e penetrimit të mobile-broadband, nga 30.9% në vitin 2014 në 40.6% në vitin 2015, është ndikuar nga hedhja në treg e shërbimeve LTE dhe LTE-A, të mundësuar nga ndryshimet ligjore/rregullatore të AKEP për procesin e re-farming të spektrit të frekuencave për shërbimet LTE.
- Zhvillimi i shpejtë i rrjeteve LTE ka çuar në dyfishim të trafikut të të dhënave në rrjetet celulare.

Duke marrë në konsideratë tarifën aktuale të shportave të integruara (telefoni/SMS dhe Internet) në rrjetet celulare për përdoruesit me parapagim rezulton se me 800-1000 lekë/muaj (me TVSH) një përdorues mund të përfitojë rreth 2000 minuta kombëtare, qindra SMS dhe 1-2 GB Internet 3G/4G. Ky nivel konsumi është shumë më i lartë se konsumi i referuar nga ITU si benchmark për krahasimin midis vendeve për përballueshmërinë e tarifave. Në terma të përballueshmërisë shpenzimi 800-1000 lekë/muaj për akses në telefoni dhe Internet celular është 1.75-2.15% e GNI për frymë të Shqipërisë në 2014 (4505 USD).

---

<sup>20</sup> *Mobile-broadband services are affordable in Europe not only because of the high income levels in the region, but also because of the low price of the service. Indeed, in countries such as Estonia, Lithuania, Poland, Serbia and **Albania** prepaid mobile-broadband plans were offered at prices below USD 4 per month in 2015.*

Për nivelin mesatar të të ardhurave, ky nivel shpenzimesh (për konsumin e cituar) vlerësohet të jetë i përballueshëm.

#### **9.4 Përfundimi i AKEP**

Një ndër çështjet më të diskutuara në këshillim publik ishte propozimi i AKEP për përfshirjen e aksesit broadband nga rrjete fikse dhe celulare dhe paketat përkatëse tarifore në objektin e SHU. AKEP bazuar në një sërë faktorësh të analizuar në miratimin e versionit final të dokumentit vendosi që megjithëse zhvillimet shumë të mirat të aksesit broadband, sidomos nga rrjetet celulare vitet e fundit, dhe nivelit të përballueshëm të tarifave me pakicë të aksesit broadband dhe telefonisë (fikse dhe celulare) të ofruara në mënyrë komerciale nga tregu pa ndërhyrjen direkte të AKEP, përfshirja e aksesit broadband në objektin e SHU aktualisht do të ishte e parakohshme (në vendet e BE aplikohet vetëm në 7 vende), dhe mënyra më mirë për promovimin dhe më pas universalizimin e këtij shërbimi janë masat e tjera të ndërmarra nga AKEP si përmirësimi i sinjalit të mbulimit dhe cilësisë së rrjeteve 3G/4G në zona të caktuara nga 3 operatorët kryesorë celularë, masa rregulluese për aksesin broadband fikse, përfshirë masa që ndërmerren nga Qeveria në anën e kërkesës për nxitjen e shtresave në nevojë për përdorimin e këtij shërbimi dhe ICT në përgjithësi.

### **10. Statusi i ofrimit të shërbimit postar**

#### **10.1 Përcaktimet ligjore dhe nënligjore për ofrimin e shërbimit universal postar**

- Bazuar në përcaktimet e ligjit 46/2015 datë 07.05.2015 “Për ofrimin e shërbimeve postare në Republikën e Shqipërisë, shërbimi universal postar është një minimum i përcaktuar shërbimesh, të një cilësie të caktuar, i mundshëm për të gjithë përdoruesit në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga vendndodhja gjeografike, me çmime të përballueshme, sipas përcaktimeve në nenin 12 të këtij ligji.
- AKEP, në mbështetje të nenit 64 pika 3 e ligjit 46/2015, me Vendimin Nr.2581, datë 22.06. 2015 ka pajisur Posta Shqiptare sh.a., me Autorizim Individual për ofrimin e shërbimit universal postar, me afat 5 vjeçar.
- Posta Shqiptare sh.a. ka detyrim të ofrojë shërbimin universal postar në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas kushteve të Autorizimit Individual si dhe sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 46/2015, datë 7.05.2015 “Për shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë”, dhe akteve nënligjore dhe rregullatore të sektorit postar.
- Në plotësim të kërkesave të nenit 65 të ligjit 46/2015 për nxjerrjen e akteve nënligjore të sektorit postar, MIAP ka nxjerrë:

- Urdhrrin nr. 6174, datë 16.12.2015, "Për përcaktimin e dëndësisë së pikave të aksesit për ofrimin e shërbimit universal postar", duke marrë në konsideratë nevojat e përdoruesve për prezencë sa më të gjerë të pikave të aksesit në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
- Udhëzimin nr.4038, datë 4.09.2015, "Për përcaktimin e shërbimeve universale postare që ofrohen pa pagesë për personat e verbër dhe pjesërisht të verbër", i cili përcakton detyrimet e ofruesit të shërbimit universal për ofrimin e objekteve postare cekograme pa pagesë për personat e verbër ose pjesërisht të verbër.
- AKEP, në zbatim të nenit 64 të ligjit 46/2015 ka miratuar paketën e plotë rregullatore të ofrimit të shërbimeve postare, pjesë e së cilës është dhe Rregullorja nr. 36 datë 29.10.2015 "Për ofrimin e shërbimit universal postar", miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr.2627, datë 29.10.2015 në të cilën janë përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen nga rrjeti postar i një ofruesi të shërbimit universal, me qëllim përmbushjen e standardeve të cilësisë së shërbimit postar.


Sipas kërkesave të Autorizimit Individual Posta Shqiptare duhet të zbatohet:

1. Detyrimin e ofrimit të shërbimit universal postar çdo përdoruesi në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga vendndodhja gjeografike, duke përfshirë shërbimet postare brenda vendit dhe ndërkombëtare.
2. Organizimin e rrjetit postar me qëllim sigurimin e shërbimit universal postar sipas kërkesave të ligjit 46/2015 dhe akteve rregullatore të miratuara nga AKEP për ofrimin e shërbimit universal postar.
3. Standardet e cilësisë së shërbimit universal postar;
4. Parimet për përcaktimin e tarifave dhe kostove për ofrimin e shërbimit universal postar.

## **10.2 Tregues të volumit dhe cilësisë së shërbimit universal postar**

Sipas të dhënave të raportuara nga Posta Shqiptare për vitin 2016, shërbimi universal postar me një numër prej 19,638,847 objektësh të pranuar zë **86 %** të totalit të objekteve postare, përkundrajt **3 %** që zë shërbimi ekspres dhe **11 %** shërbimi jouniversal për objekte postare të pranuar.

Figura 30 - Mbulimi i tregut nga Posta Shqiptare sipas llojeve të shërbimeve të ofruara



Posta Shqiptare për përmbushjen e detyrimit ligjor, dhe akteve rregullatore të nxjerra nga AKEP, ofron shërbimin universal postar me një rrjet postar të organizuar, në 559 zyra, me 654 sportele për ofrimin e shërbimit universal postar, nga të cilët 432 sportele janë të automatizuara/kompjuterizuara, duke mbuluar me shërbim të gjithë territorin e vendit. Për pranimin e objekteve postare ka venë në dispozicion të përdoruesve 565 kuti postare dhe për dorëzimin e objekteve postare 606 kuti postare.

#### 10.2.1 Për vitin 2016 Posta Shqiptare në krahasim me vitin 2015 ka realizuar:

Tabela 24- Realizimet e Postës Shqiptare për vitin 2016 krahasuar me vitin 2015

Nr	Shërbime postare të ofruara	Objekte postare 2015	Objekte postare 2016	Ndryshimi 2016/2015
<b>Posta Shqiptare</b>				
<b>1</b>	<b>Shërbimi Universal Postar</b>			
1.1	Postë Brenda vendit	16,819,386	18,416,556	
1.2	Postë ndërkombëtare	1,702,982	1,221,931	
<b>1.3</b>	<b>Totali (1.1 +1.2)</b>	<b>18,522,368</b>	<b>19,638,487</b>	<b>6%</b>
Posta Shqiptare				
<b>1</b>	<b>Shërbimi Universal Postar</b>	<b>2015</b>	<b>2016</b>	
<b>1.1</b>	<b>Postë Brenda vendit</b>	16,822,701	18,416,556	9%
<b>1.2</b>	<b>Postë ndërkombëtare</b>	1,702,982	1,221,931	-28%
<b>1.3</b>	<b>Totali (1.1 +1.2)</b>	<b>18,525,683</b>	<b>19,638,487</b>	<b>6%</b>

### 10.2.2 Treguesit e totalit të shërbimeve postare universale

Deri në fund të tremujorit të katërt të vitit 2016 rezultojnë objekte postare të shërbimit universal postar të pranuar, si më poshtë:

Figura 31- Ecuria e objekteve postare të shërbimit universal postar të ofruara 3M-I 2016 - 3M-4 2016





Figura 32- Shërbimet Postare sipas llojit të paraqitur në tre mujor



### 10.3 Tregues të rrjetit dhe shërbimit universal postar

Posta Shqiptare, me qëllim sigurimin e shërbimit universal postar sipas detyrimit të nenit 12, te Ligjit 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë” si dhe përcaktimet e pikës 3 të Autorizimit Individual me të cilën është pajisur Posta Shqiptare për ofrimin e shërbimit universal postar, ka të organizuar rrjetin postar në **555** zyra të hapura për publikun në të cilat ofrohet shërbim universal postar dhe shërbime jo universale/ekspres, prej të cilave **37** kryejnë funksionin dhe si qendra përpunimi.

- a) Në disa nga zyrat postare, përveç shërbimeve postare, ofrohen shërbime financiare dhe shërbime të biznesit.
- b) Posta Shqiptare ka vënë në dispozicion të publikut për ofrimin e shërbimit universal **654** sportele nga të cilët **432** sportele janë të automatizuar/kompjuterizuar.
- c) Për pranimin e objekteve postare ka venë në dispozicion të përdoruesve **565** kuti postare dhe për dorëzimin e objekteve postare **606** kuti postare, nga të cilat të paktën një kuti postare është e vendosur në çdo zyrë postare.  
Me qëllim mbulimin e të gjithë teritorit të vendit, prezenca e zyrave postare është në të gjitha bashkë dhe në zonat rurale.
- d) Përsa i përket infrastrukturës së mjeteve postare, Posta Shqiptare ka në përdorim **430** mjete transporti. Në mjetet e transportit përfshihen kamiona, furgona, vetura, motocikleta dhe bicikleta.

Në funksion të organizimit dhe shpërndarjes së rrjetit postar Posta Shqiptare për vitin 2016, ka realizuar në ofrimin e shërbimit universal postar këta tregues kryesorë:

- a) Vendodhja dhe të dhënat për çdo zyrë postare që janë paraqitur online në aplikacionin “Map – Google Earth”, në të cilin prezenca e pozicionit gjeografik të çdo zyre postare është shoqëruar me një tabelë ku është paraqitur emertimi i zyrës postare, kodi postar, shërbimeve postare që ofrohen dhe orari i punës, zona e ofrimit të shërbimit si dhe distanca nga zyra në zyrë si dhe midis zyrës postare dhe përdoruesve.
- b) Në lidhje me zbatimin e kërkesave të përcaktuara në Urdhërin e Ministrit Nr.6174, datë 16.12.2015, si dhe duke i'u referuar statistikave të Censurit të vitit 2011, ku numri i popullsisë të Republikës së Shqipërisë është **2,831,741** banorë për sipërfaqe **28,748** km<sup>2</sup>, rezulton se Posta Shqiptare në vitin 2015 ka realizuar treguesit si më poshtë:
  - Shërbimi universal postar ofrohet në **555** zyra postare të hapura për publikun;
  - Një zyrë postare ofron shërbim universal postar për një numër mesatar të popullsisë prej **5,100** banorë.

Është plotësuar detyrimi prej **5,100** banorë i pikës 2/a të Urdhërit të Ministrit Nr.6174, datë 16.12.2015;

- Mesatarisht në një sipërfaqe prej **51.79** km<sup>2</sup> është prezente një zyrë postare që ofron shërbim universal postar.  
Është plotësuar detyrimi prej **53** km<sup>2</sup> i pikës 2/b të Urdhërit të Ministrit Nr.6174, datë 16.12.2015;
- Në zonat urbane, distanca e zyrës postare më të afërt nga adresa e përdoruesit është mesatarisht **5** km.  
Është plotësuar detyrimi prej **5** km i pikës 3 të Urdhërit të Ministrit Nr.6174, datë 16.12.2015.
- Në zonat rurale, distanca e zyrës postare më të afërt nga adresa e përdoruesit është mesatarisht 8 km për 95% te popullsisë.  
Është plotësuar detyrimi prej 8 km i pikës 4 të Urdhërit nr.6174, datë 16.12.2015.

Shërbimet postare kryesore janë të detajuara në zëra të veçantë dhe të saktësuara me peshën dhe përmasat e objekteve postare që pranohen, në përputhje me standardet e UPU-së. Sipas nevojës së përdoruesve në disa prej zyrave postare ofrohen dhe shërbime financiare si dhe shërbime të biznesit.

Sa me sipër, konstatohet se përcaktimi i shërbimeve postare universale të ofruara dhe orari i zyrave postare ka qënë në respektim të kërkesave të nenit 12 të ligjit 46/2015.

#### **10.4 Standardet e cilësisë së shërbimit universal postar**

AKEP, për të garantuar cilësinë e shërbimit universal postar sipas standardeve ndërkombëtare, ka përcaktuar në Rregulloren për ofrimin e shërbimit universal postar, standardet për shërbimin universal postar brenda vendit dhe postës ndërkombëtare.

##### ***10.4.1 Cilësia e Shërbimit/standartet e shërbimit universal postar:***

Në zbatim të kërkesave të Ligjit 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, të Autorizimit Individual për ofrimin e shërbimit universal me të cilin është pajisur “Posta Shqiptare”, Rregullores Nr.36, datë 29.10.2015, “Për ofrimin e shërbimit universal postar”, si dhe duke ju referuar rezultateve të inspektimit në muajt Nentor – Dhjetor 2016, treguesit e cilësisë së shërbimit dhe standardet e shërbimit universal postar rezultojnë të jenë:

##### **➤ *Në zbatim të kërkesave të pikës 9 të nenit 12 të ligjit 46/2015:***

Rezulton se përmasat minimale dhe maksimale për objektet postare (letra dhe pako postare), sipas këtij neni, janë në përputhje me aktet e miratuara nga UPU-ja, si për postën ndërkombëtare dhe për postën brenda vëndit.

➤ ***Pika 2 e nenit 33 te ligjit 46/2015:***

Rezulton se Ofruesi i Shërbimit Universal Postar “Posta Shqiptare”, ka plotësuar detyrimin ku të paktën një herë në vit, të publikojnë informacion për cilësinë e shërbimit universal postar, pasi informacioni është i evidentuar në faqen zyrtare online, rubrika “Standartet e Cilësisë”, të subjektit ofrues të shërbimit universal postar “Posta Shqiptare”.

➤ ***Pika 3 e nenit 33 te ligjit 46/2015:***

Mbi cilësinë e shërbimit, e cila përfshin, në veçanti, kërkesen për kohën e shpërndarjes së objekteve postare, sistemin e informimit për ndjekjen e objekteve postare, rregullsinë dhe besueshmërinë e shërbimeve kombëtare dhe ato ndërkufitare/ndërkombëtare:

***10.4.2 Testet mbi kohën e shpërndarjes së objekteve postare.***

Lidhur me standartet mbi kohën e shpërndarjes së objekteve postare, “Posta Shqiptare” në bazë të Programit të Punës nr.494, datë 10.02.2016 ka zhvilluar teste për postën brënda vëndit mbi standartet e kohës së shpërndarjes së objekteve postare.

Rezultatet e testit ndërmjet qyteteve për objektet letër e thjeshtë, për vitin 2016 krahasuar me vitin 2015 janë si më poshtë:

	<b>Standardi</b>	<b>Fakti 2015</b>	<b>Fakti 2016</b>
D + 1	85.0 %	97.40 %	98.09 %
D + 2	15.0 %	2.56 %	1.86 %
Mbi D + 2		0.04 %	0.05 %

➤ ***Rezultatet e testeve janë brënda standardit të vendosur nga AKEP.***

Rezultatet e testit ndërmjet qyteteve për objektet letër rekomande, për vitin 2016 krahasuar me vitin 2015 janë si më poshtë:

	<b>Standardi</b>	<b>Fakti 2015</b>	<b>Fakti 2016</b>
D + 1	85.0 %	98.5 %	98.7 %
D + 2	15.0 %	1.4 %	1.3 %
Mbi D + 2	–	0.1 %	0.0 %

➤ ***Rezultatet e testeve janë brënda standardit të vendosur nga AKEP.***



#### **10.4.3 Realizimi i treguesve të cilësisë së shërbimit postar për vitin 2016:**

Lidhur me standardet mbi kohën e shpërndarjes së objekteve postare, “Posta Shqiptare” në bazë të Programit të Punës nr.494, datë 10.02.2016 ka zhvilluar teste për postën brënda vëndit mbi standardet e kohës së shpërndarjes së objekteve postare.

Rezultatet e testit ndërmjet qyteteve për objektet letër e thjeshtë, për vitin 2016 krahasuar me vitin 2015 janë si më poshtë:

	<b>Standardi</b>	<b>Fakti 2015</b>	<b>Fakti 2016</b>
D + 1	85.0 %	97.40 %	98.09 %
D + 2	15.0 %	2.56 %	1.86 %
Mbi D + 2		0.04 %	0.05 %

➤ *Rezultatet e testeve janë brënda standardit të vendosur nga AKEP.*

Rezultatet e testit ndërmjet qyteteve për objektet letër rekomande, për vitin 2016 krahasuar me vitin 2015 janë si më poshtë:

	<b>Standardi</b>	<b>Fakti 2015</b>	<b>Fakti 2016</b>
D + 1	85.0 %	98.5 %	98.7 %
D + 2	15.0 %	1.4 %	1.3 %
Mbi D + 2	–	0.1 %	0.0 %

➤ *Rezultatet e testeve janë brënda standardit të vendosur nga AKEP.*

#### **10.4.4 Standardet e kohës së shpërndarjes për postën ndërkombëtare.**

Standardet e kohës së shpërndarjes për postën ndërkombëtare ndërmjet Postës Shqiptare dhe shteteve të BE dhe shteteve që nuk janë anëtare të BE realizohet nëpërmjet testeve të zhvilluara nga kompanite postare nën monitorimin e UPU-së si dhe standardeve të Post Europës. Rezultatet e këtyre testeve shërbejnë si referencë për matjen e standarteve për kohën e shpërndarjes së postës ndërkombëtare.

Posta Shqiptare gjatë vitit 2016 ka marrë pjesë në sistemin GMS (Global Monitoring System) të monitoruar nga Unioni Postar Ndërkombëtar për matjen e cilësisë së shërbimit me objekt letrën e thjeshtë.

Posta Shqiptare kërkoi të shkëmbejë teste me 5 operatorë postare si Austria, Kroacia, Zvicra, Sllovenia dhe Hungaria, por vetëm operatori postar Kroat pranoi bashkëpunimin me Postën Shqiptare. Rezultatet e testeve me operatorin postar të Kroacisë, janë brënda standartit të vendosur nga AKEP për shërbimin universal postar ndërkombëtar.

#### Postë ndërkombëtare

	Vëndet e BE	Vëndet e Tjera (UPU)
	%	%
<b>D+3</b>	92	NA <sup>21</sup>
<b>D+5</b>	99	NA
<b>D&gt;5</b>	100	NA

#### 10.4.5 Dorëzimi i objekteve postare.

➤ Në pikën 1 të nenit 40 të Ligjit 46/2015 është përcaktuar se:

Shpërndarja dhe dorëzimi i objekteve postare duhet kryer në njërën nga këto adresa të marrësit:

- në banesën e tij;
- në ambientet e punës ose të biznesit;
- në kutinë postare, të vendosur në ambientet përkatëse.

Nga kontrolli i ushtruar në Zyrën Postare nr. 5/1, Tiranë, mbi dorëzimin e objekteve postare (pako/koli) konstatohet se:

- Për objektet postare kolipostë, për shkak të pamundësisë tekniko/ logjistike, subjekti ofrues i shërbimit universal postar “Posta Shqiptare”, nuk i dorëzon objektet postare kolipostë në adresë të marrësit, por dorëzohen në zyrat postare përkatëse.
- Paketat e vogla postare për të cilat dërguesi ka zgjedhur shërbimin ekspres ndërkombëtar apo brënda vëndit dorëzohen në adresën e marrësit.
- Paketat e vogla postare për të cilat dërguesi ka zgjedhur shërbimin universal postar apo jo universal dorëzohen pjesërisht në adresën e marrësit, dhe pjesërisht dorëzohen pranë zyrave postare përkatëse.

Në referim të pikës c), për objektet postare të cilat nuk dorëzohen në adresë por pranë zyrave postare përkatëse, subjekti ofrues i shërbimit universal postar “Posta Shqiptare”, kryen njoftimin për tërheqjen e objektit postar nëpërmjet dëftesës së shkruar mbi mbërritjen e objektit postar, dhe nëpërmjet njoftimit telefonik (sms).

Pas njoftimit mbi tërheqjen e objektit postar, marrësi paraqitet në zyrën postare për tërheqjen e objektit postar. Në këtë rast marrësi detyrohet të paguajë sipas tarifave të miratuara e cila sipas objekti postar rezulton të jetë:

- Për paketat e vogla 30 leke;
- Për kolipostat 50 leke.

<sup>21</sup> Matja e cilësisë së shërbimit në këtë rast kryhet sipas standarteve të vendosura dhe të kontrolluara nga UPU.

- *Rezulton se Posta Shqiptare kryen pjesërisht dorëzimin e objektet postare kolipostë në adresën e marrësit.*

## **10.5 Tarifat dhe kostot për ofrimin e shërbimit universal postar**

Ligji 46/2015 përcakton dhe parimet për tarifën e shërbimit universal postar dhe metodat e mundshme për rregullimin e tyre.

Tarifat për shpërndarjen e objekteve postare që vijnë nga jashtë vendit dhe që janë pjesë e shërbimit universal përcaktohen në bazë të marrëveshjeve dypalëshe ose shumë palëshe midis Postës Shqiptare dhe ofruesve përkatës të shërbimeve postare jashtë vendit ose në bazë të detyrimeve terminale të përcaktuara në përputhje me rregullat e miratuara nga aktet e UPU-së.

Sipas nenit 28 të ligjit 46/2015, tarifën për çdo shërbim që bën pjesë në shërbimin universal postar duhet të përmbushin parimet e mëposhtme:

- a) të jenë të përballueshme dhe të tilla që të gjithë përdoruesit, pavarësisht vendndodhjes së tyre gjeografike, të kenë akses në shërbimet e ofruara;
- b) të jenë të orientuara drejt kostos dhe të sigurojnë nxitje për ofrimin efikas të shërbimit universal postar;
- c) të jenë të njëjta për shërbime të njëjta në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë;
- d) të jenë transparente dhe jo-diskriminuese, të mos dëmtojnë konkurrencën.

Aktualisht, Posta Shqiptare ofron shërbimet universale postare në bazë të tarifave të miratuara me VKM Nr.446, datë 26.09.2002, mbi “Miratimin e tarifave postare të shërbimit bazë”.

- Nga verifikimi i kryer përgjatë ushtrimit të veprimtarisë inspektuese, rezultoi se subjekti ofrues i shërbimit universal postar “Posta Shqiptare” për zyrat postare në zonat urbane ka informatizuar të gjithë procesin që ndiqet për një objekt postar, që nga pranimi i tij nga punonjësi i sportelit dhe deri në përfundim të shërbimit, duke nxjerrë automatikisht dhe llogaritjen e tarifës përkatëse për shërbimin e kërkuar nga përdoruesi. Sistemi elektronik “Eterna Posta” ka të implementuar tarifën e miratuara për çdo shërbim postar që ofrohet, ndërsa për zyrat postare në zonat rurale veprohej nëpërmjet tabelave përkatëse në të cilat janë të pasqyruara tarifën e miratuara për shërbimin postar që ofrohet, gjithashtu të publikuara dhe në faqen zyrtare online të ofruesit “Posta Shqiptare” sh.a.
- Në verifikim të të dhënave dhe informacionit të mësipërm, rezultoi se ofruesi i shërbimit universal postar respekton aplikimin e tarifave të miratuara sipas kërkesave ligjore të parashikuara në Ligjin 46/2015 dhe Rregullores nr.36 datë 29.10.2015, për “Ofrimin e Shërbimit Universal Postar”.

## **IV Programi vjetor i punës për vitin në vazhdim**

Programi vjetor i punës për vitin në vazhdim 2017 bazohet në vijimin e përmbushjes së:

- Detyrimeve dhe objektivave rregullatorë të përcaktuar në legjislacionin material,
- Politikat e zhvillimit sektorial të Këshillit të Ministrave,
- Direktivave të fushës të Komisionit dhe Parlamentit Europian,
- Akteve të BEREC, ERGP dhe ITU,
- Rekomandimeve sektoriale të Progres Raportit të KE për Shqipërinë,
- Kërkesave të paraqitura nga tregu.

Si dhe duke konsideruar:

- Tendencën e zhvillimit të tregjeve në kushtet e neutralitetit teknologjik dhe konsolidimit të tyre,
- Nxitjen e investimeve të orientuar drejt interesit më të lartë public,
- Mbrojtjen e interesave të konsumatorit,
- Praktikrat dhe eksperiencat më të mira Rajonale dhe Botërore.

### **11. Programi vjetor i punës për vitin në vazhdim 2017**

#### **11.1 Në drejtim të mbikëqyrjes dhe rregullimit ekonomik**

1. Analiza e tregut celularë.
2. Analiza e tregut të telefonisë fikse.
3. Monitorimi i zbatimit të detyrimeve të vendosura nga AKEP për operatorët celularë në 2014-2017.
4. Rishikimi i Statusit të SHU të komunikimeve elektronike.
5. Publikimi në faqen web të AKEP i informacionit krahasues të tarifave të shërbimeve të komunikimeve elektronike.
6. Masa të mundshme rregulluese për roamingun ndërkombëtar dhe shërbimet me vlerë të shtuar/numrat-jogjeografikë.
7. Mbledhja, përpunimi dhe publikimi i të dhënave statistikore të komunikimeve elektronike.

## 11.2 Në drejtim të administrimit të burimeve të fundme, autorizimeve dhe faciliteteve

1. Ndjekja e Proçedurës së Tenderit me objekt “Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1965 – 1980 MHz çiftuar me 2155- 2170 MHz dhe 5 MHz spektër i paçiftuar 1915 – 1920 MHz”.
2. Ndjekja e Proçedurës së Tenderit me objekt “Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 2500-2690 MHz”.
3. Hartimi i dokumentave mbi strategjinë dhe objektivat për futjen e shërbimeve të lëvizshme në brezat e frekuencave 800 MHz.
4. Hartimi i dokumentave mbi strategjinë dhe objektivat për futjen e shërbimeve të lëvizshme në brezat e frekuencave 3400-3600 MHz, 3600-3800 MHz.
5. Ndjekja e aplikimeve për pajisjen me AI për përdorimin e frekuencave.
6. Ndjekja e aplikimeve për pajisjen me numeracion dhe kode.
7. Ndjekja e proçesit të portabilitetit të numrit, përditësimi i Rregullores.
8. Ndjekja e praktikave të koordinimit të frekuencave me institucionet e tjera, ndërkufitare, satelitore etj..
9. Ndjekja e proçedurave të koordinimit të frekuencave dhe notifikimit të satelitëve që ndiqen nga AKEP.
10. Ndjekja e aplikimeve për regjistrimin nën regjimin e AP.
11. Ndjekja e aplikimeve për pajisjen me çertifikata/liçenca.
12. Ndjekja e aplikimeve për pajisje me Konfirmimin e Njohjes së Konformitetit të Pajisjeve Radio.
13. Administrimi dhe përditësimi i Web-Gis, regjistrit elektronik të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë (Atlasi Elektronik).
14. Verifikimi i raportimeve të sipërmarrësve të tregut të komunikimeve elektronike në Modulin e Aplikimeve Online për lidhjet në brezin 2.4/5.8GHz.
15. Broadband - Ndjekja në vazhdimësi e përmbushjes së detyrimeve të marra përsipër nga operatorët në zbatimin të Vendimit Nr. 300, datë 08.04.2015 të Këshillit të Ministrave, "Për Miratimin e Planit Kombëtar për Zhvillimin e Broadband-it" i ndryshuar, për mbulimin me shërbim në zonat me densitet të ulët të popullsisë për mbulimin me shërbime broadband dhe zonave për përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar.
16. Vijimi i bashkëpunimit në kuadër të zbatimit të Vendimit Nr. 300, datë 08.04.2015 të Këshillit të Ministrave, me Institucionet Shtetërore si Ministrinë, Njësitë Vendore, Autoritetin Rrugor Shqiptar etj.
17. Zbatimi i akteve të reja ligjore - Marrja e masave nga AKEP, për zbatimin e VKM nr. 851, datë 7.12.2016 “Për kalimin e të dhënave mbi shtrirjen e rrjetit të infrastrukturës inxhinierike të bashkitë”.
18. Zbatimi i akteve të reja ligjore - Marrja e masave nga AKEP, për zbatimin e parashikimeve të ligjit nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”.
19. Vijimi i proçesit për Përmirësimin e akteve rregullatore - Marrja e masave për përmirësimin të: Rregullores Nr. 24 datë 02.02.2012 “Për Autorizimin e

Përgjithshëm” e ndryshuar dhe rregulloreve të tjera që mund të preken nga këto ndryshime.

20. Marrja e masave për përmirësimin të: Rregullores “Për shërbimet radioamatore në Republikën e Shqipërisë” miratuar me VKD nr. Nr.1222, Datë 13.04.2010, e ndryshuar.
21. Upgrade i regjistrit elektronik – ATLAS: Finalizimi i Dokumentit të Tenderit dhe Fillimi i procedurës së prokurimit për Upgrade të “Regjistrit elektronik të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

### **11.3 Në drejtim të monitorimit të spektrit të frekuencave, cilësisë dhe inspektimit**

1. Zhvillimi i projektit për krijimin e Sistemit Kombëtar të Monitorimit të Spektrit të Frekuencave, Ndërtimi i Stacioneve të Thjeshtë Fiks Monitorimi (SRFMS ), në sektorët rajonalë.
2. Monitorim i brezit të frekuencave 20 MHz – 3 MHz, në zonën Tiranë- Durrës nëpërmjet Stacioneve Fikse të Monitorimit në Krujë dhe Pinet.
3. Monitorimi i brezit të frekuencave të shërbimit të radionavigimit aeronautik 108 - 144 MHz, 960 - 1215 MHz dhe 1300 – 1350 MHz, në qytetin e Tiranës dhe qytetet kryesore në RSH.
4. Inspektimi i sipërmarrësve të tregut të komunikimeve elektronike.
5. Monitorimi periodik i frekuencave që përdoren në pikat kryesore të transmetimit në territorin e vendit, në brezat e frekuencave deri në 26 GHz.
6. Monitorimi i brezit të frekuencave 2.4 GHz dhe 5.8 GHz në pikat kryesore të transmetimit në territorin e vendit.
7. Monitorimi i brezit të frekuencave 2.6 GHz në qytetet kryesore të vendit.
8. Monitorimi i mbulimit dhe cilësisë së shërbimit në brezat e frekuencave GSM/UMTS/IMT/LTE në qytetet kryesore të Shqipërisë, rrugët kryesore kombëtare, zonat urbane dhe pikat turistike.
9. Monitorimi i mbulimit dhe cilësisë së shërbimit në brezat e frekuencave GSM/UMTS/IMT/LTE në zonat me densitet të ulët të popullsisë, të cilat do të mbulohen me shërbime broadband.
10. Monitorimi i mbulimit dhe cilësisë së shërbimit në brezat e frekuencave GSM/UMTS në zonat kufitare, sipas marrëveshjeve teknike midis AKEP dhe autoriteteve fqinje.
11. Monitorimi i mbulimit dhe cilësisë së shërbimit në brezat e frekuencave GSM/UMTS/IMT/LTE në zonat me densitet të ulët të popullsisë, të cilat do të mbulohen me shërbime broadband të përcaktuara në marrëveshje për investim të përbashkët midis operatorëve.
12. Administrimi i interferencave dhe zgjidhja e tyre në rastet e ankesave për ndërhyrje të dëmshme që vijnë nga sipërmarrësit e komunikimeve elektronike.
13. Zbatimi i rregullave teknike të përcaktuara në Rregulloren Nr. 22, datë 24.06.2011, “Mbi kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës rrjeteve kabllore urbane dhe rrjeteve me fibra optike ndërurbane të komunikimeve elektronike”, për stabilizimin dhe standartizimin e rrjeteve kabllore të komunikimeve elektronike.

#### **11.4 Në drejtim të ushtrimit të funksioneve rregulatore në teknologjinë e informacionit dhe zhvillimit të broadband**

1. Ndjekje e procesit të regjistrimit / rinovimit të domain-ve. Administrim i sistemit të cctld .al (sistem i menaxhimit të domain .al).
2. Monitorim i aksesit në internet të Sistemit DNS (lidhjet përkatëse me 2 ISP).
3. Administrim dhe mirëmbajtje e sistemeve informatike dhe rrjetit kompjuterik të institucionit.
4. Menaxhimi i CRBD dhe Portabiliteti i Numrit.
5. Funksionimi i sistemit të CRDB sipas Rregullores dhe realizimi i procesit të bartjes së numrave për pajtimtarët.
6. Upgrade i Sistemit të Përqëndruara të Informacionit për rrjetet e komunikimeve elektronike Sistemi i menaxhimit të proceseve të AKEP.
7. Rinovim i infrastrukturës IT për cctld.al.
8. Ndjekja dhe realizimi i detyrave që do të caktohen për pjesëmarrje në Grupe pune të ndryshme.
9. Upgrade i sistemit E – Arkiva.
10. Sistem monitorimi të rrjetit LAN/WAN për AKEP, QKMF dhe pikat në distancë.

#### **11.5 Në drejtim të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe mbrojtjes së konsumatorit**

1. Angazhim në konstatimin e nevojës për amendime/përditësime të akteve rregulatore të nxjerra nga AKEP dhe në fuqi, dhe në hartimin dhe ndryshimin e tyre në kuadër të përmirësimit të kuadrit rregullator me legjislacionin kombëtar dhe përqaqjes së plotë me “acquis”, rekomandimet e ITU-së, rezolutat etj.
2. Angazhim në përmirësimin e legjislacionit sekondar rregullator të miratuar dhe në fuqi për komunikimet elektronike dhe shërbimin postar.
3. Angazhim në forcimin e rolit të autoritetit rregullator në mbrojtjen e konsumatorit (përdoruesit/pajtimtarit) në tregun e komunikimeve elektronike dhe në tregun postar duke e bashkërenduar punën me regjimin normativ në fuqi për mbrojtjen e konsumatorit në Shqipëri, për të garantuar:
  - a. Mbrojtjen e interesave të konsumatorit në aspektin individual;
  - b. Mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në tërësi nga sjelljet diskriminuese dhe antikonkurruese të operatorëve në tregun e komunikimeve elektronike;
  - c. Mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në tërësi nga sjelljet diskriminuese dhe antikonkurruese të ofruesve të shërbimeve postare në tregun postar;
  - d. Trajtim të barabartë dhe jodiskriminues të të gjithë përdoruesve përmes procedurave ligjore e transparente;
  - e. Monitorimin dhe kontrollin e shërbimeve që ofron i autorizuari ndaj përdoruesve të shërbimeve elektronike dhe përdoruesve të shërbimeve postare.

4. Angazhim në forcimin e rolit të rregullatorit në mbrojtjen e interesave ligjore të tregut të komunikimeve elektronike dhe për të garantuar trajtimin e barabartë ligjor dhe jodiskriminues të ofruesve të rrjeteve dhe shërbimeve në procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve mes tyre.
5. Angazhim në forcimin e rolit të rregullatorit në mbrojtjen e interesave ligjore të tregut të shërbimit postar për të garantuar trajtimin e barabartë ligjor dhe jodiskriminues të ofruesve të shërbimeve postare në procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve mes tyre.
6. Angazhim në mbrojtje të interesave juridike dhe ligjore të institucionit të AKEP sa here që do të vepohet në emër dhe për llogari të tij me përfaqësim të autorizuar para gjykatës.
7. Angazhim në trajtim juridik profesional dhe konsulence ligjore në trajtimin e të gjitha praktikave administrative të depozituara në AKEP.
8. Angazhim në zbatimin e ligjshmërisë për sigurimin e transparencës dhe publikimit të informacionit për çështje që lidhen me të drejtat e përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare.
9. Angazhim në përmbushjen e detyrave dhe objektivave specifike të caktuara në planin e veprimit të AKEP për vitin 2017 (nga miratimi i tij).
10. Angazhim për kryerjen e një procesi objektiv dhe transparent të vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civil të DZMMK, bazuar në legjislacionin e nëpunësit civil.

## **11.6 Në drejtim të mbikëqyrjes së tregut të shërbimeve postare**

- 1 Marrëdhëniet me Institucionet Ndërkombëtare BE, UPU dhe Rregullatorët e Vendeve të Rajonit.
  - Përditësimi dhe mbajtja në vëmendje të veçantë të ndryshimeve thelbësore të Akteve Ndërkombëtare mbi veprimtarinë postare, me qëllim njohjen e praktikave më të mira të Institucioneve Ndërkombëtare dhe institucioneve rregullatore të rajonit.
  - Raportimi dhe evidentimi i problematikave që trajtojnë rekomandimet e UPU me qëllim përfshirjen e tyre në Aktet rregullatore të shërbimit postar, si dhe të detyrave që dalin nga rekomandimet lidhur me raportimet e rregullatoreve në UPU dhe ofruesve të shërbimit postar në institucionet rregullatore.
  - Vendosja dhe mbajtja e kontakteve me institucionet rregullatore të rajonit me qëllim bashkëpunimin në fushën e rregullimit të shërbimit postar.
- 2 Marrëdhëniet me Ofruesit e Shërbimeve Postare:
  - Monitorimin e veprimtarisë së ofruesve të shërbimit postar, lidhur me zbatimin efektiv të detyrimeve ligjore, termat dhe kushtet e përgjithshme të shërbimit postar si dhe kushteve thelbësore që rrjedhin nga Ligji nr.46/2015, të akteve rregullatore të nxjerrë në plotësim të tij, si dhe vlerësimin e analizimin e problematikave që do



të përftohen nga raportimi i çdo ofruesi mbi veprimtarinë e shërbimit postar.

- Grumbullimi, analizimi dhe përpunimi i të dhënave statistikore postare të dërguara nga ofruesit e shërbimeve postare dhe informacione të tjera të lidhura me aktivitetin që zhvillojnë në këtë sektor, të cilat do të shërbejnë për përgatitjen e Raporteve, Informacioneve dhe Vlerësimeve të tregut postar.
- Hartimi i Planit të Inspektimit, përcaktimi i tematikave dhe metodologjisë së inspektimit sa i përket ushtrimit të kontrollit të veprimtarisë të ofruesve të shërbimeve postare në zbatim të kërkesave të Ligjit “Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve rregullatorë të Sektorit Postar, si dhe hartimi i raportit përfundimtar të inspektimit duke nxjerrë konkluzionet dhe problematikat e evidentuara.
- Përditësimi i rrjetit dhe të të dhënave të tjera të shërbimit postar.
- Marrja e masave procedurale përkatëse lidhur me ndjekjen dhe mbikqyrjen e zbatimit të Urdhrit nr.6174, datë 16/12/2015, të Ministrisë së Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, “Për përcaktimin e dëndësisë së pikave të aksesit për ofrimin e shërbimit universal postar”.
- Ndjekja e procedurave administrative lidhur me trajtimin korrespondencës që lidhet ngushtësisht me shërbimin postar, si dhe bashkëpunimin me Drejtorinë e përcaktuar sipas strukturës organizative të AKEP për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis përdoruesve dhe ofruesve të shërbimit postar dhe midis ofruesve të shërbimit postar.
- Ndjekja dhe zbatimi i procedurave administrative për dhënien e autorizimeve përkatëse për ofrimin e shërbimit postar sipas parashikimeve të Ligjit Nr.46/2015, dhe akteve rregullatore të sektorit postar.

### 3 Sektori i Integritimit

- Marrja e masave tekniko-administrative për drejtimin e veprimtarisë së komunikimit protokollar të institucionit me institucione të tjera ndërkombëtare dhe kombëtare.
- Evidentimi efektiv i nevojave të Institucionit lidhur me trajnimin dhe shkëmbimin e eksperiencës së punonjësve me qëllim përmirësimin e kapaciteteve administrative dhe rritjen e mëtejshme profesionale.
- Marrja e masave administrative dhe procedurale për përmbushjen e detyrimeve institucionale në kuadër të proceseve të integritimit, në mbështetje të zhvillimit të objektivave strategjik kombëtarë.
- Përforcimi i mëtejshëm i bashkëpunimit me institucione ndërkombëtare dhe kombëtare, jo vetëm në nivel përfaqësimi por duke kontribuar më tej në përmirësimin e legjislacionit aktual si dhe në shkëmbimin e eksperiencës për praktikën më të mirë të punës në fushën e komunikimeve elektronike dhe postare.

### **11.7 Në drejtim të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe administrimit të brendshëm**

1. Implementimi i strukturës së re, miratuar me Vendim të Kuvendit të Shqipërisë nr.88/2015 të Kuvendit të Shqipërisë “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)”.
2. Ndryshimi i rregullores së Brendshme të AKEP.
3. Vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil mbi sistemin e vlerësimit të arritjeve vjetore individuale të punonjësve të AKEP.
4. Ndjekja dhe mbikqyrja e trajnimeve për punojësit e AKEP.
5. Realizimin e gjithë procedurave dhe detyrimeve ligjore të prokurimeve sipas afateve kohore dhe legjislacionit në fuqi.

### **11.8 Në drejtim të menaxhimit financiar dhe pagesave**

1. Detajimi i të ardhurave dhe shpenzimeve të AKEP për vitin 2017,
2. Realizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve të AKEP për vitin 2017,
3. Realizimi i investimeve të AKEP për vitin 2017,
4. Hartimi i programit të shpenzimeve të vitit 2018,
5. Llogaritja dhe arkëtimi i pagesave,
6. Ndjekja dhe vjelja e pagesave të debitorëve.

## V Raporti Financiar

### 12. Raporti për realizimin e treguesve financiar vjetor të AKEP

Me Vendimin Nr.1073 datë 23.12.2015 “ Për miratimin e fondit të shpenzimeve, për vitin 2016 për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike e Postare” fondi i shpenzimeve u miratua në shumën 318,700,000 lekë.

#### 12.1 Të ardhurat dhe shpenzimet

Tabela e mëposhtme paraqet treguesit kryesorë financiarë të AKEP për të ardhurat dhe shpenzimet dhe tarifës së shërbimit të radiokomunikacionit për vitin 2016.

*Tabela 25- Të ardhurat dhe shpenzimet*

Nr Re n	Emërtimi	Vitet 2016	
		Programi	Realizimi
<b>I</b>	<b>Të ardhurat gjithsej:</b>	<b>318,570,000</b>	<b>335,159,070</b>
<b>II</b>	<b>Shpenzime gjithsej:</b>	<b>318,570,000</b>	<b>203,450,356</b>
1	Shpenzimet për paga dhe shtesa të tjera	81,200,000	70,009,885
2	Shpenzimet për sigurime shoqërore e shëndetësore	10,400,000	9,286,736
3	Shpenzimet për materiale	6,200,000	6,616,631
4	Shpenzimet për shërbime	90,470,000	88,081,766
	Shpenzimet për Investime	130,000,000	29,455,338
<b>III</b>	<b>Tarifa e shërbimit të radiokomunikacionit</b>		
1	Arkëtuar dhe transferuar në buxhetin e Shtetit		430,956,966
2	Të ardhurat si agjent tatimor nga arkëtimi dhe derdhja e tarifës së shërbimit të radiokomunikacionit		21,547,848
	Nga kjo:		
a	Për shpërbime nga të ardhurat si agjent tatimor		14,661,386
b	Për blerje pajisje dhe investime		6,169,749.60

#### 12.2 Realizimi i arkëtimeve

Për vitin 2016, të ardhurat janë realizuar në shumën 335,159,070 lekë nga 318,570,000 lekë të programuar në fillim të vitit, me realizim në masën 105.2%. Arkëtimet për vitin 2016 janë realizuar nga pagesat e sipërmarrësve që ofrojnë shërbime dhe ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushën e komunikimeve elektronike, shërbimeve postare dhe regjistrim domain. Pagesat që

llogariten dhe kryhen në AKEP nga sipërmarrësit janë sipas VKM Nr.599, datë 23.07.2010 “Për miratimin e pagesave që kryhen në AKEP”, i ndryshuar.

Të ardhurat në AKEP janë përfituar nga pagesat:

- Për mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike sipas nenit 24 të Ligjit Nr. 9918,
- Për dhënie dhe përdorimin e frekuencave,
- Për caktimin dhe përdorimin e numrave dhe serive numerike,
- Për ofrimin e shërbimeve postare,
- Për regjistrim domain.al
- Të tjera (certifikata radio operator, certifikata miratim tipi, radioamator, interesa bankare).

Një rëndësi e veçantë i është kushtuar dhe ndjekjes së debitorëve, me qëllim arkëtimin e detyrimeve që kanë si ndaj AKEP-it, ashtu dhe për tarifën e shërbimit të radiokomunikacionit.

Procesi i mbledhjes së detyrimeve nga sipërmarrësit debitor është ndjekur nëpërmjet:

- Dërgimit të shkresave zyrtare, kontaktimit me telefoni dhe nëpërmjet website.
- Inspeksionit të kryer nga Drejtoria e Inspeksionit dhe Monitorimit të Spektrit.

### **12.3 Realizimi i shpenzimeve.**

Shpenzimet gjithsej janë realizuar në shumën 203,450,356 lekë nga 318,570,000 lekë të planifikuara në fillim, ose në përqindje realizimi është në masën 63.9%. Mos realizimi i shpenzimeve vjen si rrjedhojë e mosrealizimit të shpenzimeve për investimeve dhe në disa zëra të shpenzimeve administrative.

#### ***12.3.1 Shpenzimet administrative***

Shpenzimet administrative, ku përfshihen shpenzimet për paga e shtesa, për sigurimet shoqërore e shëndetësore, për material dhe për shërbime janë realizuar në shumën 173,995,018 lekë nga 188,270,000 lekë të planifikuar ose 92.4%.

##### ***12.3.1.1 Shpenzime për paga dhe shtesa***

Shpenzime për paga e shtesa nga 81,200,000 lekë të planifikuar u realizuan 70,009,885 lekë ose 86.2%. Mos realizimi shpenzimeve për paga dhe shtesa në krahasim me programin ka ardhur nga mos plotësimi i numërit mesatar vjetor të punonjesve sipas programit për vitin 2016 e cila nga 68 punonjes u realizua 60 punonjes.

### **12.3.1.2 Shpenzime për sigurime shoqërore**

Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore nga 10,400,000 lekë të planifikuara janë realizuar 9,286,736 lekë ose 89.3%. Në mosrealizimin e shpenzimeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore nga mos plotësimi i numrit mesatar vjetor të punonjësve sipas programit për vitin 2016.

### **12.3.1.3 Shpenzime për materiale**

Shpenzimet materiale për vitin 2016 janë realizuar në shumën 6,613,631 lekë nga 6,200,000 lekë të programuara ose 106.7%, me tejkalim në shumën 413,631 lekë. Tejkalimi i shpenzimeve materiale në krahasim me programin vjetor vjen nga tejkalimi i shpenzimeve për pjesë këmbimi për automjetet në shumën 433,310 lekë, shpenzimeve për materiale të tjera në shumën 403,777 lekë, shpenzimeve për goma dhe bateri në shumën 46,400 lekë dhe shpenzime për kancelari në shumën 12,072 lekë. Tejkalimi i shpenzimeve për pjesë këmbimi në krahasim me programin vjen nga rritja e shpenzimeve për ndërrim filtra dhe vaj motori . Në vitin 2016 janë rritur kilometrat e përshkruara të atomjeteve në krahasim me programin e fillim vitit e cila ka ardhur nga rritja e numrit të inspektimive të sipërmarësve dhe nga rritja e kërkesave për monitorim të frekuencave. Nga rritja e kilometrave të përshkruara të automjeteve janë rritur shpenzimet për filtra dhe vaj motorri. Shpenzimet për materiale të tjera në krahasim me programin vjetor janë tejkaluar e cila ka ardhur nga blerja e materialeve për përshtatjen e disa zyrave të administratës në godinën e Albtelecom si dhe rregullimi i zyrave në Shkodër dhe Vlorë të cilat nuk ishin të programuara në programin e shpenzimeve të vitit 2016.

### **12.3.1.4 Shpenzimet për shërbime.**

Shpenzimet për shërbime janë realizuar në shumën 88,081,766 lekë nga 90,470,000 lekë të programuar ose 97.3% me një mos realizim në shumën 2,388,234 lekë. Nga analiza e shpenzimeve për shërbime rezulton se mos realizimi më i madh është në zërin e shpenzimeve për mirëmbajtjen vjetore të Portabilitetit të Numrit me shumën 5,426,672 lekë, shpenzimet për shërbime Auto- transporti me shumën 566,793 lekë, shpenzimet për publikime e njoftime me shumën 974,000 lekë, Shpenzimet për udhëtim e dieta dhe kualifikim stafi me shumën 3,001,627 lekë, shpenzimet social – kulturore dhe pritje përcellje me shumën 676,130 lekë, shpenzimet për kuotacion të organizatave ndërkombëtare me shumën 115,306 lekë.

Disa zëra shpenzimesh për shërbime kanë rezultuar me rritje në krahasim me programin e vitit 2016.

- Në zërin shpenzime për Shërbime Të Tjera në krahasim me programin vjetor rezultuan me rritje në shumën 7,532,470 lekë. Në vitin 2016 administrata e AKEP u transferua nga godina e Torre Drini në godinën e Albtelecom. Transferimi i administratës në godinën e Albtelecom u shoqërua me shpenzime për shërbime të cilat nuk ishin të programuara në fondin e shpenzimeve të AKEP për vitin 2016.

Për transferimin e administratës nga godina Torre Drini në godinën Albtelecom u kryen:

- Shpenzime për ngarkim shkarkimin e pajisjeve dhe dokumentacionin e AKEP.
  - Shpenzime për transportimin dhe sistemimin e pajisjeve dhe dokumentacionin e AKEP.
  - Shpenzime për adaptimin dhe përshtatjen e disa ambjeteve për zyra për administratën e AKEP.
  - Shpenzime për transferimin e dhomës së serverave.
  - Shpenzime për ruatjen e godinës së Albtelecom me roje në turnin e parë dhe në turnin e dytë.
  - Shpenzime për riparimin dhe përshtatjen e ambjeteve për zyra në Shkodër, Vlorë dhe Krujë.
- Në zërin shpenzime për shërbime bazë në krahasim me programin vjetor rezultuan me tejkalim në shumën 823,605 lekë. Tejkalimi i shpenzimeve në krahasim me programin vjetor ka ardhur si pasojë e rritjes së konsumit të energjisë elektrike në godinën e AKEP nga instalimi i pajisjeve të serverave për Qendrën e Sistemit Kombëtar të Monitorimit të Spektrit të Frekuencave dhe nga vendosja e administratës në godinën e Albtelecom. Në godinën e Albtelecom ngrohja dhe freskimi i ambjeteve të punës bëhet me kondicioner të cilët kanë një konsum më të madh të energjisë elektrike se sistemi i përqëndruar që ishte në objektin e Torre Drinit.
  - Në zërin shpenzime për ambjete me qera në krahasim me programin kanë rezultuar me rritje në shumën 110,510 lekë e cila ka ardhur nga marrja me qera nga Bashkia e Tiranës dy vende parkimi për mjetet para godinës së Albtelecom.

### **12.3.1.5 Shpenzimet për Investimet**

Shpenzimet për investime për vitin 2016 nga 130,300,000 lekë të programuara janë realizuar në shumën 29,455,338 lekë ose 22,6% me një mos realizim në shumën 100,844,662 lekë. Në mos realizimin e shpenzimeve për investime ka influencuar kryesisht mos realizimi i objektit; Zhvillimi i Sistemit Kombëtar të Monitorimit të spektrit të frekuencave, pajisje për Stacion të Thjeshtë Fiks Monitorimi (SRFMS) në Shkodër dhe Vlorë me shumën 100,000,000 lekë.

Realizimi i shpenzimeve për investime sipas objekteve është si më poshtë vijon:

- Zhvillimi i Sistemit Kombëtar të Monitorimit të spektrit të frekuencave, pajisje për stacion Fiks monitorimi (SRFMS) në Shkodër dhe Vlorë e programuar në shumën 100,000 lekë. Blerja e pajisjeve për stacion Fiks monitorimi (SRFMS) në Shkodër dhe Vlorë nuk u realizua megjithëse procedura e prokurimit dhe vlerësimit u krye gjatë vitit 2016. Ankimimi nga subjekte pjesëmarrëse në tender për vlerësimin e ofertave bëri

që të mos realizohet brenda vitit 2016. Aktualisht procedura e ankimimit nga muaji Dhjetor 2016 është në Gjykatën e lartë dhe nuk ka kaluar për shqyrtim.

- Sistem sigurie kamera, sistem kondicionimi ,UPS dhe akses kontroll për stacionet Fikse monitorimi (SRFMS) në Shkodër, Vlorë , Korçë e programuar në shumën 2,700,000 lekë ,është realizuar 2,549,760 lekë.
- Upgrade i sistemit të menaxhimit të cctld.al e programuar në shumën 7,200,000 lekë është realizuar ne shumen 7,217,400 lekë.
- Upgrade ARGUS për Qendrën e Lëvizshme të Monitorimit të Frekuencave e programuar në shumën 9,300,000 lekë është realizuar në shumën 8,940,000 lekë.
- Upgrade për dhomën e Server-ave pranë Q.K.M.F. e programuar në shumën 2,800,000 lekë është realizuar në shumën 2,289,566 lekë.
- Sistemi dhe rrjeti i komunikimit i Q.K.M.F. dhe pikat e monitorimit në distancë e programuar në shumën 2,800,000 lekë është realizuar në shumën 2,703,600 lekë.
- Blerje pajisje kompjuterike e programuar në shumën 3,500,000 lekë është realizuar në shumën 3,366,500 lekë.
- Blerje pajisje për zyra e programuar në shumën 1,500,000 lekë është realizuar në shumën 1,452,000 lekë.
- Blerje pajisje të tjera e programuar 900,000 lekë është realizuar në shumën 936,512 lekë.

#### **12.4 Mbi tepricën e të ardhurave**

Teprica e të ardhurave në fund të vitit 2016 rezulton në shumën 132,425,429.49 lekë e cila është përfituar si rezultat i tejkalimit të ardhurave në shumën 16,589,070 lekë dhe mos realizimi i shpenzimeve në shumën 115,836,359.49 lekë. Tepricën e të ardhurave që rezulton në fund të vitit nga mos realizimi i shpenzimeve mendojmë të mos derdhet në Buxhetin e Shtetit shuma 100,000,000 deri në shqyrtimin dhe vendimin e Gjykatës së Lartë për ankimin e ofertës së objektit ”Zhvillimi i Sistemit Kombëtar të Monitorimit të spektrit të frekuencave, pajisje për stacion Fiks monitorimi (SRFMS) në Shkodër dhe Vlorë”.

#### **12.5 Mbi taksën e radiokomunikacionit**

Në referencë të ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “ Për taksat kombëtare” dhe udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Financave Nr.28, datë 06.10.2008 “ Për përcaktimin e tarifës së shërbimit të radiokomunikacionit” i ndryshuar, AKEP është agjent tatimor për llogaritjen, arkëtimin dhe transferimin në Buxhetin e Shtetit të tarifës së shërbimit të radiokomunikacionit.

Për vitin 2016 janë arkëtuar dhe derdhur në Buxhetin e Shtetit nga tarifa e shërbimit të radiokomunikacionit shuma 430,956,966 lekë.

AKEP ka punuar dhe ndjekur në vazhdimësi mbledhjen e tarifës së radiokomunikacionit, ka raportuar dhe derdhur në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Tiranë brenda afatit cdo muaj.

Të ardhurat e përfituara si agjent tatimor nga komisione në masën 5 % të shumës së derdhur në Buxhetin e Shtetit janë në shumën 21,547,848 lekë.

Të ardhurat e përftuara nga komisionet si agjent tatimor janë përdorur për shpërblimin e punonjësve në shumën 14,661,386 lekë dhe për blerje pajisje minitorimi në shumën 6,169,749.60 lekë.

## **12.6 Rritja e performancës dhe efektiviteti i realizimit të treguesve financiarë të AKEP**

AKEP gjatë vitit 2016 ka punuar për rritjen e performancës dhe efektivitetin e realizimit të treguesve financiarë si dhe në administrimin, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare duke bërë:

- Kontabilizimin në kohë të veprimeve të arkës, bankës, magazinës për të ardhurat nga pagesat dhe shpenzimet që kryen institucioni.
- Mbyllja e bilancit financiar të vitit 2015, dhe dërgimin e tij brenda afateve ligjore në organet tatimore.
- Ndjekja e vazhdueshme e sipërmarrësve debitor për likuidimin e pagesave për AKEP dhe tarifën e radiokomunikacionit dhe bashkëpunim me organet tatimore.
- Informatizimi i llogaritjeve të pagesave dhe mundësimi on-line në faqen e internetit të AKEP, për sipërmarrësit me qëllim rritjen e transparencës dhe uljen e debitorëve.

Llogaritjen, arkëtimin dhe derdhjen e tarifës së shërbimit të radiokomunikacionit në buxhetin e shtetit



### 13. Programi i treguesve financiarë të AKEP për vitin 2017

Në zbatim të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, Këshillit të Ministrave me Vendimin nr. Nr.62 datë 03.02.2017 “Për miratimin e fondit të shpenzimeve, për vitin 2017 për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike e Postare”, fondi i shpenzimeve u miratua në shumën 363,020,000 lekë.

Fondi i shpenzimeve për vitin 2017 sipas zërave u miratua si më poshtë:

*Tabela 26- Fondi i shpenzimeve për vitin 2017*

<b>Nr. Ren</b>	<b>Emërtimi</b>	<b>Programi Vjetor</b>
<b>I</b>	<b>Të ardhura nga pagesat gjithsej:</b>	<b>363,020,000</b>
<b>II</b>	<b>Shpenzime gjithsej:</b>	<b>363,020,000</b>
1	Shpenzime për paga dhe shtesa të tjera	86,500,000
2	Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	11,000,000
3	Shpenzime për materiale	7,900,000
4	Shpenzime për shërbime	110,070,000
5	Shpenzime për Investime	147,550,000

## Figurat

Figura 1	Organigrama e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare	31
Figura 2	Përbërja strukturore sipas funksioneve në AKEP	32
Figura 3	Të ardhurat e sipërmarrësve të komunikimeve elektronike (2008-2015)	36
Figura 4	Të ardhurat totale të sipërmarrësve të komunikimeve elektronike (2015)	36
Figura 5	Te ardhurat Totale të operatorëve celularë 2004-2015	37
Figura 6	Të ardhurat nga Shërbimet me pakicë dhe shumicë të rrjeteve celulare 2010-2015	38
Figura 7	Ecuria e Fitimeve neto të sipërmarrësve të rrjeteve celulare (2010-2015)	38
Figura 8	Ecuria e Investimeve të sipërmarrësve në rrjete celulare (2010-2015)	39
Figura 9	Ecuria e numrit të përdoruesve celularë sipas tremujoreve T4 2014 - T4 2016	41
Figura 10	Numri i përdoruesve active të aksesit broadband nga rrjete celulare	43
Figura 11	Ecuria e strukturës së trafikut dalës celular (2003-2015)	45
Figura 12	Ecuria trafikut on-net/off-net 2014-2016	46
Figura 13	Ecuria e ARPU dhe Thirrje për përdorues	51
Figura 14	Ecuria e numrit të pajtimtarëve të Telefonise fikse 2000-2015	57
Figura 15	Norma e penetrimit të telefonisë fikse sipas qarqeve dhe zonave urabne/Rurale (2016)	57
Figura 16	Norma e Penetrimit të telefonisë fikse në Shqipëri dhe vende të Tjera	58
Figura 17	Ecuria e pjesëve të tregut të aksesit Broadband nga rrjete fikse (2010-2016)	59
Figura 18	Ecuria e pajtimtarëve të telefonisë dhe të aksesit broadband nga rrjete fikse 2010-2016	60
Figura 19	Penetrimi i aksesit broadband nga rrjete fikse sipas popullsisë dhe familjeve (2011-2016)	60
Figura 20	Penetrimi i aksesit broadband nga rrjete fikse sipas Qarqeve (2016)	61
Figura 21	Lidhjet broadband fiks sipas teknologjisë Shqipëri v BE 2015/2016	63
Figura 22	Shpërndarja e pajtimtarëve me akses broadband fiks sipas shpejtësisë 2014-2015	63
Figura 23	Ecuria e objekteve postare 2012-2016	66
Figura 24	Objekte postare per banore ne vendet e BE	67
Figura 25	Ecuria e numrit të të punësuarve 2012-2016	69
Figura 26	Pjesët e tregut në të ardhura - 2016	71
Figura 27	Pjesë tregu në të ardhura sipas shërbimeve	71
Figura 28	Totali i të ardhurave/investimeve në sektorin postar gjatë periudhës 2012-2016	72
Figura 29	Tarifat MTR sipas vendeve te BEREC (Korrik 2016)	77
Figura 30	Mbulimi i tregut nga Posta Shqiptare sipas llojeve të shërbimeve të ofruara	137
Figura 31	Ecuria e objekteve postare të shërbimit universal postar të ofruara 3M-1 2016 - 3M-4 2016	138
Figura 32	Shërbimet Postare sipas llojit të paraqitur në tre mujor	138

## Tabelat

Tabela 1	Tregues kryesorë të volumit të shërbimeve celulare 2013-2015	40
Tabela 2	Numri i pajtimtarëve me akses broadband 3G/4G	43
Tabela 3	Pjesët e tregut të operatorëve celularë 2011-2016	47
Tabela 4	Përdorimi mesatar mujor i shërbimeve celulare 2010-2016	49
Tabela 5	Ecuria e ARPM dhe ARPU 2010-2015	51
Tabela 6	Ecuria e numrit të pajtimtarëve të aksesit broadband nga rrjete fikse 2010-2016	59
Tabela 7	Numri i pajtimtarëve që kanë akses në shërbime të integruara	61
Tabela 8	Numri i pajtimtarëve të Albtelecom me shërbime të integruara	62
Tabela 9	Ofrimi me shumicë Linja/kapacitete me qira 2014-2016	64
Tabela 10	Të dhëna mbi kategorite kryesore të objekteve postare (2015-2016)	66
Tabela 11	Numri i Zyrave postare të hapura për publikun (2015-2016)	68
Tabela 12	Tregues të rrjetit teknik sipas viteve 2012-2016	68
Tabela 13	Të ardhurat nga shërbimet postare për vitin 2016	70
Tabela 14	Të ardhurat e Posta Shqiptare sipas shërbimeve	70
Tabela 15	Tarifat e aksesit në tubacione në rrjetin Albtelecom (2015-2016)	74
Tabela 16	Regjistri i Sip. që kanë njoftuar për ofrimin e rrjeteve /shërbimeve publike	81
Tabela 17	Monitorimi i radiolidhjeve fikse	95
Tabela 18	Monitorimi Fiks i Spektrit të frekuencave 20– 3000 MHz	96
Tabela 19	Numri i domain-eve sipas regjistrarëve	106
Tabela 20	Të dhënat e detajuara të numrit të domain-eve	106
Tabela 21	Regjistri i realizimeve të prokurimit publik për Vitin 2016	119
Tabela 22	Aktivitetet ndërkombëtare në të cilat AKEP ka marrë pjesë përgjatë vitit 2016	126
Tabela 23	Rënditja e Shqipërisë për indeksin e çmimeve të ICT në raportet e ITU 2015-2016	132
Tabela 24	Realizimet e Postës Shqiptare për vitin 2016 krahasuar me vitin 2015	137
Tabela 25	Të ardhurat dhe shpenzimet	152
Tabela 26	Fondi i shpenzimeve për vitin 2017	158